FRANC ÇLLOKAJ

TREGIMI PËR BUKËN E BARDHË

FRANC SLLOKAN / TREGIMI PËR BUKËN E BARDHË

NATYRA DHE NJERËZIT

FRANC SLLOKAN

TREGIMI PËR BUKËN E BARDHË

Dečja knjiga

„MUSTAFA BAKIJA"
SHTËPIJA BOTUESE KRAHINORE
PRISHTINË 1951

Titulli i origjinalit
ФРАНЦ СЛОКАН
ПРИЧА О БЕЛОМ ХЛЕБУ

Përkthye
HAKI HOXHA

Ilustrue
RADIVOJE KNEZHEVIQ

Redaktori teknik
VLLADA BOGDANOVIQ

Shtypë në 5.000 copë në „Jugoshtampë" — Beligrad
Shtypja âsht mbarue në korrik 1951

SI DO TË JETË Ë ARDHMJA E JONË

Kujt duhet me iu përgjegjë?

Çashtjet që edhe ty të shqetsojnë dhe t'interesojnë i kam mbledhë nga kuvendimet që kam pasë me rininë, puntorët, intelektualët, qytetaret dhe qytetarët.

Të gjithëve duhet me iu përgjegjë. E të gjitha këto që po më pyetni mund të bashkohen në nji pyetje të vetëme të madhe:

Si do të jetë e ardhmja jonë?

Kjo do me thanë: si do të jetë te na në vjetët e ardhshëm — mbas pesë vjetësh? Dhe si do të jetë mbas dhetë vjetësh? Si do të jetojmë atëherë? Si do ta shîqojmë jetën? Shka dhe si do të punojmë? Shka do të bâjmë dhe shka do të ndryshojmë.

Shka duem në të vërtetë?

Na duem që të marrë fund e kaluemja. Por shka duhet me përmirësue dhe në ç'mënyrë? A mundet njeriu t'i bâjë ballë lehtazi »fatit« të vet? Dhe pse kemi qenë të pafat deri tash?

Due me iu dhanë nji përgjegje të vetëme:

E ardhmja jonë do të jetë e bukur!

Por, a do të më besoni? Dhe a do t'isha atëherë mâ i mirë se falltorja mashtruese? Jo, nuk kam qëllim me qitë fall. Due të ju provoj me fakte të thjeshta se e ardhmja jonë do të jetë me të vërtetë shum mâ e bukur se e kaluemja dhe e tashmja. Do të përpiqem me ju shpjegue sepse ajo do të bâhet patjetër mâ e mirë.

Qé po ju tregoj se si do të realizohet kjo gjâ!

Kreu i parë

VISARET TONÁ

1. Në rrethin magjik

Disa njerëz mendojnë ende se me u pasunue shpejt âsht lumnija mâ e madhe. Me u pasunue, për këta do me thanë — mos me punue kurrgjâ. Për njerëzit punuesa, të cilët shpesh herë s'kanë pasë mjaft as bukë, të cilët s'kanë pasë as rrobe të mira as banesë të përshtatshëme — pasunija ka qenë dishka krejt tjetër.

Nga nji herë për shum njerëz të vendit tanë pasuni do të thoshte me pasë punë të vazhdueshëme. Prandej ata kanë shkue në mergim për të nxjerrë kafshatën e bukës. Kanë kërkue »pasuni« n'Amerikë, Vestfali, Francë — e kahmos nepër krejt botën. E kanë nda kafshatën prej gojës dhe atë shka fitojshin ua dërgojshin në shtëpi prindëve të vet, vllazënve dhe motrave. Te shtëpija gati askush nuk fitonte gjâ. Po qe se dëshirojshe me fitue dishka, ishje i detyruem me e lanë atdheun patjetër. N'atdhé askush s'âsht pasunue. Disa mendojshin se njeriu mund të pasunohet vetëm në vendet e hueja. Mirëpo, nji numër i madh i atyne që këtheheshin prej vendeve të hueja të lodhun dhe të këputun — nuk besojshin mâ në këtë gjâ.

Njerëzit e thjeshtë besojshin dikur në përrallën se pasunija âsht me të vërtetë aty, por se âsht mbulue nandë pashë thellë në dhé. Ai që don me e gjetë, duhet me hy patjetër në rrethin magjik, të cilin duhet ta vizatojë në tokë me nji dru të veçantë. »Pasuninë«, e ruen dreqi gjithmonë, prandej duhet me u kacafytë

me të. Nuk guxon me u frigue prej tij. Duhet të dijsh me e mashtruë me doemos.

Atëherë njerëzit nuk kanë dijtë asnji tregim që do të ju flitte se si e ka gjetë pasuninë njeriu i vorfën. Tregimi i këtillë do t'ishte shum i pabesueshëm.

N'ato ditë, njerëzit tanë kanë jetue aq vorfnisht, sa që gadi s'kanë mujtë me besue as në pasunitë e përrallave. I besojshin dreqit. A thue do të kishte këso të këqijash në botë, po të mos rrinte vetë dreqi mbi pasuninë? Ata s'i besojshin visarit, me gjithë se e nxjerrshin dita ditës prej dheut. Nuk kanë qenë as të vetëdijshëm se po e nxjerrin. Ata e kanë nxjerrë vetëm për të tjerët. Por nuk mendojshin shum për këtë gjâ. »Kështu âsht në botë«, flitshin ata. Sikurse patjetër do të mbetej kështu dhe se nuk do të mundte të ndryshohej kurr asnji gja.

Ishin në rrethin magjik, dhe nxirrshin gjithmonë visare prej dheut, por me dreqin nuk u kacafytën. Ndonjeni që ishte edhe mâ i keq se vetë dreqi i mbushte strajcat e pangishëme me visarët që ata nxirrshin prej dheut.

2. Visaret nuk gjinden vetëm në tregime

Në botë ka aq shum visare, sa që gadi mund të humbim në to. Këto visare nuk ka nevojë me i kërkue aq gjatë, por duhet me i shfrytzue. Visarët nuk gjinden vetëm në tregime. Shiqo rreth vetvehtes! Jemi të pasun. Edhe Sllovenija ka visare të shumta.

»Shkrepat tanë të zdeshun!« Ti i vërçn me nënqeshje.

Po, edhe shkrepat do t'ishin visare, sikur të mos kishin kurrgjâ tjetër. Këta shkrepa mund të shëndrrohen lehtazi në gëlqere, mermer: në mure, në pllaka për shtruemjen e rrugëve, në karpit, xham, ciment...

Në këta »shkrepa« do të kishte mjaft kullosa për dhen, të cilat do të na jepshin lesh. Shum shkrepa mund të mbulohen lehtazi me pyje. Kush e din se shka mund të këtë mâ në shkrepa! Shka nuk mëshihet nën to!

E dijmë se shka mëshihet. Në mes të shkencave tjera gjindet edhe shkenca, e cila i ka dhanë mundësi njeriu me shique thellë nën tokë dhe atje të zbulojë shum visare. Kjo nuk âsht përrallë. Në botën e vërtetë ndodhin mrekullina edhe mâ të mëdha se sa në tregimet. Ajo shkencë që zbulon visaret në thellësi prej shum qinda metrash quhet gjeologji. Gjeologët — specijalistat që merren me këtë shkencë — kanë zbulue edhe te na visare shum të mëdha. Jo vetëm se i kanë zbulue, por ata i kanë edhe çmue.



»Lumejt do të na japin visarin mâ të çuditshëm — energjinë elektrike«

Prandaj na e dijmë se nën »shkrepat« tanë mëshihen shtresa shum të mëdha qymyri. Kjo do me thanë se do të hapim shum xeherore qymyri e tashmâ e dijmë se edhe ku do t'i hapim këto xeherore.

Mirëpo na kemi edhe visare të tjera me shumicë, të cilat i shohim me sytë tanë të gjithë fare lehtë pa qenë profesjonalista.

A ke mendue ndonjiherë se lumejt tanë janë visare tepër të çmueshëme. Po, edhe n'ujin e thjeshtë mëshihet visari. Ai do të na e sigurojë ardhmeninë tanë mâ të mirë.

Lumejt do të na japin visarin mâ të çuditshëm — energjinë elektrike.

Shka âsht energjija elektrike?

Kjo âsht ajo fuqi e çuditshëme, të cilën njeriu din me e shëndrrue në dritë, në nxehtësi dhe në fuqi lëvizëse. Energjija elektrike ven në lëvizje maqina të shumta. Sikur të dojshim vetëm me i numërue ato, ky libër nuk do të mjaftonte për atë punë. Me anën e energjisë elektrike na nxjerrim nji metal shum të njoftun — aluminin. Pa energji elektrike nuk do ta kishim këtë dhe prodhimi i tij do t'ishte shum i shtrejtë. Me anën e energjisë elektrike dhe nepër furra elektrike na sod shkrijmë edhe mineralet e hekurit, kështu që për këtë proçes nuk kemi nevojë mâ për aq shum koks sikur përpara, kur nuk përdorej energjija elektrike për këtë qëllim. E pse nuk e përdorim koksin? Koksi âsht i shtrejtë. Ai nuk mund të nxirret prej çdo lloj qymyri. Na nuk kemi mjaft qymyr t'atillë prej kah do të mujshim me nxjerrë koksin ase gazin në vojguroret.

Nji spejcalist e ka quejtë energjinë elektrike »vajzë për të gjithë«. Me të vërtetë, me anën e kësaj ngrohemi, ziejmë, hekurosim, pastrojmë, çojmë ngarkesa të randa, mjekohemi (mjekët përdorin aparate dhe vegla të ndryshëme për mjekimin e disa sëmundjeve dhe bâjnë operacjone me anën e energjisë elektrike). Energjija elektrike ven në lëvizje lokomotiva dhe nëndetëse; me anën e energjisë elektrike ndëgjojmë (radjon) dhe shiqojmë në largësi (televizjoni).

Duhet me e shfrytzue peshën e ujnave që rrëxohen, ase sikurse e quejmë na — fuqinë e ujit — e kështu do të fitojmë energjinë elektrike. Nuk mjafton me shfrytzue vetëm fuqinë e ujit për të vû në lëvizje gurët e mullinit. Lumejt tanë duhet të vejnë në lëvizje turbina të mëdha dhe atëherë fuqija e ujit do të shëndrrohet n'energji elektrike. Në këtë mënyrë do të nxirret visari prej ujit.

Do të mujshim me folë edhe për shum visare të tjera; për shembëll për ato në pyll, në argjil të thjeshtë e në këneta. Po, edhe nëpër këneta ka visare, bje fjala turbë. Vetë këneta mund të bâhet lehtë visar — mund të shëndrrohet në fusha pjellore ase në liqej, që »do t'u japin ujë« centraleve elektrike.

Poeti ynë i madh Valentin Vodniku i ka këndue visaret tona qysh para njiqind e pesëdhetë vjetëve. Ai këndoi se si njeriun e ushqejnë fushat, mineralet e tregtija; se si natyra na dhuron gjithshka, vetëm se nuk guxojmë me e humbë kohën kot...

3. Të kujt janë visaret?

N'atë kohë, para njiqind e pesëdhetë vjetëve shum gjana në botë dukeshin ndryshe. Visaret kanë qenë të njajta; por edhe ato ndryshohen me gjithë se nuk e diktojmë këtë gjâ mbrenda nji kohe të shkurtë. Njeriu dhe mënyra e tij e jetesës ndryshojnë mâ shpejt. Ndryshon rendi shoqnuer. Ata që nxjerrin visare prej toke i kanë pasë dikur duert e lidhuna e madje, jo vetëm duert, por edhe shpirtin e kanë pasë të lidhun me pranga. Atëherë edhe duert që nxjerrshin visaret nuk kanë qenë si sod. Edhe duert ndryshojnë. Sod ato nuk janë mâ vetëm — duer të thjeshta e të regjuna të njeriut. Sod duert janë — maqina. Këso duersh — maqina, që punojnë sod në fabrika nuk ka pasë para njiqind e pesëdhetë vjetëve. Atëherë, për shembëll, fuqitë prodhuese nuk kanë qenë aq të zhvilluame.

Njeriu atëherë punonte mâ tepër me vegla prej druni. Për maqinat gadi as nuk ka dijtë. Prandej atëherë nuk i duhej shum prej asaj gjaje, të cilën na a quejmë »landë djegëse«. Qymyri nuk përdorej. Hekurudhra nuk kishte ende. Avulli nuk vente ende në lëvizje maqina dhe lokomotiva. Njeriu atëherë dridhej ende para rrëfés sikurse para ndonji fuqije të panjohun. Ai nuk, dinte ende për fjalën »elektricitet« në kuptimin e vet të sodshëm — me gjithë se kjo fjalë âsht shum e vjetër. Atëherë kali ishte fuqija mâ e fortë punuese e përveç kësaj nuk kishte as rrugë të mjaftueshëme për me qarkullue me kuaj. Te na francezet kanë fillue me

ndërtue rrugë mâ të mira, e madje mbas vendosjes s'Ilirisë s'ashtuquejtun. Minerali i hekurit shkrihej në furra të vogla. Fjala »fabrikë« ishte e panjohun. Sikur atëherë të kishte fillue me punue ndonji fabrikë, do të duhej së pari me ua shpjegue njerëzve kuptimin e kësaj fjalije të re, njilloj si sod që duhet me shpjegue vazhdimisht se shka âsht plani ekonomik.

Edhe katundari ynë ka qenë njeri i kullukut. Çdo të dhetin duej të drithit âsht dashtë me ia dhanë zotnisë së vet — aristokratit ase ipeshkvit. Përveç kësaj, i âsht dashtë patjetër me punue n'ara të zotnisë për nji numër të caktuem ditësh në vjet, me bajtë drû e landë; dhe mandej i âsht dashtë me i ndërtue edhe muret e burgjet e qyteteve, ku e mbyllte aristokrati sa herë që të dëshironte.

Kà qenë mëkatë në qoftë se i shtypuni pyette: »Të kujt janë këto ara që po i punoj?« Ase: »A nuk âsht imi ky drith që korra«? Ase: »A thue gjithmonë duhet me dorzue bagëtinë që kam ushqye vete«?

Por njeriu që punonte kulluk as nuk i bânte vehtes pyetje të këtilla, sepse ai nuk guxonte me mendue mbi këtë gjâ. Te ky mendimi âsht shue shekuj me radhë. Gjithnji ia kanë mbushë mendjen se kështu ka qenë gjithmonë sikurse jetonte ai atëherë — dhe se kështu duhet të mbetet për gjithmonë. Sepse kështu âsht caktue qysh përpara me ligjet e zotit dhe të njerëzimit. Në botë nuk ndryshon kurrgjâ, kështu ka qenë gjithmonë, qysh prej fillimit.

Edhe sod nuk janë shrranjosë plotësisht rrjedhimet e kësaj edukate skllavënuese. Gjinden ende gjithnji njerëz; të cilët mendojnë se në botë me të vërtetë nuk âsht mirë, por prap se prap mâ mirë âsht ashtu sikurse âsht, dmth. të mos ndryshojë kurrgjâ. Në kohën e mâparshëme ka qenë mâ mirë. Dikur ka qenë shekulli i artë. Në qoftë se ka ndryshue ndonji gja, âsht bâ vetëm mâ keq. »Në botë gjithshka âsht mâ keq«, flasin ata. Natyrisht, ata nuk e dijnë që po i përsërisin rrenat qindvjeçare. Ata nuk janë të vetëdijshëm se këto rrena ua kanë shtî në krye të parëve tanë ata zotnij dhe ai kler antipopulluer, që gostitej në tryezat e pasuna aristokrate.

Edhe këta njerëz nuk marrin guxim për të pyetë: »Të kujt janë të gjitha këto vilsare që na rrethojnë? A nuk janë tonat? Pse nuk pasunohemi me ahën e tyre? Pse në botë të mos jetë mâ mirë? A thue na nuk mujmë me ndryshue kurrgjâ?«

4. Si duhet me i përballue pengesat në rrugën deri te visaret

Në viset tona kanë fillue mbas luftës së parë botnore me u ndërtue fabrika. Së pari âsht ndërtue nji në Gorenjsko, mandej edhe nji tjetër — dhe mâ në fund e gjithë krahina âsht shpallë për »vend industrijal«. Njerëzit nuk kanë dijtë se të kujt janë ato fabrika. Ato kanë lindë papritmas mû si këpurdhat mbas shiut. Kurkush nuk pyeste se si ndodhi kjo gjâ. Njerëzit vetëm kanë pa se këto qenkan fabrika tekstile. Pronarët e tyne merrshin puntorë me rrogë. Në të vërtetë, nuk i paguejshin mirë. E kush ka pague mirë? Gjithkund âsht keq. E mâ keq âsht kur nuk fiton kurrgjâ.

Në fabrikat e reja kanë punue shum prej njerëzve tanë. Por njerëzit tanë kanë qenë vetëm puntorë »të thjeshtë«. »Specjalistat«, mjeshtrit, drejtorat dhe të gjithë të tjerët, të cilët nuk ishin punorë, kanë qenë të huej. Ata i shiqojshin njerëzit tanë ashtu si i shiqojnë të bardhët »njerëzit e egër« nëpër kolonitë.

Kurkush nuk çuditej për atë gjâ që duhej të dukej me doemos si gjâja mâ e çuditshëme: në fabrikën që prodhonte e qitte vazhdimisht vagona me mall tekstili, punojshin puntorët dhe puntoret e veshuna si mos mâ keq.

Gjithashtu nuk çuditej kurkush sepse në këto fabrika punojshin maqinat e hueja, të cilat janë prodhue diku në Sudet, ku industrija e tekstilit ka qenë shum e zhvillueme. Atje janë demontue këto maqina, janë nxjerrë prej fabrikave dhe, në vend të tyne, janë vû të rejat. Ka ndodhë madje që ato fabrika janë dhe mbyllë, sepse atje puna zhvillohej në fabrikat moderne, ndërsa te na punohej me plot vrull me maqina të vjetrueme.

Prap se prap disa u habitën kur para dhetë tjetëve u pre çdo punë në fabrikën e Kranjës. Puna nuk âsht pre se ndoshta

nuk ka pasë mâ punë. Jo, puntorët e kanë lanë punën, mbassi fabrikanti nuk ka deshtë me ndî kurrgjâ për ato shka fliste puntorija mbi mëditjet e ulta. Puntorët e kanë dijtë mirë se te na vêhen në levizje maqinat e vjetra, mû për shkak se fuqija jonë puntore ka qenë çmue aq ulët, sa u kemi bâ »konkurencë« edhe fabrikave moderne në botën e jashtëme.

Puntorët kanë shpallë grevë. Âta nuk shkuen nëpër shtëpija, por kanë qëndrue nëpër fabrika. Nji gjâ e këtillë nuk ka ndodhë ende te na.

Dukë Natllaçenit, iu duk kjo gjâ e pashembëllt, e u autorizue të dredhë kërbaçin mbi puntorët tanë. N'atë kohë te na, në Bled e kalonte pushimin me kënaqësi vetëm njeriu që »punonte« mâ shum e që bânte përpjekjet mâ të mëdha në Jugosllavi. Kjo do të thotë: njeriu për të cilin kanë punue njerëz mâ shum. Ky njeri ishte gjithmonë akcjonari mâ i madh, pronari i fabrikave dhe i xeheroreve të panumërta. Nuk duhet me u habitë se ky në nji kohë ishte edhe kryeministër. Dukë Natllaçani iu drejtue atëherë atij njeriu të fuqishëm, Millan Stojanoviqit, të cilit i shkonte mbas e i shërbente nji ushtri e gjithë gjindarmësh. Duhet me bâ dishka, jo që puntorëve t'iu bâhet qefi, por që skandali të zhduket sa mâ parë.

Me i pushtue fabrikat — kjo âsht me të vërtetë në kundërshtim me të gjitha botëkuptimet e zotit dhe të njeriut! Ky âsht sulm kundra pronës private! A thue mund të lejojmë shkeljen e këtillë të qartë të ligjeve të përjetshëme?

Para njiqind vjetëve kanë folë gadi kështu aristokratët. Duhet me e ruejtë rendin e shejtë e të përjetshëm, që mbështetet në ligjet e zotit dhe të njeriut. Zoti ka vendosë që në botë duhet të ketë aristokratë dhe njerëz që punojnë kulluk — dhe se njerëzit e kullukut nuk mujnë me u bâ aristokratë.

Prandaj edhe sod, puntori nuk do të guxonte kurr me pyetë: »A thue në këtë mall, që po e prodhoj unë për tre dinarë n'orë, nuk do të kishja sa do pak dishka timen? A thue gjithmonë do të detyrohem me punue për fabrikanta, për pronarët tanë dhe të jashtëm kapitalista? A thue gjithmonë duhet me u lutë për shtimin e mëditjeve? A ta lus industrijalistin për të lidhë kontratë kolek-

tive me né puntorët dhe të marrë përsipër se do të sjellet me né si me njerëz?

Me gjithë se puntori ynë atëherë ka qenë ende skllav i mëditjes, ai prap mendonte me krye të vet. Kështu qëndron ndryshimi midis tij dhe të parëve të tij që punojshin kulluk. Ai âsht bindë se kapitalisti nuk jep kurrgjâ me dëshirën e vet. Ka pa se ligji respekton vetëm kapitalistin dhe rendin e vjetër — shfrytëzimin e njerëzve punues. Ka pa gjithashtu se bota ndryshon. Por kjo nuk ndryshon vetvetiu. Botën mund ta ndryshojmë na që punojmë. Puntori âsht bâ i vetëdijshëm për fuqin e tij. Ka pa se âsht i fuqishëm, vetëm atëherë kur âsht i bashkuem. Kapitalistat i mashtrojnë lehtazi vetëm puntorët e përçamë e në grindje me shoqi-shoqin, e jo kurr puntorët e bashkuem e të vetëdijshëm. Derisa puntorët të qëndrojnë në fabrika, kapitalistat nuk do të mujnë me na bâ kurrgja me ligjet e tyne.

Këto gjâ e kanë pasë të qartë edhe fabrikantat, të cilët i nderojshin aq shum ligjet e zotit dhe të njeriut. Për këtë gjâ ka qenë i vetëdijshëm edhe zotnija i pakufizuem i rendit »të papërmbysshëm«, përfaqësuesi dhe mbrojtësi i këtij rendi. Gjindarmët e Stojadinoviqit janë afrue natën deri te muret e fabrikës, kanë hypë mbi ta, hynë mbrenda dhe i sulmuen puntorët me dajak. Para kësaj, ata kanë hjedhë në mes të puntorëve gastare me gazna që të zanë frymën, të cilat u përhapën në të gjitha lokalet ku flejshin puntorët. Gjindarmët e bânë këtë gjâ për mbrojtjen e ligjeve »të përjetshëme« të zotit, në bazë të të cilave puntori duhet t'i nënshtrohet »zotnisë« — kapitalistit.

Pse po i tregoj të gjitha këto? Ndoshta ti vetë, që po e lexon këtë libër ke qenë atëherë në këtë fabrikë dhe e din mâ mirë se si ka ndodhë kjo gjâ. Por prap, të gjitha këto dhe shum gjana tjera duhet me i tregue, në mënyrë që të na kujtohet fjala jonë e urtë: »Mâ shum vlen me dijtë se sa me pasë«.

Këtu qëndron urtësija mâ e thellë e popullit. Me fjalë tjera: Mendja âsht visari mâ i madh, vetëm se duhet ta përdorim. Ajo na tregon rrugën kah mujmë dhe si duhet patjetër ta përmirësojmë jetën. Arsyetimi âsht arma jonë. Njeriu punues duhet të mendojë, sepse të menduemit ta tregon rrugën qysh përpara. Pa

mendime, pa vetëdije — nuk ka përparim. Të menduemit na i ka farkue armët me të cilat do të triumfojmë mbi anmikun dhe mo të cilat do t'ua çelim rrugën pasunive materjale dhe shpirtnore. Kjo armë âsht botkuptimi ynë mbi botën.

5. Gjithkush âsht farkatari i fatit të vet

Do të mujsha me shkrue nji tregim interesant dhe instruktiv. Afërsisht kështu:

Përveç...

Ka qenë nji shtet i fuqishëm. Para këtij dridhej mbarë bota, përveç vendit ku mbretnonte populli punues. Shteti i fuqishëm ka pasë me mija e mija fabrika. Shka kanë prodhue këto fabrika? Çdo gjâ tjetër, përveç gjanave të nevojshëme për popullsinë paqëdashëse. Me fjalë tjera, në këtë shtet nuk ka pasë popullësi paqëdashëse. Atje ka jetue vetëm ushtrija. Shteti ka pasë me miljona ushtarë t'armatosun deri në dhambë. Në të vërtetë këta nuk kanë qenë ushtarë. Ata kanë qenë maqina të çuditshëme që lëvizëshin vetëm simbas urdhnit. Maqinat që kanë masakrue, djegë, shkretnue.

Ky shtet ka pasë shum qinda mija qerre lufte që quheshin tanksa e kurrkush as nuk din se sa topa, aeroplana dhe armë tjera luftarake ka pasë. Gjithashtu nuk dihen të gjitha ato që mbaheshin të mshehta.

Flitej se ai shtet ishte nji maqinë e madhe ushtarake e tmershëme. Këtë maqinë të madhe ushtarake tmerruese e drejtonje nji njeri i ndershëm. Ai nuk i ngjante njeriut, sepse nuk fliste si njeri. Ai gati lehte si qen. E kur lehte, e ndigjonte mbarë bota përveç...

Në këte shtet ka pasë gjithshka përveç... Kanë pasë armë, maqina, djelmosha — dhe prap të gjitha këto ishin tepër pak. Kanë pasë gadi çdo gjâ, vetëm nuk kanë pasë mbarë botën, ndonse kanë dëshirue ta kenë. Kanë dashtë me ia vû zgjedhen krejt botës dhe do t'ia vejshin gadi krejt përveç...

Çdo gjâ do t'ishte mirë sikur të mos ish kjo »përveç«.

Kanë pasë çdo gja përveç njerëzve. Me fjalë tjera, nuk kanë pasë njerëz që të mendojshin me trunin e vet. Ka pasë shum maqina dhe skllavë. Pikërisht mbassi nuk kanë pasë njerëz, nuk kanë pasë kurr as mjaft skllavë. Nuk kanë pasë kurr mjaft maqina, skllavë, armë.

»Pse të mendojmë«, thojshin ata. »Po na kemi Führerin që mendon për né. Zoti na e ka dërgue dhe ai flet me anën e gojës së këtij. Zoti na e ka dërgue që të na çojë në vendin e premtuem si popull të zgjedhun. Na e kemi për detyrë me e pushtue mbarë botën, e këtë gjâ duhet ta ketë për nder secili që udhëhiqet prej racës sanë heroike. Zoti i dashtun ia ka dhanë të gjithë mendjen Führerit tanë. Na e kemi për detyrë që vetëm ta ndigjojmë Führerin, pa kurrfarë vrejtjeje. Hajl!«

Tregimin nuk duhet me e vazhdue. Ju të gjithë e dini mirë se si âsht përfundue ky tregim. Deshta vetëm me iu thanë se shka duhet të mësojmë nga tregimi i vërtetë — po qé se nuk e kemi ba tashmâ këtë gjâ. Ai që âsht »shkollue« prej okupatorit, e ka mësue tashmâ mirë këtë gjâ. Por jemi njerëz dhe harrojmë...

Ai tregim na mëson se njeriu e meriton emnin e vet vetëm atëherë kur mendon me kryet e vet. Çdonjani prej nesh duhet të dijë me mendue. Çdonjani prej nesh duhet të jetë njeri, e jo maqinë.

Pse? Ai që pyet kështu, nuk mendon.

Ai që nuk mendon nuk mundet as me punue mirë. Ai nuk mundet me dijtë se shka âsht puna. Ai nuk mundet me pa se në botë ndryshon çdo gjâ dhe se njeriu duhet të marrë pjesë në këtë ndryshim.

Secili prej nesh e ka ndonji detyrë. Çdonjani punon ase pregatitet për ndonji qëllim. Çdo njerí jeton prej punës. Çdo njerí merr pjesë në transformimin e botës. Me gjithë këtë, në këto ndryshime nuk marrin pjesë të gjithë ashtu si duhet. Na dëshirojmë që të gjithë të jenë të mirë, transformuesa të vetëdijshëm, ndërtuesa të botës.

A po e kupton tash fjalën e urtë popullore në dritën e ré: »Çdonjani âsht farkatar« i fatit të vet«! Secili që e kryen me vetëdije detyrën e vet, merr pjesë në veprën e madhe për lumnin e vet. Madje jo vetëm për ardhmenin e vet — por ai krijon e farkon edhe ardhmenín mâ të mirë për krejt komunitetin dhe për parardhësit e vet.

Prandaj do t'ishte me vend që të merremi vesh se si me fillue farkimin e visarit tanë.

Kreu i dytë

SHKA DUEM

1. »Nuk dihet se kush po pin as kush po paguen«

Tregimi më i pabesueshëm prej të gjithë të tjerëve do t'ishte kështu:

Një herë na kishte pasë vdekë një njeri. Kur filloi me jetue kaq mirë, mendoi se kurrgjâ tjetër nuk i duhej në botë, veçse një shtëpí e mirë. Prandej u vendos me të shpejtë në të. Mandej filloi me e ndërtue. Së pari i leu muret mirë me gëlqere. Mandej e mbuloi shtëpín, ndërtoi katin e parë, katin e poshtëm dhe më në fund vuni themelet. Mandej iu paraqit detyra që të sjellë landën e ndërtimit. Kur i pregatiti të gjitha këto, filloi me hartue planin serjozisht. Ndërkaq, ai u bâ aq i ri, thue se leu rishtazi. Ky padyshim qé mbarimi i jetës së tij frytdhanëse.

Ndoshta të gjitha këto ju dukën si ndonjë marrí, por a thue në botë nuk ndodhin ngjarje edhe më të pabesueshëme?

Për shembëll: në botë ka shum shtete. (Kurrgja e pabesueshëme)! Në disa nga këta shtete njerëzit jetojnë aq keq, sa qe në të vertetë as nuk jetojnë. (Kush nuk do ta dinte këtë gjâ!) Sa më keq jetojnë, aq më tepër kanë fabrika, fonde, qytete të mëdha, fusha dhe pyje të pakufí. Përnjimend, ata vetëm mendojnë se i kanë, por në të vërtetë nuk i kanë kurkund.

Fabrikat e tune punojnë me hov të madh. Pse? Mbushen depot. Ndoshta edhe fabrikat punojnë për këtë gjâ. Depot janë aty dhe duhet me i mbushë. Dyqanet tregtare janë gjithashtu plot me mall. Pse? Jo për të furnizue popullsinë me gjanat e nevoj-

shëme për jetesë. Sa mâ tepër mall të ketë, aq mâ pak ka asish që kanë mall. Mandej në fabrika préhet puna. Kjo âsht gjâ e mirë, apo jo? Pse të prodhojshin fabrikat, kurse prodhimet e tyne nuk i blen kurkush?

Mirëpo, sa mâ tepër fabrika të ketë, nga ato të cilat e kanë pré punën, aq mâ pak njerëz do të ketë që do të mujnë me ble mallna. Pse këta njerëz nuk duen mâ me e ble këtë mall?

Padyshim nga shkaku se t'ardhuna ka aq mâ pak, sa mâ i vogël të jetë numëri i fabrikave që punojnë. Njerëzit e papunë janë blemësa të dobët. Sa mâ pak njerëz në punë, aq mâ pak dhe blemësa, ase përkundrazi, sa mâ pak që të fitojnë njerëzit, aq mâ pak edhe do të blejnë. Pra, prodhime ka «për së tepërmi«.

Për së tepërmi? Po pse atëherë njerëzit janë lecka-lecka?

Pse lypin bukë ata njerëz, që janë t'aftë për punë? Pse fabrikat e presin punën? Pse në fusha rritet drithi »për së tepërmi«, sa që fusha e mbjellun »duhet« të livrohet përsëri?

Apo ndoshta ende nuk je tue e kuptue tregimin mbi njeriun që ka vdekë mâ parë, e mandej ka fillue me jetue?

A thue e kanë dijtë njerëzit se shka po bâjnë kur kanë fillue me mihë visare pa masë? A thue a kanë pyetë se sa mall nevojitet në të vërtetë dhe se kush do ta blejë në të vërtetë atë mall? Jo, kjo gjâ nuk i ka interesue. Ka qenë gjâ kryesore se sa do të fitojnë, sa do të jetë fitimi. Asht dukë se fitimi do të jetë i mirë, sepse çmimet atëherë kanë qenë të nalta. Por kur malli âsht bâ »për së tepërmi«, u krijue »rreziku« i uljes së çmimeve të mallit. Shka duhet me bâ që të mos ulen çmimet dhe që të mos zvoglohet fitimi. Në shitje nuk guxohet me pasë mall për së tepërmi. Që të mos ketë për së tepërmi, nuk guxohet me ua shpërnda njerëzve të zdeshun, të zbathun dhe t'unët, por duhet t'asgjâsohet. Me e djegë, me hjedhë në det, me e asgjâsuel

Duket se âsht largue përkohësisht rreziku dhe se fitimi ka mbetë i paprekshëm. Por ndonji herë mund t'agojë dita e vërtetë e gjyqit të njimëndët. Atëherë ndalet çdo gjâ, Njilloj âsht kjo punë si met'u prishë automobili papritmas dhe kurrkush nuk mundet me konstatue se pse ka trathtue motori dhe ke harrue me shique rezervoarin e benzinës, prej kah asht shterrë benzina — që, kështu

i shterret fryma edhe zotnimit kapitalist. Në kësi rasti thuhet se âsht shkaktue kriza. E kriza ekonomike në shtetet e mëdha kapitaliste paraqet nji varg thyemjesh, që quhen falimentim ase disfatë.

Ndodh edhe kjo që kriza të fillojë me kërcitë dhambët e njerëzit mendojnë se a do t'ishte e mundun me e largue. Atëhere thirret kështilli i madh. Kjo ndodh rregullisht atëherë kur nuk dihet mâ se »as kush pin, as kush paguen«. Kur kaosi mbërrin kulmin, fillojnë këshillimet se si të rregullohen të gjitha përsëri; jo për t'u largue kaosi, por që të nxjerret prej këtij nji fitim sa mâ i madh. Fillohet krijimi i planit, sikurse e ka krijue pronari, të cilit ia kanë shitë pasuninë n'ankand, e ai mendon: »Atje do t'i mbjellsha dhetë sheka grunë, sikur toka t'ishte edhe e imja«.

Këtê desha me thanë: Kur rrobaqepsi pren rroben, ai e din shum mirë se shka mendon me qepë. Kur katundari livron, ai e din gjithashtu se shka do të mbjellë. Përpara se të fillojnë muratorët me e ndërtue shtëpinë, dikush ua përpilon planin. Çdonjani duhet të dijë se shka don. Edhe farkatari e din se shka do të farkojë kur fillon me rrahë me çekiç hekurin e skuqun. Por në shum shtete punohet si ai njeriu i tregimit tanë që mâ parë vdiq, e mâ në fund lindi. Mirëpo, na punojmë simbas planit.

2. Këtu do të mbjelli grunë«

Të dielën para dreke katundari Bujk rrinte nën hijen e plepit dhe lexonte fletoren bujqësore. »Plani ynë pesëvjeçar ka fillue. Kemi fillue ekonominë me plan«, po lexonte ai.

— Ivan, hajde këtu! — e thirri të birin. — Nuk po kuptoj kurrgjâ mâ. Shka âsht ky — Plani pesëvjeçar?

— Qe, babë, ky âsht kështu... Qé, edhe ti e ke planin tand...

— Shka kam? Mê të vërtetë kam ara, kam edhe disa kullosa, e bjeshkët po i shiqoj prej së largut.

— Plani nuk âsht bjeshkë. Plani âsht skica jonë ekonomike. Me njiherë do ta shpjegoj krejt çashtjen. Kur ndërtuen te na shtëpinë e zjarmfikësave, mjeshtri ma parë hartoi skicën. Vizatoi

shtëpinë e zjarmfikësave. Ai vizatim ka qenë plani. Por këtu âsht fjala për projekte tjera. Për shembëll mbi projektin ase planin ekonomik. Në projektin ase preventivin e këtillë, janë parapa dhe të gjitha llogaritë, për të dijtë se shka do të punojmë dhe sa duhet të prodhojmë, për të mujtë me qeverisë drejt.

— Dokrra! Kush e din se shka do të punoj unë! Sa drû do të pres në pyll! Kush mundet me i shkrue të gjitha këto!

— Kjo gjâ nuk âsht e nevojshëme. Asht llogaritë vetëm se sa mundet katundari me prodhue afërsisht, e dihet se sa âsht prodhimi për nji hektar. Qé, mandej asht llogaritë se sa gjana duhet me prodhue në vjetin e ardhshëm në mënyrë që të ketë mjat për të gjithë.

— E kush do të më »komandojë« mue se shka do të mbjell! N'arën ku kam pasë mbjellë patate kësaj vere, do të mbjellë grunë në vjeshtë dhe — amin!

— E sheh, edhe ti e ke planin tand! Qysh përpara e din se ku do të mbjellish dhe sa tokë mendon me punue.

— Shka i intereson atij, edhe në qoftë se e kam! Ndoshta unë jamë vetë zotni në tokën që punoj! A mos nuk e paguej tatimin me nder?

— Po, babë, por kosën dhe pllugun nuk mundesh me i mbarue vetë. A thue nuk t'intereson se sa kosa, pllugje, veshmbathje dhe gjana tjera të ndryshëme do të prodhohen në fabrika? Shka do të thojshe sikur të të nevojitej kosa, e ti të mos mundeshe me e blé?

— Ekonomi e mirë shtëpijake qënka kjo, kur njeriu nuk mundet me ble as kosën as shatin, kur i nevojiten!

— E sheh, për këte arsye tash bahet edhe planifikimi, e kjo do me thanë me qeverisë shtëpinë me plan. Sikurse ty t'intereson që fabrikat të prodhojnë mjaft mall për të ble ti, ashtu dhe puntorëve u intereson shum se sa po jep ti dhe sa ke me dhanë.

— Kush do të të kuptojë! Shka planifikojnë aty disa?

Në gërmadhat që kanë lanë Gjermanët?

— Me planifikue do me thanë me punue mbas planit. Duhet me qeverisë simbas planit, sepse qé, edhe ti po e mbjellë grunin, ashtu si e ke parapa. Kjo gjâ të duhet, në mënyrë që të mundesh

me e ble kosën kur të të duhet, e madje edhe që ajo të jetë e mirë dhe e lirë. Duhet me qeverisë simbas planit, në mënyrë që na katundarët të kemi njaft pleh artificjal dhe gjana tjera të ndryshëme që na nevojiten me doemos, po qe se dëshirojmë me përparue. Çdo gjâ duhet të punohet me mend. Çdo gjâ duhet me u llogaritë përpara. Kush âsht i mençëm ka me punue vullnetarisht, në mënyrë që çdo gjâ të bâhet sikurse âsht parapa e llogaritë me plan. Kush nuk ka mend nuk do të guxojë me punue simbas kryes së vet të marrë. Edhe kali ynë duhet me e tërhjekë qerren kur ta ngjesim në të.

— Shka do me thanë me këtë, se unë nuk qenkam i mençëm? Rinija po flet sod tepër. A thue përvoja jonë nuk âsht kurrgja? Kur kam qenë unë i ri...

— Babë, nuk duem të flasim tash se si ka qenë dikur. Tash âsht ndryshe. E madje edhe kështu si asht nuk guxon të mbetet. Duhet të punojmë me mend, në mënyrë që të jetojmë mâ mirë. Duhet të punojmë edhe të jetojmë me mend.

— Do tá shohish ti se si punohet kur do të të duhet me derdhë mund në këtë pasuni. Kurrfarë plani nuk do të ndihmojë, në qoftë se nuk do të dijsh me i përvjelë duert.

— Po prandaj e kemi edhe planin, në mënyrë që të dijmë me i përvjelë mirë duert në mënyrë që të mujmë me u mësue për të punue sa mâ mirë. Nuk âsht fjala këtu për të punue mâ randë, por që efekti i punës të jetë mâ i madh, e na të punojmë mâ pak e mâ lehtë. A thue na duhet të lejojmë që arën ta mihim me shat, kur kemi pllugje? E pse të lavroj të gjithë mitën me pllug, kur mundem me lavrue me traktor për nji orë? Pse, sod, që, na e fshijmë grunin me maqina, ndërsa ju dikur e keni fshî me shtypësa?

— Po traktori a do të na japë pleh?

— Jo traktori, por do të na japin lopët. Ti vetë e din shum mirë se lopët na japin mâ shum pleh dhe madje pleh mâ të mirë se sa kuajt. Lopët hanë shum mâ pak dhe prej këtyne kemi mâ dobi. Natyrisht, na duhen edhe kuajt, por ata do t'i përdorim mâ pak, sepse do të lavrojmë me traktora, e do t'udhëtojmë me automobila. Me traktor do të nxjerrim edhe drû prej pyllit.

— Do t'udhëtojsh me automobil? Qysh nesër do ta blesh, apo jo?

Sa mâ parë ta plotësojmë planin, ase Planin tanë pesëvjeçar, aq mâ shpejt do të kemi mjaft traktora. Natyrisht, çdo katundar nuk do ta ketë traktorin e vet dhe automobilin e vet. Disa nuk kanë as vegla për shuemjen e zjarmit, por këto i kemi të gjithë së bashkut. Të gjithë do t'i përdorim traktorat, e madje ndoshta edhe disa kamjona; e të gjitha këto do të jenë pronë e përbashkët.

Nuk due të të ndëgjoj mâ. Padyshim âsht mëkat që po ndigjoj gjana të këtilla ditën e dielë. Mos mendo kurrsesi se kësi gomari të vjetër do të mundesh me e bâ bolshevik.

3. Tregimi interesant nuk qe shkrue asnji herë

Ndoshta nuk ka përfundue ende grindja në mes të babës dhe të birit. Por ajo nuk na intereson mâ. Do të na duhej shum letër, sikur t'i përshkruejshim të gjitha grindjet e këtilla. E mb'anën tjetër edhe letrën duhet me e përdorë me mend.

Na nuk do të zehemi. Nuk kemi kohë për ta humbë kot. Duhet të bisedojmë shum shpejt mbi faktin se shka âsht parapa dhe shka âsht llogaritë në Ligjin mbi Planin pesëvjeçar. Po themi në ligj. Jo në ligjin e vjetër të padrejtë, por në ligjin tanë populluer. Ky ligj âsht pikërisht si ndonji tregim shum interesant — mâ interesant se këtë nuk ka shkrue kurkush ende deri tash. Asnji tregim nuk ka hy ende deri tash aq thellë në jetën tanë sikurse ky.

A e din shka do me thanë zbatimi i këtij? Me fjalë tjera, ky tregim duhet të bahet njimendësí.

Ky realizim do me thanë se mbrenda pesë vjetëve t'ardhshëme do të përparojmë mâ tepër se sa për pesëdhetë vjetët e kalueme.

Me fjalë tjera, jeta jonë do të zgjatet për nji gjysëm shekulli. Me jetue për dishka, do me thanë me ia mbërrijtë dishkafes. E na mbrenda pesë vjetëve do t'i mbërrijmë këto gjana, të cilat ndryshe nuk do të mujshin me u mbërrijtë as për dheta vjetë

me rradhë. Mbrenda pesë vjetëve do të zhvillohet ekonomija jonë e re, e me të do të zhvillohemi edhe na. Do të bâhemi njerëz të tjerë. Do të mendojmë dhe do ta ndjejmë ndryshe vetvehten. Jeta për né do të thotë shum mâ tepër, sepse atë do të dijmë me e çmue ndryshe.

Si do t'ishte te na për pesëdhetë vjetë, ase si do të jetë për pesë vjetë. A nuk dëshiron me qenë ndryshe? Kështu që çdonjani prej nesh të gëzohet për jetën si për ditën mâ të bukur?

Sharlatanët dhe sofistat mendjehollë kanë shkrue dikur libra dore se si do të bâhesh i lumtun dhe i kënaqun në mënyrë të lehtë. Kanë shkrue se kinse gjatë jetës nuk nevojitet kurrgjâ tjetër, veçse me ble nji libër t'atillë dore, e në këtë mënyrë ke me e plotësue detyrën tande jetësore dhe je bâ i lumtun. Janë zbulue para teje të gjitha sekretet e jetës dhe i din përmendësh të gjitha përvojat, simbas të cilave duhet të jetojsh.

Tash kemi librin që na mëson me të vërtetë se si duhet të jetojmë. Ai libër përmban ligjin mbi t'ardhunat tona. T'ardhunat do të barazohen simbas këtij, në qoftë se na do të shkojmë simbas ligjit që na e tregon libri. Ai ligj i ka zhdukë të gjitha »ligjet e zotit dhe të njeriut«, të cilët janë përpjekë me pengue të gjithë zhvillimin e njerëzimit. Simbas ligjit tanë ndryshon çdo gja. Ky âsht ligji i ndryshimeve të mëdha.

Prej të vòrfënve mâ të mëdhej, të cilët janë detyrue me kërkue fitim në mbarë botën ase me vuejtë te shtëpija në tokën »shterpë«, do të bahemi pasanikë. Vendi ynë do të shëndrrohet nga vendi bujqësuer në vend industrijal.

Cili âsht ndryshimi në mes të vendit bujqësuer dhe industrijal. A mos ndoshta deri tash nuk ke jetue në vendin bujqësuer, e nuk e din ende këtë ndryshim? Ktheu pak mbrapa dhe shiqo se si âsht në të vërtetë në vendin bujqësuer!

Shumica e populsisë ushqehet me produktet bujqësore, me ato produkte që i jep toka e punueme keq (shka do me thanë se jetohet në skamje). Por toka punohet keq nga shkaku se vendi bujqësuer nuk ka industrín e makinave; nga shkaku se nuk e përdor plehun artificjal; nga shkaku se nuk ka mjaft pleh ahrash;

pse nuk ka gropa të rregullueme për pleh, pse nuk ka bagëti, pse nuk ka mjaft ushqim për bagëti; pse nuk ka mjaft sillose për ushqimin e bagëtisë. Që katundari të mundet përgjithësisht me ble produkte industrijale (të fabrikave), i duhet patjetër me shitë sa më tepër produkte të veta, bujqësore e në këtë menyrë as ai vetë nuk ka bukë të mjaftueshëme, edhe pse e prodhon. Njerëzit jetojnë në shtëpija të pashëndetshëme dhe të ngushta. Në shtëpijat e këtilla vdes nji numër shum i madh fëmijsh të vogjël. Njerëzit nuk dijnë shka âsht drita elektrike dhe ju duhet shum me e kursye dritën e dobët. Ata nuk dijnë fare se shka janë maqinat me motor elektrik. Janë të veshun keq. Prodhimet bujqësore, në krahasim me ato industrijale, janë aq të lira, sa që katundari me të hollat që merr për ato nuk mundet me ble as veshmbathje e as veglat e nevojshëme. Në shkollat e mesme shkollohen rrallë fëmijt e katundarëvet; janë të shumtë edhe ata që nuk mujnë me vijue rregullisht as shkollën fillore. Njerëzit lexojnë pak. Për libra dhe revista nuk kanë të holla, e bile as interesim. Skamja dhe padija i randojnë njerëzit. Ata as nuk mendojnë se jeta mund të ndryshohet — të përmirësohet. Aq ma pak mendojnë se ajo patjetër do të përmirësohet. Njerëzit »e pajtuem me fatin e tyne« presin vetëm vdekjen, sepse besojnë se do të shpërblehen mbas vdekjes për të gjitha mundimet.

Kështu âsht pra në vendin bujqësuer. Në vendet industrijale, ku fabrikat janë pronë e industrijalistave (kapitalistave), njerëzit gjithashtu nuk janë mirë. Por atje jetojnë shum puntorë, të cilët jetën e shiqojnë ndryshe. Puntori e din që ndryshon çdo gjâ. Puntori i vetëdijshëm e din se rendi shoqnuer zhvillohet nën ndikimin e asaj gjaje që e quejmë »prodhim«, nën ndikimin e mënyrës së prodhimit dhe të përvehtësimit të pasunive. Derisa nuk ka pasë maqina, nuk ka pasë as kapitalista as fabrika. Nuk ka pasë as kapitalizëm, as klasë puntore. Qeverisja kapitaliste nuk âsht e përjetshëme. Aristokratët besojshin dikur thellësisht se sistemi i kullukut do të mbetej për gjithmonë. Madje edhe sod disa përfaqësuesa të kapitalizmit dëshirojnë me i bindë njerëzit se nuk âsht e mundun me e asgjasue rendin kapitalist. Por, Revolucjoni i madh në Rusi ka provue se kjo gja âsht rrenë, e qenja

e Bashkimit Sovjetik i hjedh poshtë dita ditës rrenat e tyne të marra.

Kur kapitalizmi bâhet pengesë për zhvillimin, ai patjetër do t'asgjasohet. Atëherë të gjitha fabrikat dhe të gjitha mjetet për prodhimin e mallnave kalojnë në pronën e përbashkët (kolektive) të të gjithë njerëzve. Me këtë rast shteti bujqësuer duhet të shëndrrohet në shtet industrijal, sikurse âsht ky i yni. Në rendin socjalist, ku populli âsht pronari i mjeteve të prodhimit, nuk mund të qëndrojë mâ mënyra e vjetrueme e prodhimit të mallnave.

Por të gjitha nuk mund të ndryshohen për nji ditë. As nuk mund të ndryshohen vetvetiu. Mbrenda këtyne pesë vjetëve do të ndryshohen mjaft shum gjana, por jo vetvetiu. Na do t'i ndryshojmë.

Shka do të ndryshojë te na?

Kjo nuk mund të tregohet me nji të marrun frymë dhe prandaj due ta shpjegoj me anën e shifrave. Liĝji mbi ardhmeninë tanë âsht shkrue me shifra, e ky libërth ka për qëllim që të shpjegojë se shka tregojnë me të yërtetë këto shifra.

4. Tregimi për bukën e bardhë

Ndoshtë mâ tepër të pëlqen tregimi për bukën e bardhë se sa për shifrat e thata. Te na shum rrallë âsht shtrue në tryezë buka e bardhë. Asht shtrue vetëm atëherë kur ka qenë festë. Kur të vobegtit andrrojshin për jetën mâ të mirë, ata mendojshin vazhdimisht për bukën e bardhë. Kanë folë: »Në botë do të jetë mirë atëherë, kur të gjithë të kemi mjaft bukë të bardhë!« Kur vdiste i vobegti e ngushllojshin: »N'atê botë do të kesh mjaft bukë të bardhë«.

Të hypim në tren dhe të nisemi! Për ku? Atje ku ka mjaft bukë të bardhë. N'atê botën tjetër? Jo, në botën tanë! N'ardhmenin tanë!

E ku jemi tash? A nuk jemi në »botën tanë«?

Jo. Udhëtimi do të vazhdojë pesë vjetë — deri në stacjonin e parë, ku sigurisht nuk do të vonohemi. Lufta për botën tanë quhet përmbushja e Planit pesëvjeçar. Atëherë bota do të jetë

gjithnji mâ tepër e jona. Pse? Visari ynë gjindet ende thellë në gërminë. Asht i yni, por prap se prap nuk âsht ende në duert tona.

Katundari do të thotë: »A thue nuk âsht i imi drithi, të cilin e prodhova vetë? Pse buka e këtij drithi të mos jetë e imja?«

Katundari âsht pjestari i komunitetit të madh që quhet shtet. Në këtë komunitet puna âsht e ndame. Katundari lëvron, farkatari farkon, xehtari nxjerr xehe, muratori bân mur, ingjinjeri vizaton plane dhe udhëheq punimet. Çdonjeni punon dishka të dobishëme. Por nuk mundet gjithmonë me punue duerthatë. Na nevojiten veglat. Shum gjana mund t'i prodhojmë vetëm me anën e maqinave. E shka të bâjmë, në qoftë se nuk kemi maqina e në qoftë se nuk kemi fabrika që do të prodhojnë maqina të këtilla?

Jemi të shërtnguem me ble maqina jashtë shtetit tanë.

A do të mundet katundari me ble produkte industrijale, në qoftë se nuk i jep këta produkte të veta? A asht e qartë se duhet patjetër të japë produktet e veta për ato industrijalet. Duhet të japë aq produkte, sa vlefta e tyne të mbërrijë vleftën e produkteve industrijale.

Shteti blen n'atë mënyrë, tue e dhanë mallin për mall. Sa mâ tepër mall të ketë — aq mâ lehtë mundet me ble.

Komuniteti ynë i madh, shteti, nuk ka ende gjithshka i duhet. Atij i duhet patjetër me ble shum maqina dhe landë të para. Me shka i blen këto? Me drithë, dru, xehe, bagëti — me ato shka ka.

Drithi, që ka prodhue katundari, a asht me të vërtetë i tij, kur atij i duhet me shitë gjithmonë sa do pak, por dishka nga ai drithë për të mujtë me ble rrobe, vegla, pleh, krypë dhe të gjitha gjanat tjera që i nevojiten për jetën dhe punën e përditshëme?

Minerali që nxorrëm a âsht i yni; po druni që premë në pyjet tona a asht i yni, a asht e jona vena që prodhuem në vneshtat tona — në qoftë se duhet me ble maqina që nxjerrin xehe, maqina që punojnë tokën, maqina për përpunimin e drunit dhe shum gjana të tjera?

Jo, të gjitha këto nuk janë plotësisht tonat. Kur të mos kemi ma nevojë me ble maqina, sepse do t'i prodhojmë vetë, — veçanisht kur t'i prodhojmë mâ lirë se sa i paguejmë sod — atëherë do të jetë e jona e tanë buka e bardhë e drithit të fushave tona.



»Pesë vjetë do të vazhdojë kruga — për ndërtimin më të mirë.«
Atje do të mbërrijmë në rrugët e reja që po i ndërtojmë.

Ky âsht tregimi për bukën e bardhë. Ky âsht tregimi për — shifrat. Shifrat janë shkrue në Ligjin tanë mbi Planin pesëvjeçar. Ato na tregojnë se sa xehe dhe sa qymyr duhet të nxjerrin xehtaret tanë, në mënyrë që të mundemi me u bâ zotnuesà të plotë të visareve të tokës; shifrat na tregojnë për atë shka duhet të bâjnë punëtorët tanë, në mënyrë që fabrikat të prodhojnë sa mâ tepër produkte të ndryshëme që iu nevojiten katundarëve, puntorëve dhe njerëzve tjerë punuesa. Shifrat tregojnë mbi sasinat e mëdha t'energjisë elektrike, që do të bahen shpirti i fabrikave tona, kur në to të vehen në lëvizje maqina të shumta. Shifrat na tregojnë se si do të zgjaten hekurudhat tona dhe se si trenat do të vrapojnë me vrull shum mâ të madh. Këta trena do të shkojnë shum mâ shpejt. Do të kemi mâ tepër lokomotiva dhe vagona. Do të transportojmë shum mâ tepër mallna. Shifrat flasin gjithkund për jetën dhe punën, sepse tash nuk kemi ende nji jetë të vërtetë: ato flasin mbi nxjerrjen e visarëve që tashmâ na presin në çdo vend. Flasin mbi fitoret duhet me i korrë ende.

5. Mrekullina t'atilla që nuk kanë ndodhë ende

Diku në nji katund maluer ishte nji grumbull i madh trupash dhe pritte se do t'i gdhendë ndokush. Por puntorë nuk kishte. Nuk kishte as ujë për me e vû në lëvizje sharrën. Në kohën e vjetër — e kjo nuk ka qenë aq larg — puntorët kanë nxjerrë drrasa prej trupave me anën e sharrës së madhe e të thjeshtë të dorës. Ka qenë e nevojshëme me e tërhjekë këte tre puntorë, e madje me mundime bukur të mëdha. Njeni rrinte përmbi trupin e çuem naltë në skelë, e dy të tjerët përfundi tërhiqshin sharrën për dorëze. Këta sharraxhij as nuk kanë mendue se në botë do të bâhej edhe aso sharre, e cila ka me sharrue vetiu. Kjo gjâ do t'iu dukej për së tepërmi mrekullí e madhe, e për tê nuk do të mujshin me besue as në andërr.

Tash sharraxhiu i po atij katundi maluer, që âsht pesëdhetë kilometra larg lumit, uji i të cilit i ven rrotat në lëvizje, ka thirrë puntorët që t'ia çojnë trupat. Ka vû në lëvizje vetëm maqinën, e aty kanë qenë puntorë të padukshëm dhe shum të fuqishëm. Me njiherë kanë qenë të gatshëm për punë. »Dinamoja« u vû në lëvizje dhe filloi kangën. Rrypi i motorit filloi vallen, sharra filloi dhe e preu trupin.

Në qoftë se âsht e nevojshëme, këta puntorë të padukshëm mujnë për nji çast me kalue nga njiqind kilometra. Ata vijnë për t'iu ndihmue katundarëve. Dijnë me vû në lëvizje maqinat fshise, pompat, maqinat që prejnë kashtën dhe nji numër të madh maqinash tjera që i përdor katundari. Ata punojnë vetë me maqina. Maqinat madje mjelin dhe lopët e qethin dhentë. Duket sikur maqinat lëvizin vetë. Kurkund nuk e sheh kazanin me avull, as motorin me benzinë; kurkund nuk duket as tymi mâ i vogël. Për këtê gjâ askush nuk çuditet. Madje edhe katundari, i cili tash për herë të parë e ka pa dritën elektrike, âsht miqësue me njiherë me këtê mrekullí. Drita elektrike ka ndriçue kasollat qindvjeçare, ku ndezej pisha dikur, para nji gjysmë shekulli.

Këto janë mrekullina që tê na po fillojnë me u ba qysh tash. Me të vërtetë, mrekullina që të parët tanë nuk kanë mujtë as me i mendue. Sikur t'ua kish thanë kush këtê gja n'atê kohë, pa dyshim nuk do të besojshin se âsht e mundshëme nji gjâ e tillë.

Zakonisht nuk pyesim se kush na i ka ba të mundshëme këto mrekullina. Aq më tepër na duket se kështu duhet të jetë patjetër dhe habitemi kur, për shembëll, pritet korenti elektrik. Kush na e ka dhanë dritën elektrike? Kush na ka mësue me bâ maqina? Kush i ka shti në punë maqinat që të na zavendësojnë në punë?

Përgjegja nuk âsht aq e lehtë. Nuk do të fitojshim shum, në qoftë se do t'i numrojshim emnat e shpiksave. Përgjegja bjen pikërisht në kuadrin e tregimit mbi bukën e bardhë. Në qoftë se njeriu do të shijonte bukën e bardhë, a do t'ishte mbasandaj i kënaqun plotësisht me bukën e zezë? Sikur ndokund të shëndritte lampa elektrike, a thue të gjithë njerëzit do të mendojshin se kurrgjâ nuk mund të ndryshohet në botë dhe se duhet të mbetet për gjithmonë si sod, sepse ky âsht rregullimi mâ i mirë?

Shpirti i njeriut âsht asi rebeli që ka kundërshtue gjithmonë çdo gja të vjetër dhe ka kërkue rrugë të reja. Vetë njeriu ka zbulue gjithshka që na lehtëson punën dhe zbukuron jetën. Këtij kurrgjâ nuk i âsht dhanë falas. Çdo gjâ âsht detyrue të shpikë dhe ta realizojë. Sa maqina ka sod, të pakten aq zbulime janë dashtë për të. Për çdo zbulim janë nevojitë shum përpjekje e përsosmenina. Njerëzit kanë vra mendjen e janë mundue me orë të tana. Janë nevojitë edhe flijime. Sa flijime, për shembëll, ka kërkue aeroplani para se sa i janë zhvillue njeriut krahët e sigurtë, me anën e të cilëve ka mujtë me u shkëputë prej toke!

Krejt shka ka realizue njeriu, âsht vepër e duerve të tij. Pa duer nuk do të mundte të zhvillohej as shpirti. Njeriu dallohet prej kafshëve shî pse ai përdor duert, për arsye se âsht drejtue dhe se ka fillue të punojë me duer. Kur âsht drejtue në kambë, ka fillue të ndryshojë edhe kafka e tij — ajo ka fillue të bâhet kafkë njeriu. Njeriu e ka trunin mâ të zhvilluem, se të gjitha qenjet e tjera të gjalla. Truni i tij âsht zhvillue me anën e punës. Për shkak të punës âsht zhvillue edhe të folunit e njeriut, mâ mirë me thanë mendimi i tij.

Kur âsht drejtue në kambë, njeriu ka fillue me hypë gjithnji mâ nalt në shkallët e zhvillimit. Ka fillue me korrë fitore dhe me ia nënshtrue vehtes së vet fuqit e natyrës. Së pari e ka nënshtrue zjarmin. Mandej ka zbutë ujin, i cili ka fillue me vû në lëvizje

rrotën e mullinit. Mandej ka nënshtrue erën, e cila âsht detyrue me grahë anijen me vela dhe me vû në lëvizje mullinin e erës, ndersa tash njeriu synon kah energjija atomike, që âsht e grumbullueme në pjesët mâ të vogla të materjes — n'atome.

Jemi marrë vesh se nuk do të flasim tepër në mënyrë shkencore. Në këtë kapitull kam dashtë vetëm me tregue se na e dijmë mirë se shka duem:

Duem që të jemi zotnues të të gjitha visareve tona; duem bukën e bardhë; duem me prodhue bukë për venten tanë; të nxjerrim xehe për fabrikat tona; të prodhojmë të gjitha llojet e maqinave që na nevojiten, e madje edhe t'atilla që na duhen në t'ardhmen; duem të jemi njerëz që meritojnë emnin — të shëndoshë, të kuptueshëm, të vetëdijshëm dhe të lumtun! Duem të jetojmë, të krijojmë dhe të përparojmë! Nuk duem që të vuejmë mâ në skamje, të topitemi në mosdije dhe dëshprim! Duem të jemi njerëz!

Kreu i tretë

DHE SHKA DO TË MBRRIJMË

1) Mbrenda pesë vjetve do të jemi dy herë më të pasun

Ndoshta pò të duket se nuk premtoj shum. Thuejse ka dy herë më tepër asish, të cilët s'kanë kurrgjâ. Skamnori*) që ka vetëm dy, do të ketë gjithësejt katër dinarë kur »pasunija« e tij të shumzohet për dy.

Me gjithë se Jugosllavija, për kah t'ardhunat e veta shtetnore, âsht në rradhën e shteteve të fundit, na me gjith'atë nuk jemi skamnorë. Shka janë t'ardhunat shtetnore? T'ardhunat shtetnore janë shumat e të të gjitha t'ardhunave që janë fryti i punës në nji shtet. Shteti ynë ka qenë deri tash, deri në vjetin 1939, vend bujqësuer. Bujqësija e mbrapambetun sikurse âsht e jona, padyshim nuk ka aq t'ardhuna sa do të kishte industrija shum e zhvilluame. Vetëm nji fabrikë e madhe mundet me prodhue mall mbrenda nji vjeti për disa miljonë dinarë. Në mënyrë që prodhimet bujqësore të munden me mbërrijtë nji vlefë kaq të madhe, âsht e nevojshëme që, në rradhë të parë, toka të punohet mirë.

Në vjetin 1939, t'ardhunat e Jugosllavisë kanë qenë çmue në 132 miliarda dinarë. Në qoftë se marrim që atëherë ka pasë afër 15,000.000 banorë, atëherë do me thanë se për çdo banor kanë ra nga 8.800 dinarë t'ardhuna shtetnore në vjet. Kjo do me thanë se kaq do t'ishin t'ardhunat e çdo njeriut në vjet, sikur t'ardhunat shtetnore të ndaheshin në mënyrë të barabartë në të gjithë po-

*) Skamnori — ai që lyp derë më derë.



»Korenti elektrik do të hâhet gjak i fabrikave tona.« Në mbarë shtetin po rreshtohen tashmâ shtyllat e largpërçuesave.

pullsin. Por, këto t'ardhuna atëherë derdheshin në xhepat e kapitalistavę. T'ardhunat shtetnore t'asaj kohe na shërbejnë si mjet për të pa se sa âsht çmue puna jonë — sa ka qenë vlefta e prodhimeve bujqësore dhe industrijale. Sikur vlefta e krejt prodhimit të mbetej aq e ultë si përpara, na do të mbetëshim me të vërtetë skamnorë.

Na nuk duem me mbetë skamnorë. Jemi zotue me kambëngulje se do të dalim ngadhnjyesa ndâj vorfnís dhe mbrapambetjes. Duem me i mbërrijtë vendet industrijale. Por me këtë âsht thanë shum pak. Vlefta e prodhimit tanë industrijal në vjetin 1939 ka qenë 3.378 dinarë për nji banor. N'industri bâhej vetëm 45% të të gjithë punës sanë, shka do me thanë as gjysma.

Por edhe mâ keq ka qenë sepse industrija prodhonte relativisht shum pak mjete të nevojshëme për prodhim, d. m. th. maqina, vegla dhe mjete që nevojiten për zhvillimin ekonomik mâ përparimtar; këso mjetesh industrija prodhonte vetëm 45% nga i gjithë prodhimi i vet. Duhet me përmendë edhe se vlefta e prodhimeve bujqësore ka qenë atëherë vetëm 63,8 miljonë di-

»Në komunitet duhet të punojmë të gjithë« — të gjithë do t'i gëzojmë frytet e punës.

narë a në vjetin 1951 do të mbërrijë naltësinë prej 96,7 miljonë dinarësh.

Unë nuk do t'i përdori shifrat aq shpesh, në mënyrë që të mos frigohesh prej tyne. Me gjith'atë ndoshta do t'interesohet ndokush se sa kanë qenë t'ardhunat shtetnore në shtetet tjera industrijale, por ata le të kënaqen me aq shka po ju them se Jugosllavija ka qenë në mes të shteteve të fundit. A je i kënaqun? Padyshim nuk je i kënaqun që kemi qenë aq të »përparuem«. Me gjithë këtë nuk duhet me mendue së t'ardhunat shtetnore në shtete me industri shum të zhvillueme mbërrijnë rregullisht shuma të nalta. Të marrim, për shembëll, Çekosllovakinë, që âsht nji ndër vendet mâ të fuqishëm industrijalë n'Europën e Mesme, me gjithse Sllovakija, nji pjesë e saj, âsht ende vend thjesht bujqsuer. Në Çekosllovaki ka gjithsejt dy miljonë banorë mâ pak se te na (dishka mbi 12,000.000). T'ardhunat shtetnore janë çmue në 160 miliardë kruna çekosllovake, e kruna vlen aq sa edhe dinari ynë.

T'ardhunat shtetnore te na do të hypin deri në vjetin 1951 në 255 miliardë dinarë. Nuk e dijmë se për sa do të bâhen Çe-

kosllovakët mâ të pasun mbrenda kësaj kohe. Por me gjithë këtë, a do t'i tejkalojmë? T'ardhunat tona shtetnore gadi do të dyfishohen, sepse 132 miliardë shumëzue për dy bâjnë 264 miliardë.

A thue se u mësove në këtë kapitull me llogaritë nga pak? Ndoshta e ke llogaritë se në vjetin 1951 t'ardhunat shtetnore do të jenë afër 16.000 dinarë për nji banor. Natyrisht, me rastin e kësaj llogarije nuk guxojmë me harrue se këto t'ardhuna shtetnore do të jenë me të vërtetë **popullore**, shka do me thanë se nuk do të humbin n'arkat e kapitalistaye dhe nuk do të dalin jashtë shtetit tanë.

Do të jemi, pra, dy herë mâ të pasun, për kah naltësija e t'ardhunave shtetnore dhe për kah vlefta e prodhimit. Kjo do me thanë se do të nxjerrim visare prej dheut për kaq e kaq miliarda në vjet. Do të nxjerrim visare për 255 miliarda — e madje jo në rrethin magjik, por në vendet tona të panumërta të punës: në xeherore, në fusha, në fabrika, në puntorina ...

2) Si të pasunoheni

Dikur shkruheshin receta se si njeriu mundet me u pasunue lehtë, si me thanë, për nji natë. Këto i kanë shkrue ata, të cilët kanë dijtë me hartue udhëzimin mâ të mirë »Si të mbetem i marrë përgjithmonë dhe »Pse nuk guxoj kurr me u bâ i mençëm?« Me fjalë tjera, të pasunit n'atë kohë nuk kanë pasë nevojë me u bâ të mençëm.

Tash dëshirohet që të pasunohet populli punues. Nuk do të flasim për llotarinë, e as nxitimin për ar.

Shka âsht pasunija në të vërtetë?

Pasuni janë frytet e punës me shumicë ase, si thomë na, pasunitë natyrore dhe prodhuese.

Kur jemi të pasun? Kur guxojmë të flasim për mirëqenjen? Mirëqenja mbretnon n'atë shtet ku shumica e mallit tu takon atyne që e krijojnë. Pasuni nuk ka n'ato vende, ku mallnat shum të mëdha — artikujt bujqësorë dhe industrijalë — grumbullohen në magazinat e spekulantave ndërkombëtarë e të hollat nepër banka, ndërsa me miljona njerëz jetojnë në skamje, sepse nuk

dijnë se shka do të bâhet nesër. dhe se ndoshta mos do të bashkohen me turmat miljonshe të njerëzve të papunë. Mirëqenja nuk âsht e mundshëme në shtetin kapitalist, sepse atje begatitë grumbullohen vetëm për t'i fitue disa njerëz. Atje nuk prodhohen gjanat e nevojshëme për jetesë, në mënyrë që t'u garantohet gjallnija të gjithë njerëzve punuesa e që kurkush të mos ketë nevojë me u mundue, me banue në kasolla dhe me u veshë dobët. Në shtetin kapitalist turmat punuese nuk mujnë kurr me u pasunue. Atje pasunohen vetëm kapitalistat, të cilët quhen miljonarë.

Si të pasunohen turmat punuese? Në shtetin kapitalist mund të përdoret fjala e urtë se »prej pune nuk âsht trashë ende kurrkush«, se kurrkush nuk âsht pasunue; edhe në qoftë se ka punue, me gjithse atje kapitalistat trashen prej pune ashtu si duhet — natyrisht, jo prej punës së vet, por prej punës së tjeterkujt. Atje njerëzit pasunohen mbassi përvehtësojnë frytet e punës së popullit punues. Na e dijmë se puna âsht burimi për çdo pasuni. Pa punë nuk ka as pasuni materjale. Pa punë nuk ka ushqim. Pa punë nuk ka kurrfarë sendi. Pa punë âsht e mundshëme vetëm vdekja.

Prandaj, mund të pasunohemi vetëm, në qoftë se punojmë. Të gjithë duhet të punojmë së bashkut. Pa punë të përbashktë nuk ka mirëqenje. Në shtetin populluer individi nuk mund të pasunohet. Mund të pasunohemi ose të gjithë ose kurrkush. Sa mâ parë të prodhojmë gjithëshka na nevojitet dhe aq sa na duhet, aq mâ parë do të pasunohemi. Kjo do me thanë se duhet patjetër të ndërtojmë dhe të prodhojmë sa mâ tepër dhe sa mâ shpejt. Po qe se dëshirojmë me pasë sa mâ tepër mall dhe sa mâ shpejt, duhet patjetër ta përmirësojmë sistemin e punës. Për nji prodhim mâ të madh, nevojitet nji punë edhe mâ e madhe. E kush duhet ta bâjë këtë punë? Natyrisht, duhet ta bâjmë na vetë. A do me thanë kjo se na nevojiten mâ tepër puntorë? Padyshim. Kemi nevojë, jo vetëm për puntorë të thjeshtë, por mâ tepër për fuqi puntore mekanike. Kemi nevojë për maqina. Kemi nevojë për mâ shum mjete për prodhim, mâ shum fuqi puntore dhe mâ shum vende të punës: — fabrika, xeherore, fusha. Përnjiherë duhet me

e fillue punën në shum vise; duhet me rëmihë visare sa mâ të mëdha.

Shka do me thanë kjo — me shti në punë sa mâ shum puntorë dhe në sa mâ shum vende?

Do me thanë se duhet patjetër të ndërtojmë fabrika, t'i zgjanojmë fabrikat e vjetra; të hapim xeherore të reja dhe t'i zgjanojmë të vjetrat; të ndërtojmë centrale elektriku dhe largpërçuesa... Qysh? Me shka? Kush do t'i japë të hollat për të gjitha këto punë?

Visari e lind visarin në sajë të punës. Puna sjell fryte, të cilat japin farën, në mënyrë që puna e re bâhet edhe mâ e frytshëme. Në qoftë se, për shembëll, katundari don me ndërtue shtallën, ai nuk guxon me i përdorë të gjitha ato gjana që i ka marrë me produktet e veta yetëm për t'i veshë dhe për gjana tjera të nevojshëme. Dishka duhet edhe të ndajë. Në qoftë se shteti don me ndërtue fabrika, ai nuk guxon me i përdorë t'ardhunat vetëm për rruga, shkolla, shtëpija, etj. Nji pjesë të t'ardhunave të veta fabrikat duhet ta kthejnë patjetër në qarkullim, dhe madje për maqina të reja, për seksjone të reja. T'ardhunat e xehereve duhet patjetër të na japin mundësi për zgjanimin e xehereve të vjetra dhe për hapjen e galerive të reja.

Kur të punojmë mâ mirë, në saje të përdorimit të metodave ma racionale të punës në fabrika dhe xeherore, kur të hyjë në punë sa mâ tepër fuqi punëtore dhe kur të punojnë mâ mirë fabrikat e furnizueme dhe të rregullueme, atëherë do të ketë mâ pak shpenzime të prodhimit dhe, si pasojë, edhe t'ardhunat do të jenë mâ të mëdha.

Pra, t'ardhunat duhet patjetër t'i investojmë n'asi punimesh, të cilët do na japin mundësi që t'ardhunat e nesërme të jenë sa mâ të mëdha; duhet të prodhojmë asi artikujsh për të cilët tash kemi nevojë ma shum për ta. E shka tash kemi nevojë mâ shum? Disa mendojmë se kemi nevojë mâ shum për rrobe. Mirëpo, na kemi nevojë mâ shum për maqina, na nevojitet mâ shum fuqija mekanike punëtore, që të mundemi me prodhue sa mâ lehtë gjithshka që sod kemi ende mâ pak.

Do t'ia mbërrijmë edhe këtij qëllimi. Në bazë të Planit, mbrenda pesë vjetëve, do t'investojmë n'ekonominë populloro 278,3 miljardë dinarë. Për disa njerëz fjala miljard âsht fjalë boshe. Por a e din se shka âsht miljardi? Po, — njimijë miljonë!

Merre me mend atëherë se prej sa miljona njerëzish punuesa përbâhemi na. Në shtetin tanë ka afër 15 miljonë banorë. Në qoftë se t'interreson, llogarite se sa do t'i duhej çdonjenit prej nesh me punue që të bâhemi mâ të pasun, që të kemi mâ tepër fabrika, shtëpija, maqina dhe produkte mâ të ndryshëme, Kaq e kaq miljardë — do me thanë kaq e kaq miljardë orë punë; kaq e kaq tonelata qymyr, xehe, hekur, çelik ciment, aq miljona tonelata landë të para, mija e mija vagona drithë dhe me qinda mija metër kub dru.

Të gjitha këto nuk âsht e mundshëme me i bâ pa fuqín krijuese puntore, pa njerëz që janë të vetëdijshëm se shka duen dhe të cilët dijnë me ia mbërrijtë qëllimit të caktuem. E këta njerëz janë visari mâ i madh, që i krijojnë të gjitha visaret e tjera.

3. »Do të shihni, dishka do të ndodhë«

Janë skeptikë ata që përqeshin: »E kush do t'ua japë të gjitha këto miljarda? Miljardat nuk janë vogëlsina që mund të gjinden në rrugë«. Disa njerëz te na mendojnë ende se arka e bankës âsht i vetmi burim i të hollave. Vetëm në qoftë se banka na jep të holla do të mundemi me ndërtue mure. Në qoftë se shteti don me ndërtue, ai duhet patjetër të marrë të holla nga arka e vet. E arka e shtetit âsht zakonisht bosh. Shtetet e vogla kanë hy borxh për së tepërmi dhe kanë mâ shum të daluna se sa t'ardhuna. Në qoftë se shteti i vogël don me bâ dishka të madhe, i duhet patjetër me marrë të holla hua prej shtetit të madh. Kështu mendojnë »ekonomistat« e tipit të vjetër.

Duket se ata ende nuk kanë pa gjithshka âsht ndryshue të na. Mbas shlirimit ata kanë folë me qellim të keq dhe në mënyrë profesjonale se do të shkaktohet »bankroti« (falimentimi), sepse »regjimi« i ka përlorë tashmâ të gjitha »mjetet« që i ka »trashigue«. Taksën e tatimit nuk e paguen tashmâ kurrkush; sipër-

marrjet e shtetit nuk ndihmojnë gadi kurrgjâ. »Mungesa« âsht shum e madhe. »Do të shihni, për së shpejti dishka do të ndodhi«.

Profetizmi i tyne u plotsue. Këte gjâ e kemi pa. Gadi i tanë shteti âsht bâ nji vend i madh i vetëm i punës. Kemi pa se si kanë fillue të punojnë fabrikat njena mbas tjetrës; xeheroret kanë fillue përsëri me dhanë xehe të ndryshëme dhe qymyr, me gjithse gjatë okupacjonit i kish mbulue dheu dhe uji. Nga gërmadhat u ndërtuen katunde, si në film. Urat u vunë mbi lumej. Trenat shkuen përsëri rregullisht edhe atje, ku para disa muejve ishin vetëm mbeturinat e hekurudhave të dikurshëme. Traktorat filluen me punue n'arat e lanuna djerrë, të cilat në disa vende nuk ishin thye për katër vjetë. Nepër qytete dhe në shum vende tjera mâ të vogla, filluen gadi në çdo hap, me u hapë themele të ndërtesave të reja. Për çdo ditë në të gjitha viset tona u ndërtuen gjithnji mâ tepër pullaze të rij me ngjyrë të kuqe.

Cila bankë na i dha të hollat për të gjitha këto? Kush na dha hua? A mos i muerrëm ndoshta reparacjonet?

Ai që mendon në krye kapitaliste — që mendon se të hollat janë visare, nuk mundet me gjetë padyshim përgjegje për këto pyetje.

Se shka janë të hollat në rendin kapitalist. Mundesh lehtazi me lexue në dizertacjonet e shumta shkencore. Sa mâ tepër që të lexosh, aq mâ pak ke me kuptue. Na nuk kemi nevojë me ça kryet me pikëpamjet shkencore mbi të hollat. Parja te na âsht mjeti ndihmës ekonomik. Queje si të duesh — njet pagese ase mjet shkembimi. Ajo na nevojitet si, për shembëll, shifrat kur jemi tue llogaritë.

Mund të themi gati se parja âsht vetëm njet ndihme për llogaritjen e vleftës së punës. Pa punë nuk ka produkte, e prandaj, as kurrfarë vlefte. Pa vleftë nuk mund të ketë as pare. Kur flasim mbi miljardat e dinarëve, do me thanë se me punë e kemi realizue të gjithë atâ vleftë, d. m. th. se aq miljarda do të jetë vlefta e punës që do të kryejmë.

Prandaj, parja âsht mjeti për matjen e vleftës së punës. Sikurse masim me tonelata sasinë e qymyrit të nxjerrun, me kilovatorë sasinë e korentit të prodhuem elektrik, me kilometra

gjatësinë e rrugës — ashtu dhe vleftën e punës ase të prodhimit e masim me të holla. Nuk mundemi me mbledhë në këtë mënyrë: një rrugë dhe dy shtëpi bajnë tri. Por mundemi me mbledhë kështu: ndërtimi i një rruge dhe i dy shtëpive do të kushtojë 10 miljonë dinarë.

Pra, prej kah i marrim të hollat për fabrikat, shtëpijat, hekurudhat e reja dhe për shum punime të tjera?

Në të vërtetë duhet të pyetshim se a âsht e mundun me ndërtue fabrikën vetëm me të holla.

Që të mujshim me ndërtue fabrikën, na nevojiten puntorë dhe materjal i ndërtimit. Për ndërtimin e fabrikës nevojitet koha e punës. Në fabrikën e re duhet me shpenzue landë dhe punë. Maqina âsht bâ prej metalit e jo prej të hollave. Që të mundemi me e bâ atë, duhet para së gjithash të kemi metal. Metalin e nxjerrim prej shkrijetoreve. Ai asht nxjerrë atje prej xehesh e xehet âsht dashtë të nxjerren prej dheut. Ato i ka rrëmihë xehtari. Atij i asht deshtë me hangër, për të mundë me i rëmihë. I âsht dashtë buka. Edhe ai që i ka farkue nuk mundet me punue pa bukë. Kjo do me thanë, mâ në fund, se dikush âsht dashtë të prodhojë bukë. Këtë e ka prodhue katundari. Shka deshtëm me tregue? Në qoftë se duem me ndërtue fabrikën, me bâ maqinën, me ndërtue rrugën etj., duhet patjetër të punojnë edhe mâ shum njerëz, jo vetëm në vendin e ndërtimit të fabrikës, të hekurudhës së re, ase në fabrikën për vegla të maqinave, por edhe në shum degë t'ekonomisë, në qoftë se jo edhe në të gjitha.

Të përpiqemi me e thjeshtësue çashtjen. Katundari ka dhanë drithin dhe ka marrë maqinën. Asht e qartë se ai mâ parë duhet të prodhonte drithë. Ndërtuesi i maqinës don bukë. E shka të japë për të?

Thamë se maqinën duhet ta shkëmbejnë me bukë. Në të vërtetë, ai për bukë ka dhanë vetëm vërtetimin se ka bâ maqinën. Ai vërtetim âsht — masa e vleftës së punës së tij, ase parja. Natyrisht, ndërtuesit të maqinës i âsht dashtë me punue për të marrë dishka.

Shka deshtëm, për me shpjegue?

Se për jetesë na duhen produktet bujqësore dhe industrijale. Ase, që njeriu të mundet me jetue, i duhet ushqimi si dhe mjetet për prodhimin e gjanave ushqimore dhe për krijimin e gjanave tjera të nevojshëme. Kjo do me thanë — ai që don me jetue, duhet të punojë patjetër. Pra, njeriu jeton prej punë, e jo prej pareve.

Na punojmë. Me punën tanë ndihmojmë që prej germadhave të ndërtohen vendbanime mâ të mira. Me punën e përbashkët kryejmë ndërtimin e fabrikave, të hekurudhave dhe të rrugëve, prodhimin e maqinave dhe të gjanave ushqimore.

Në qoftë se duem me ndërtue sa mâ shum fabrika dhe me hapë xeherore të reja, duhet patjetër të bajmë dishka qysh përpara. Nuk mjafton që të farkojmë dhe të shtypim mjaft të holla. Ai që don me pasë qymyr nuk e ndimon kurrgjâ, sepse ka aq e aq vaga për matje — në qoftë se këtë qymyr nuk e nxjerr kurrkush prej dheut. Vaga do t'ishte pa kurrfarë vlefte, në qoftë se nuk do të kishim visarë për t'i matë me të. Për fabriken e re na duhet cimenti, gëlqerja, hekuri, tulla, druni. Për xeheroren e re na duhen stabilimentet e xeheroreve.

Shteti nuk mund të ndërtojë fabrika, në qoftë se ka vetëm pare, e nuk ka landë ndërtimi dhe bukë për puntorët. Sa mâ tepër që të ketë produkte të ndryshëme bujqësore dhe industrijale, sa mâ tepër punime të ndryshëme të bahen, aq mâ tepër fabrika të reja do të ndërtohen.

4. »... Sunduesi i botës«

Kurr, pra, nuk do të besojmë se parja âsht vetvetiu sunduese e botës! Në rrena të këtilla i kanë tërhjekë njerëzit mjaft gjatë për hunde. Te matunit nuk âsht vleftë, prandaj as nuk mund të ketë kurrfarë fuqije, dhe kështu pra ajo, nuk âsht sundimtare.

Tregimi i vogël mâ poshtë do të na shpjegojë këtë gjâ mâ mirë.

Burri dhe grueja kanë prodhue nji fuçi venë. Kanë pasë dëshirë me e shitë, e aq mâ tepër për ta pi. Prandaj të dy vendosën kështu: venën do ta blejmë njeni prej tjetrit, sepse kjo

prap se prap âsht prona e tyne e përbashktë, e kanë prodhue vetë. Kështu do të kenë edhe të holla, edhe do të munden me e pi. Vena mbeti në fuçi, nuk e ndanë.

Për çmim u muerren vesht si kushrijt ndërmjet vedi. Le të jetë litra nji dinar! Nuk duem ndoshta me ia rrjepë lëkurën njeni tjetrit.

Mandej puna filloi. Kur donte me pi burri — i paguente grues, e kur gruen e merrte etja — i paguente burrit. Mâ në fund e shprazën fuçin plotsisht. Atëherë filloi llogarija. Kush ka pi mâ tepër? U zunë e u përfytën, derisa iu ra ndërmend se në bazë të fitimit do të dijnë lehtazi se sa ka pi secili.

— Numëro të hollat! — i tha burri ngadhnjyeshëm.

— Shka të numëroj, mbassi nuk kam asnji dinar — iu përgjegj grueja. Grueja u habit qysh herën e parë kur lidhen kontratën e shitblemjes, midis njeni tjetrit.

— Pra, e sheh, unë nuk kam pi fare!

— Krejt e ke pi vetë!

— E kush e piu litrën e fundit? A thue nuk âsht ky dinari yt, që ma dhe kur pive litren e fundit?

— E ku janë dinarët tjerë? A mos don me i mëshehë?

T'i lamë, le të zihen deri në ditën e gjyqit. S'ka kuptim me pritë derisa këta të dy ta zbulojnë të vërtetën që në fillim kanë pasë fuçinë me venë dhe vetëm nji dinar, dhe se, mâ në fund, nuk ka pasë mâ venë; për fat, iu ka mbetë vetëm dinari.

Para së gjithash neve me këte rast na ka interesue se si qarkullon dinari. Në qoftë se âsht në qarkullim vetëm nji dinar si dhe vetëm nji artikull konsumi, do të mbetet vetëm nji dinar, pa marrë parasysh se a e ka bâ të njajtën rrugë nji herë, apo

njiqind herë. Dinarin e njajtë mund ta përdorin njimijë vetë ase vetëm nji njeri — ai gjithmonë do të mbetet vetëm nji dinar, e kurr nuk bahet dy ose ndoshta njimijë. Por me rastin e këtij qarkullimi ndodh edhe dishka. Së bashkut me dinarin qarkullon edhe nji prodhim ase më shum prodhime.

Kur qarkullon ndonji prodhim, në saje të punës krijohet, për shembëll, prej xehes metali, e prej metalit maqina. Dhe, do të mujshim me thanë, prej buke bâhet xehja — ndonse kjo gjâ ende duket qesharake. Buka me këte rast âsht »mjet që ven në lëvizje« — landë djegëse që i jep mundësi xehtarit me hapë gropa. Kur të qarkullojnë kështu buka, xehet, metalet dhe maqinat, ndodh dishka: buka shëndrrohet në fuqi që rëmih xehe. Me qarkullimin e mâtejshëm xehet shkrihen etj. Çdo gjâ ndryshon vazhdimisht — prodhimi me prodhim. Në qoftë se prodhimi definitiv âsht maqina, qarkullimi nuk ka pushue ende: maqina do të prodhojë prodhime tjera.

Kjo do me thanë se prodhimet shumohen në saje të punës. Puna e mâparshëme e bân të mundshëme punën e ardhshëme. Kur nxjerrim ndonji visar, kemi krijue kushtet për me nxjerrë më lehtë edhe visare të tjera, ase — tue punue bâhemi më të pasun. Puna na ushqen. Sa më shum punë të bâjmë, aq më lehtë do t'i krijojmë ato që nuk i kemi ende ase që i kemi ende tepër pak.

Vetëm puna âsht burim i fuqisë dhe i pushtetit. Vetëm puna mundet me na shlirue prej mvarësisë nga ata që kanë në duer të tyne prodhime t'atilla, të cilat na nuk i kemi ende. Kur të prodhojmë na vetë maqina dhe kur të nxjerrim xehe vetëm për vehten tanë, kur të prodhojmë dru vetëm për vehten tanë, kur në pyjet tona të rriten lisat vetëm për ne — atëherë do të bâhemi të fortë dhe të pamvarun.

Kjo do me thanë, pra, sikurse âsht shprehë me shifra, se n'ekonomin popullore do t'investojmë më se 278 miljardë dinarë gjatë pesë vjetëve dhe se vleftën e prodhimit do ta shtojmë prej 116,5 miljarda dinarë (në vjetin 1939) në 266,7 miljarda dinarë (në vjetin 1951).

5. Cili âsht ndryshimi midis ... ?

A e din se cili âsht ndryshimi midis punës së shekullit të mesëm dhe të punës moderne? Në mes të trumpetes dhe të radjo-aparatit? Në mes të parmendës dhe të traktorit? Në mes të shportes dhe të kamjonit? Në mes të vorbës prej dheut dhe prej aluminit? Në mes të qerres dhe t' aeroplanit?

Pyetjet e këtilla në fillim duken të marra. Por kur të na duhej me zgjedhë pishen ose llampen elektrike, na do t'i kuptojshim me njiherë.

Para Luftës së dytë botnore te na ngjajshin gjana të pabesueshëme. Katundarët zgjedhëshin pishën në vend të dritës elektrike. Në katundet që ishin t'elektrifikueme, katundarët hoqën dorë prej dritës elektrike, sepse ishte shume shtrejtë. Filluen me përdorë përsëri gazin dhe pishen.

Po a thue drita elektrike nuk âsht përparim në krahasim me llampen e gazit? A thue nuk ndriçon mâ mirë dhe nuk âsht mâ e lirë? Fare qartë, në Jugosllavinë e paraluftës njeriu ka mujtë lehtë me dyshue në përparim.

Tashmâ nuk kemi nevojë me bâ pyetje të këtilla. Na e dijmë mirë se jeta âsht zhvillim. Jeta shkon vetëm gjithmonë përpara, e jo kurr mbas. Katundari nuk do ta hjedhë poshtë kurr mâ sakicen e hekurtë për të marrë në duer atë prej gurit. Nuk do t'i hjedhim poshtë trenat e të fillojmë përsëri me i shikue kuajt dhe gomarët dhe me e bartë mallin me anë të tyne, ashtu si Martin Kërpani krypën. Veqnat modernë nuk do t'i hjedhim në hekurishta të vjetra e të fillojmë përsëri me e endë pelhurën me dorë. Llampat elektrike do t'i hjedhim vetëm atëherë kur të zbulojmë burime mâ të mira të dritës, që nuk do të shpenzojnë aq korent dhe që do të ndriçojnë mâ mirë. Kur të kemi mjete mâ të mira për bartje, do t'i lamë trenat. Lokomotivën me avull do ta vorrosim atehere kur ta zavendësojë lokomotiva elektrike ase ajo me motor. Ndoshta do të kemi edhe lokomotivën atomike, e cila do të vehet në lëvizje prej energjisë atomike. Në mes të pishës e të llampës elektrike âsht ndryshimi aq i madh, sa në mes të shekullit të Mesëm dhe të shekullit të Vjetër. Që të formohej ky ndryshim, âsht dashtë patjetër të kalojnë shum vjetë dhe shekuj.

Shka ka kalue? Në vjetët e kaluem ka rrjedhë shum ujë. Sikur fuqija e këtij uji t'ish shfrytzue për punë, do të kryheshin vepra shum të mëdha. Në kohën e kalueme kanë jetue shum njerëz. Atyne patjetër u âsht dashtë të punojnë dhe kanë krye vepra madhështore. Njerëzit e kanë plotësue kohën me punën e tyne. E puna ka lindë mendime dhe idena të reja. Mendimi shkon gjithmonë përpara. Kur njeriu nënshtroi elektricitetin simbas dëshires së vet dhe shpiku llampën elektrike, mendimi nuk ka kërkue mâ rrugën e zbulimeve që prej gurit të shkrepi zjarmin — rrugë të cilën tashmâ kaherë e ka kalue. Mendimi shkon përpara. Por sikurse çdo rrugë që duhet ta ketë fillimin e vet, ashtu dhe çdo mendim duhet të fillojë prej atij mâ të ultit. »Prej gjasë së vogël bâhet e madhja.« Njeriu nuk ka mujtë mâ parë me gjetë kazanin e avullit, e mandej zjarmin. Nuk ka mujtë me njoftë energjinë atomike, para energjisë së nxehtësisë. Nuk ka mujtë me shpikë automobilin para qerres e lokomotives me avull.

Pra, e kemi të qartë se zhvillimi âsht përparim. Këtë nuk e pengon puna se në botë ka ende njerëz që e mohojnë përparimin dhe e shiqojnë jetën si kënetën e qëndrueshëme, e jo si lumin e kthjellët. Kush mohon përparimin, ai mohon edhe zhvillimin e kështu edhe vetë jetën. Njeriu i këtillë nuk sheh kurrfarë dallimi në mes të pishës dhe të llampës elektrike. Ai âsht i verbët dhe shurdh, dhe na nuk do të shtyhemi me të.

Na i besojmë përparimit. Dijmë se përparimi dhe puna janë të lidhun aq fort sa edhe Dielli e dita.

Kur t'i kryejmë shum vepra, e gjithë jeta jonë do të ndryshojë shum — do të përparojmë.

A mund të marrish me mend t'ardhmen që do ta krijojmë me duert tona? Shka do të ndryshojë? Ç'farë dallimi do të ketë në mes të jetës sanë të tashëme dhe t'ardhshëme? Do të dëshirojshim me dijtë se si do të jenë katundet tona t'ardhshëme, si do ta përdorim kohën, të cilën, padyshim, do të dijmë me e çmue edhe mâ tepër, sepse do të na zbulohen aq gjana të reja, sepse do të jemi edhe mâ të vetëdijshëm se koha âsht gjâja e vetëme që e marrim hua prej jetës. Jeta âsht mbrendija, e koha qarku — prej nesh mvaret se me shka do të përmbushet ky qark për — mbrenda.

Na interesón në se do të zgjatet dishka jeta e njeriut, sa do të përparojë lufta kundra vdekjes. A do të mujmë me hy ndopak ma thellë në mëshehtësín e jetës dhe me e shtý mâ tejë asgjasimin e organizmit të njeriut. Shka do të përmirësohet përgjithësisht.

Përgjegjen e këtyne pyetjeve do ta gjejsh në shifra, të cilat, të gjitha këto gjana, i përmbajnë në vehten e tyne dhe ja zbulojnë atij që din me i lexue. Po flas për shifrat e përparimit tanë. Në fillim bjen në sy dallimi në mes të shumave të vleftës së punës së kryeme para lufte dhe në vjetin 1951. Por mû në këtê dallim qëndron edhe ai hapi medhshtuer përpara. Sigurisht, nuk mjafton me bâ vetëm nji hap, në qoftë se kemi dëshirë me shkue përpara vazhdimisht. Nuk do të ndalemi. Po që të mundemi me përparue edhe mâ, iky hap i parë âsht vendimtar — Plani i parë pesëvjeçar.

Pra, shka do të mbërrijmë mbrenda pesë vjetëve të para? Do të bâhemi të pamvarun nga bota e jashtëme; do të krijojmë industrinë; shteti ynë do t'elektrifikohet; do të bâhemi të fortë ekonomikisht. Do të bâjmë nji hap shum të madh nga mbrapambetunija, nga »shteti katundar« në shtetin populluer, ekonomikisht të pamvarun.

Kreu i katërt

SI DUHET TË FILLOJMË

1. Kulshedra që përbin njerëz të gjallë

Tregimet e vjetra mbi kulshedrën përbindëshe janë edukative. Përmbajtja e tyne âsht kryesisht e njajtë. Dikur ka jetue nji kulshedër e tmerrshëme me shtatë krena, e njerëzve u âsht dashtë ta ushqejnë me mish njeriu. Atyne u âsht dashtë me i sakrifikue bijat e veta mâ të bukura. Kundra asaj kanë luftue shum trima, por të gjithë kanë mbarue në kabzherin e kulshedres, përveç njenit, mâ të mbramit, i cili ia preu »kryet« kryesuer. Me fjalë tjera, nuk ka qenë mjaft me ia këputë vetëm disa krena »të dorës së dytë«. Krenat e dorës së dytë rriteshin përsëri, po qe se trimi nuk do t'ia prente me shpatë kryet kryesuer.

Këto tregime nuk janë edhe aq të pakuptim, sa janë të tmerrshëme. Edhe sod ka në botë kulshedra që njerëzit duhet me i ushqye me mish të gjallë. Nanave iu duhet me flijue fëmijtë, e shpesh herë ato flijohen edhe vetë. Por flijimet nuk ndihmojnë kurrgjâ. Kulshedra âsht e pangishëme. Sa mâ tepër të përbtjë, aq mâ tepër âsht e pangishëme. Nuk i mjaftojnë mâ banorët e nji vendi ase të nji shteti. Nuk i mjafton madje as gjysma e botës. Do të dëshironte me e përbî mbarë botën.

Përmbajtja dhe kuptimi i jetës së këtij përbindëshi âsht vetëm lakmija — për grumbullimin sa mâ të madh të të mirave materjale, për grumbullimin e fitimeve mbi fitimet. Lakmisë së kulshedrës duhet t'i nënshtrohet mbarë bota. Të gjithë duhet t'i shërbejnë me besniki. Djelli shëndrit vetëm për fitim. Të gjitha pyjet rriten vetëm për fitim. Njerëzit janë vetëm mjet për mbë-

rritjen e fitimeve dhe jetojnë vetëm me qëllim që përbindëshi të mundet me korrë fitime. Zoti âsht fitim. Koha shërben vetëm si masë për qarkullimin e fitimit. Bile edhe qielli nuk guxon me u vrâ ase me u këthjellë kur âsht fitimi në rrezik. Poetët nuk do të guxojshin me këndue vetëm për fitimin. I gjithë gjaku i derdhun i miljona njerëzve që u përgjakën në vendet e ndryshëme të luftës, e veçanisht në luftën botnore të fundit, duhet t'i çimentojë fitimit themele të përjetshëme.

A ka ndonji tregim mâ të tmerrshëm se ky? Njerëzimi i mbarë botës e ka njohë këtë përbindësh — ai ka qenë në thoj të tij, e diku diku âsht ende. Mâ në fund, âsht krejt e njajtë se si e quejmë sod — kulshedër apo disi ndryshe. E dijmë mirë se kapitalizmi âsht dishka mâ i keq se çdo kulshedër.

Ka randësi të dijmë se si duhet me luftue kundër përbindëshit. Duhet me ia pre kryet kryesuer, me zhdukë shfrytzimin e njeriut prej njeriut. Në qoftë se ia këputim vetëm krenat e dorës së dytë, përbindëshi do të mbetet gjallë dhe nuk ka me qenë kurgjâ ma pak përbindësh dhe gjakpimës. Do t'i dalin krenat tjerë, të cilët do të përbîjnë dishka mâ pak se të tjerët.

Ky përbindësh nuk njeh kurrfarë kufijsh, ku do të ndalë lakmija e tij dhe fuqija e tij. Ai i shtrin thojt e vet në mënyrë grabitëse përtej kufijve të të gjitha shteteve, ku mbretnon ende prona private mbi mjetet e prodhimit. Kjo do me thanë se atje ku pronarët privatë mbajnë ende në duert e tyne fabrikat, xeheroret, centralet elektrike, pronat e mëdha, bankat etj, populli punues i duhet patjetër të sherbejë për kapitalizmin. Atij i duhet me punue vetëm për këtë përbindësh, e jo për vehten e vet. Kapitalizmi jep për këtë punë vetëm thërmijat skamnore, aq sa atij i duket e nevojshëme që fitimi të mos paksohet, por që të shtohet sa mâ tepër.

Përbindëshi âsht i marrë me gjithë krenat e vet të shumtë. Kapitalizmi âsht i çmendun. Ekonomija e tij âsht e çmendun, sepse

atê nuk e udhêheq mendja, por lakmija. Ai âsht i ngjajshëm me gjarpnin, i cili përbîn dhe bishtin e vet.

Fabrikat kapitaliste nxjerrin prodhime vetëm për fitim, e jo pse këto prodhime u duhen njerëzve. Në gjahun për fitim kapitalizmit i duhet me i gjuejtë edhe blemësat. Prodhimet duhet me i shëndrrue në të holla. Kush t'i blejë ata? Cijët janë blemësa? Cilët shpenzuesa? Po ata njerëz, të cilët kapitalizmi i ka shti në zgjedhjen e vet që të punojnë për të në fabrika, në fusha, në xeherore, nëpër zyra, në puntorina, në hekurudha dhe gjithkund përgjithësisht. Ata punojnë për të, e ai vetë ua ndan bukën. I paguen si rrogëtarët, e rrogtari âsht blemës i dobët.



Kapitalisti i përngjet bixhozxhiut, i cili don me u pasunue në mënyrë të lehtë. Për këtë qellim ai âsht në gjendje edhe me mashtrue. Prandaj kapitalistat thojshin: »Kush nuk hjek dhimtën prej çdo gjaje, ai nuk mund të fitojë!«. »Kanë hjekë dhimtën prej çdo gjaje« n'atë mënyrë, mbassi kanë investue të holla në ato punime që u janë dukë se do jenë ma të »pjellshëme« dhe këtë gjâ e kemi bâ madje secili në mënyrën e vet. As njeni prej tyne nuk ka pasë për detyrë me iu përgjegjë kurkujt për qeverisjen mbi mjetet e prodhimit. Çdonjeni prej tyne e ka përdorë kapitalin si derri strajcën. Kanë folë mbi »ligjet ekonomike« dhe madje se âsht e nevojshëme me iu përmbajtë ligjit mbi »ofertën dhe kërkesën«. Kur, për shembëll, kërkohej xeha e plumbit, shtijshin të holla në xeheroret e plumbit, sepse kishte »kërkesë të gjallë« për plumbin. Nji ditë atëherë, ka ndodhë që nuk kanë mujtë me e shitë mâ plumbin »me çmimin e përshtatshëm«. Mâ në fund nuk kanë mujtë mâ me e shitë fare — sepse nuk ka pasë »kërkesa«.

Madje nuk kanë mujtë me i shitë as xeheroret as edhe maqineritë e xeheroreve. Në këtë rast pezullojshin punën dhe e lirojshin puntorinë. Fitime nuk kishte më. Natyrisht, tash prap ishte e nevojshëme me iu përmbajtë »ligjit mbi ofertën dhe kërkesën« — me investue kapitalin për dishka tjetër. Me këtë rast interesoheshin vetëm se sa kamatë do t'iu sjellë kapitali. E shtijshim këtë kapital në fabrikat e tekstilit. Por këtë gjâ nuk e bâjshin vetëm disa kapitalista. Ka pasë shum kësish, të cilët e kishin »hunden e mirë«. Për këtë arsye shum fabrika fillojshin në një kohë me prodhue tekstil të vise të ndryshëme.

Atëherë kapitalistat vunë re një ditë se malli po grumbullohet nëpër fabrika, magazina dhe dyqane. Prodhimi ishte shum më i madh se sa konsumi. Kulshedra ka disa krena. Të gjitha ato duhet të hanë në një kohë dhe për kah pangîshmënija e tyne nuk i lanë gjâ mangut njena tjetrës. Kapitalistat bâjnë »konkurencë« midis tyne. Për të shitë sa më shum prodhime të tyne, e që të kenë sa më tepër fitime, ata përpiqen me i zbritë sa më tepër shpenzimet e prodhimit. Ata bâjnë presjon kundra puntorëve — ua zbresin mëditjet dhe për kryemjen e po asaj pune marrin gjithnji puntorë më pak. Edhe shpenzimet e prodhimit paksohen aq tepër, sa më i madh të jetë prodhimi. Prandaj prodhimi për një kohë rritet ende, me gjithë se konkurenca âsht e pamëshirshëme. Në këtë rast shpenzimet e prodhimit i ulin punët edhe më të mëdha, të përgatituna më mirë teknikisht. Prandaj së pari fillojnë të shkatrrohen sipërmarrjet më të vogla. Në këtë ndeshje të pamëshirshëme vlen vetëm »ligji i më të fortit«. Me gjith'atë, kjo ndeshje nuk mund t'i japë fund këtij kaosi. Përkundrazi — kaosi bâhet edhe më vonë gjithnji më i madh, konkurenca âsht ende më e fortë, jo vetëm midis disa kapitalistave, por edhe midis shteteve kapitaliste, të cilat një ditë për këtë shkak kacafyten dhe kështu shkaktohen luftat imperijaliste. Përbindëshi kapitalist don përsëri me e nda botën. Prej tregjeve grabiten landët e para. Por me gjithë këtë këtu as lufta nuk sjell përmirësime. Kapitalizmi sëmundet vazhdimisht, dhe kur shpërthen kriza botnore ekonomike ase lufta botnore, atë e kaplojnë vetëm ethet më të mëdha.

2. Pronarët e mëdhaj dhe të vogjël

Vetëm kur të fillojë me u përmbysë pullazi mbi krye, pronarët e madhaj fillojnë të kështillohen se si me e ndërtue shtëpin me plan. Organizojnë »konferencën«. Shum shpesh i thërrasin në mënyrë të njerëzishëme edhe »pronarët e vogjël«. Në të vërtetë »pronarët e mëdhaj« janë zotnij tepër kryenaltë, të cilët mendojnë se e tanë bota duhet të dridhet para tyne, ase para kuletave të tyne.

Në konferencë ata propozojnë »planin«. Botën duhet me e rregullue kështu e ashtu, në mënyrë që »ekonomija botnore« të ngjallet përsëri. Do të ju ndihmojmë. Do të ju japim dollarë. Natyrisht, nuk do të ua numërojmë në duer. Do t'u hapim kredina. Me ato kredina mundeni me blé te na ato gjana që keni nevojë. Na kemi mjaft prej të gjithave. Kreditin do t'ua japim vetëm, në qoftë se do të jeni të mençëm, në qoftë se do ta drejtoni ekonominë simbas këshillave tona. Na jemi ekonomikë mâ të mirë, e mund të na besoni.

A ju nevojiten maqina? Padyshim ju nevojiten! Do të ju japim. Edhe gjana tjera kemi aq shum, sa që, si m'u tallë, mund t'i hjedhim edhe në det. Jemi të pasun pakufi. Neve nuk na nevojitet ndihma, ndërsa juve ju nevojitet. Na mundemi me e blé lehtë të gjithë botën. Kush jep mâ tepër?

Asht e qartë se duhet të na lutet ai që dëshiron për ta ndihmue. Në ekonomín botnore duhet patjetër të mbretnojë rregulli! Çdo pronar i vogël le ta rregullojë ekonominë e vet n'atë mënyrë, që na të mundemi me e ndihmue lehtazi. Në qoftë se don me marrë prej nesh maqina dhe gjana tjera, të mos përpiqet me i prodhue vetë; po kështu edhe gjanat tjera që i nevojiten. Pse të mundohet pa kurrfarë nevoje! Do t'ishte gjâ e marrë — me prodhue gjana që na i kemi të gatshëme. Pronarët e vogjël le të jenë madje aq të mençëm sa për të na lutë. Të mos bâjnë marrina, sepse do të kujdesohemi se kush dhe si do të na lusin.

Kështu u kanë folë afërsisht pronarët e mëdhaj pronarëve të vogjël — natyrisht, tue përdorë shprehi profesjonale. Por ka ndodhë dishka e pashembëllt, dishka që pronarëve të mëdhaj nuk u kishte ndodhë ende kurr — pronarët e vogjël nuk kanë deshtë

me iu përgjegjë thirrjes as për këshillim. Kanë ardhë vetëm disa »pronarë të mesëm«. E pronarët e vogjël as nuk e kanë shprehë mirënjohjen për ftesen e dërgueme. »Nuk do të na shtrydhni mâ«, përshpërtitën ata. »Nuk na nevojitet »ndihma« e atillë«! Nuk do të na caktoni ju se shka do të mbjellim dhe shka do të prodhojmë. Natyrisht, ju do të dëshirojshit që na të mbetemi gjithmonë borxhlijtë tuej. Në fund as këto kasolla nuk do t'ishin tonat. Nuk do të bâheshim kurrgjâ, tjetër, përveç se skllavët tuej. Do të na duhesh gjatë të gjithë jetës me punue për ju si kafshët terhekëse, ase si ata zezakët, Hindasit dhe skllavët tjerë që punojnë gjithmonë për ju.

Pse mos të prodhojmë vetë atë shka nuk e kemi? Kemi xehe — pse të mos i shkrijmë vetë në hekur, bakër ase plumb? A thue të kërkojmë prej jush që të na dërgoni tel bakëri, pllugje, binarë? Marrina të këtilla janë bâ në Jugosllavin e paraluftës. Nga i gjithë importimi 86% ishin prodhime industrijale. Atëherë ju i keni pasë te na drejtorat, udhëheqësat e punimeve, që i kemi quejtë »drejtora«, »specijalista« dhe »akcjonarë«. Ju kanë përfaqësue mirë. Ata kanë plaçkitë shtëpijat tona, xeheroret tona. I kanë asgjasue pyjet tona. Gruni ynë ka qenë — i jueji, e ne na âsht dashtë me mbetë të kënaqun, në qoftë se na mbetej madje dishka misër. Keni lejue që t'i lyejnë me yndyrë mjekrat ashtu si duhet. Dora lan dorën, e sorra sorrës nuk ia nxjerr sytë. Xeheroret tona kanë qenë — tuejat.

Nuk mund të na mëshehni kurrgjâ. Na e dijmë shum mirë se si ka qenë, për shembëll në xeheroren e »Borit«. Atje kemi nxjerrë bakër për ju. Madje jo bakër. Xeherorja ka qenë »e jueja«. Keni thanë se aty keni investue me miljona. Mirëpo, kjo gjâ ka qenë gjâ e vogël për ju. Keni eksportue xehen e bakërit. E keni përpunue në vendin tuej, e me rastin e përpunimit nuk keni nxjerrë vetëm bakër, por shum ar. Me fjalë tjera, në xeheroren e »Borit« ka edhe ar. Vetëm kësi ari ka pasë aq, sa janë pague me të të gjitha ato që keni »investue« në xeherore. Kjo do me thanë se xeheroren e bakërit ua kemi dhanë në të vërtetë falas. A nuk ka qenë mirë që të na falnderoni? Natyrisht, tash

po derdhni lotë për »kohnat e vjetra t'arta«. Ato kanë qenë me të vërtetë ditë t'arta, por për kend?

E tash mbanie mend, se ndryshuen më ato kohë, e madje jo vetëm për ju, por edhe për né. Kështu pronarët aq të mëdhaj si ju, le të mos përulen më, tue i vizitue pronarët aq të vorfën sikurse jemi na. E na nuk do të ndalemi më para derës së shtëpisë së pronarit të madh — me kapelë në dorë. Na nuk lypim më kurrgjâ. Tę shtëpija kemi aq shum punë, sa nuk kemi kohë me shkue në kështillime me pronarët e mëdhaj. Pronarët e mëdhaj le të kujtohen vetë se na nuk kemi guxue me folë kurr.

Duert i kemi të përvjeluna dhe na vjen era djersë. A do të kishte kuptim që si të këtillë të vijmë në konferencë. Na nuk duem me veshë fraqe edhe me vû cilindra në krye.

Pra, na e zemi ase jo për të madhe — sa herë që të doni!

3. Pa qymyr nuk mund të lavrohet

Kur puntori Janez filloi me e ndërtue shtëpinë, së pari ju desht guri për ta shtie në themel. Mandej ju desht me sigurue tullat për mure. Më në fund, para se të vente bajrakun mbi pullazin e ndërtesës, i âsht dashtë me vû të gjithë konstrukcjonin e pullazit.

Do të punonte për së mbrapshti ai që do të siguronte më parë konstrukcjonin e pullazit, e që nuk do të kishte ende as gurët e themeleve. Natyrisht, pullazi âsht i doemosdoshëm për shtëpinë, por me të nuk mund të fillojsh ndërtimin e mureve.

Shka na nevojitet më shum, po qe se duem të jetojmë? Më mirë me thanë, shka âsht më e nevojshëme për nji jetë lakuriqe?

Natyrisht — buka. Këtê gjâ të gjithë na e dijmë shum mirë, sepse deri tash kemi qenë më tepër t'unët se sa të ngîmë.

Për këtê arsye disa katundarë thonë: »më parë bujqësija, e mandej të gjitha tjerat. Pa bukë nuk mund të punohet. Pa bukë nuk mund të jetojë kurrkush.«

Me të vërtetë, pa bukë nuk mund të punojë kurrkush. Por a e din se nuk ka bukë — pa qymyr? Se buka âsht në të vërtetë qymyr?

Katundari sigurisht do të qeshet dhe to të thotë: — ngihu, pra me qymyr!

Do të ia pres fjalën: — e si do të lëvrosh pa qymyr?

— Po kush livron me qymyr? Mos bân shaka të këtilla të pakrypë në këtê libër.

Me gjithë këtê, nuk më kurthoi.

— E dij se nuk lëvron me qymyr, por me pllug. Unë vetëm po të them se pa qymyr nuk mund të lëvrosh. Me fjalë tjera pa qymyr nuk do të kishte as pllug. Vetëm në qoftë se don me lëvrue me parmendë.

Në këtê mënyrë dhe katundari ma kryeneç do të bindet se këtu ka dishka. Qymyr? Po, me të vërtetë e si bâhet pllugu? E bân farkatari ase e prodhojnë në fabrikë. Prej shkahi? Padyshim prej hekurit. Ndoshta jo prej qymyrit.



»Kemi xeheroren — tashmâ i kemi ndezë edhe furrat e naltа...«

Po shka âsht hekuri? A ka ky ndonji lidhje me qymyrin? Tash do të na duhej me përshkrue se si nxirret hekuri dhe se shka nevojitet për prodhimin e tij. Ndoshta ky përshkrim do t'ishte interesant. Por e gjithë kjo gja âsht përshkrue tashmâ. Në qoftë se âsht e nevojshëme, profesionalistat do të flasin për këtë gjâ, e do të na e shpjegojnë neve — njerëzve të padijshem, se si qëndron puna me prodhimin e hekurit në Pfanin tanë pesëvjeçar. Mirëpo, né na intereson çdo gjâ, e jo vetëm prodhimi i hekurit. Tash për tash do të kënaqemi me shpjegimin se koksi âsht i doemosdoshëm për prodhimin e hekurit dhe të çelikut. Atë e quejmë »koks metalurgjik«.

Shka âsht koksi? Mund të thuhet se koksi âsht qymyr i nxjerrun prej qymyrit të thjeshtë. Koksi nxjerret në fabrikat e koksit ase të gazit, ku qymyri i nënshtrohet t'ashtuquejtunit destilim të thatë. Me rastin e këtij destilimi qymyri »humb« disa gazna, peshkëvë dhe disa përmbajtje tjera. Kur shkrihet xeha e hekurit, ajo duhet të përzihet me koks, jo vetëm që të na shëndrrohet në hekur të papërpunuem, shka don me thanë që oksidet e hekurit të shëndrrohen në hekur të përpunuem, por edhe për shkak që të krijohet temperatyra e mjaftueshëme e naltë për shkriemjen e hekurit. Për nji tonelatë hekur të papërpunuem na nevojitet nji tonelatë koks metalurgjik, që âsht jashtzakonisht i shtrejtë. Do të mujshin me kursye dy të tretat e koksit, sikur xehen e hekurit ta shkrijshim me anën e energjisë elektrike e jo vetëm me koks. Por koksi këtu âsht shum i nevojshëm për krijimin e hekurit, ase të çelikut. Sa mâ tepër karbon që t'i shtojmë hekurit, aq mâ i fortë bâhet — shëndrrohet në çelik. Pa qymyr nuk do të kishte mjaft as energji elektrike. Centralet elektrike, të cilat i ven në lëvizje fuqija e ujit nuk munden me dhanë gjatë vjetit gjithënji sasina të njajta t'energjisë elektrike. Ujnat nga ndonjiherë dimnit bijnë aq poshtë, sa që disa hidrocentraleve ju duhet patjetër me e pre punën. Nga ndonjiherë edhe gjatë verës ka fare pak ujë. Në raste të këtilla hidrocentraleve duhet patjetër t'u vijnë në ndihmë centralet kalorike, e kjo don me thanë centralet elektrike që e përdorin qymyrin si material për t'i vû në lëvizje gjeneratorët, maqinat që prodhojnë energji elektrike.

Katundari e din mirë, se nuk i duhet mâ me i shpjegue edhe mâ tejë se si qymyri na nevojitet shum në të gjitha fabrikat e hekurit, në furrat e Martinit, në shkrijetore dhe në vajanica dhe se maqinat nuk punojnë vetvetiu. Qymyri âsht landë djegëse ase, me fjalë tjera — gjaku i maqinave.

Tash âsht e qartë se pa qymyr nuk ka pllug, e kjo do me thanë mâ në fund se ai âsht bukë, sepse pa të nuk do të mujshim sod me e punue tokën.

4. Shka âsht lirija?

Edhe na po e ndërtojmë shtëpinë si puntori Janez. Këtë ndërtesë e quejmë ekonomi popullore ase, shkurt, ekonomi.

Shka na nevojitet për themele. Vetëm gurët nuk do të na mjaftojnë.

A do të na nevojitet qymyri?

Tash deri diku do të kishte të drejtë ai që tha: »Qe, ngihu pra me qymyr!«

Natyrisht, vetëm qymyr nuk mund të hamë. Mirëpo, âsht e vërtetë se pa të nuk do të kishim as me hangër. Katundarit duhet t'ia japim pllugun, kosën, trinën dhe shum gjana të tjera, në mënyrë që të mundet me i prodhue gjanat e nevojshëme për jetesë. Vetëm qymyri nuk mjafton për ndërtimin e pllugut. Kemi pa se për nxjerrjen e hekurit na duhet edhe minerali i hekurit. Të gjitha këto janë ende tepër pak. Hekurin duhet me e përpunue. Për këtë arsye na duhen fabrikat e hekurit. Hekuri nuk përpunohet as në puntorinat zejtare, as në furrat fushore. Na nevojiten shkrijetoret, që nuk mund të ndërtohen për nji natë. Na nevojiten maqina të ndryshëme dhe me qinda e mija puntorë të kualifikuem. Kemi nevojë për xeherore qymyri, si dhe xeherore tjera, për fabrikat e hekurit, për fabrikat e maqinave. Pa këtë gjâ nuk mund të ketë baza për ekonominë popullore. Pa themele të forta t'ekonomisë nuk ka as jetë të lirë. Pa lirinë ekonomike nuk ka as liri politike, as kulturore, e liri ekonomike nuk mund të ketë, për deri sa ekonomija të mos zhvillohet aq, sa që shteti të mundet me qenë i pamvarun prej shteteve kapitaliste.

Pa lirinë ekonomike do të na duhej të mbetëshim patjetër »pronarë të vogjël«, e që »pronarët e mëdhaj« — do me thanë kapitalistat ndërkombëtarë — do te na përzajshin lehtazi nga pronat tona të vogla sa herë që të dojshim. Ata do të na detyrojshin që të ju shërbejmë. Çdo shtet âsht pak a shum i mvarun ekonomikisht, po qe se detyrohet me eksportue xehe dhe me ble maqina. Asnji shtet nuk âsht në të vërtetë i pamvarun dhe i lirë, në qoftë se industrija e tij nuk âsht e pamvarun prej imperijalistave, ase në qoftë se ai shtet nuk e ka industrinë e zhvillueme mjaft.

Fabrikat e hekurit, shkrijetoret, fabrikat e çelikut dhe përgjithësisht të gjitha puntorinat, që janë në lidhje direkte me këtë gjâ dhe të cilat prodhojnë prodhime prej hekurit dhe prej çelikut, ase përpunojnë hekurin dhe çelikun — i quejmë industri e randë.

A t'intereson ndoshta se shka âsht themeli i lirisë sanë ekonomike.

Shka âsht lirija?

Lirija âsht gjithashtu pamvarësi ekonomike. Shteti si kolektiv, si komunitet i njerëzve, fiton lirín kur fiton pamvarësín ekonomike, kur asnji »pronar i madh« nuk mundet me e përzanë mâ nga shtëpija e tij e vërtetë. Je i lirë atëherë kur ia ndan bukën vehtes s'ate, e kjo don me thanë kur popullit nuk ia ndajnë bukën kapitalistat, kur fiton aq bukë sa ke nevojë. Kush nuk ka bukë — ai nuk âsht i lirë.

Nuk ka bukë ai që nuk ka ekonomi të përparueme.

Shka âsht ekonomija e përparueme?

N'ekonomín e përparueme fuqitë prodhuese shoqnore janë mâ të zhvillueme. Prandaj shoqnija gjindet në nji shkallë mâ të naltë zhvillimi, prodhimi âsht mâ i madh dhe mâ i lirë, për çdo produkt nevojitet mâ pak punë shoqnore, N'ekonomín e përpunueme janë të zhvillueme dhe të gjitha deget e ekonomís — jo vetëm bujqësija, por edhe industrija.

Shka âsht industrija?

Industrín mundemi me e krahasue lehtë me maqinën shum të madhe që ka rrota të panumërta, të mëdha dhe të vogla. Të gjitha

rrotat nevojiten. Në qoftë se do të mungonte vetëm një kësosh, maqina do të »çalonte« ase nuk do të punonte fare. Me fjalë tjera rrotat janë të lidhuna midis tyne. Të gjitha degët ekonomike përbâjnë një tanësi që e quejmë ekonomi, e të gjitha llojet e industrisë përbâjnë industrinë. Prodhimi industrijal dallohet shum prej prodhimit bujqësuer, nga shkaku se âsht prodhim »fabrike«, e kjo do me thanë se punohet me maqina dhe se nuk âsht e lidhun direkt me tokën.

Rrota kryesore e maqinerisë industrijale quhet industri e randë. Pse?

Që muratori të mundet me ndërtue mure, i nevojiten drrasat. Ai nuk i prodhon drrasat. Ai nuk i prodhon drrasat vetë. Drrasat për të janë gjysëm-fabrikate. Po kështu edhe mekaniku nuk e prodhon vetë hekurin dhe llastrën. Sikur të mos prodhonte kurrush drrasa dhe hekur, si do të punojshin muratorët dhe mekanikët?

A mundet fabrika me prodhue enë prej llastre sikur industrija e randë të mos ia jepte llastrën dhe maqinat. Kjo në një kohë do me thanë se fabrika e enëve mvaret prej fabrikës së hekurit, ase prej fabrikave që prodhojnë llastër. Me fjalë tjera, industrija e lehtë mund të zhvillohet vetëm, në qoftë se âsht e zhvillueme edhe industrija e randë.

Mirëpo, disa pseudospecjalista do të nxitojnë që të na tërhekin vërejtjen mbassi për ta ekziston një varg shtetesh, të cilat kanë industrinë e lehtë shum të zhvillueme, e nuk kanë fare industri të randë.

Me të vërtetë, edhe Jugosllavija e paraluftës ka pasë dishka nga industrija e lehtë, e cila ka qenë mâ e zhvillueme se sa ajo e randa. Por industrija e lehtë a ka qenë e pamvarun nga ajo e randa? A thue nuk na âsht dashtë me importue sasina shum të mëdha gjysëmfabrikatesh dhe produkte të gatshëme. E shka do me thanë importimi kaq i madh i mallit industrijal, e dijmë mirë na njerëzit e thjeshtë, edhe pa shpjegimin e specijalistave ekonomikë. Kjo âsht njisoj si puna me pronarin e vogël që i duhet me marrë hua bukë prej prodhuesit të madh dhe për këtë të lejë peng pullazin e vet që ka mbi krye.

Na e dijmë mirë; në qoftë se nji shtet âsht i detyruem me importue gjysëmfabrikate, ai âsht krejt i mvarun prej shteteve të jashtëme e jo vetëm industrija e tij e lehtë. Atëherë atij bota e jashtëme ia cakton çmimet. Kur âsht shteti kaq i mvarun prej shteteve kapitaliste, sikurse ka qenë Jugosllavija e vjetër, atëhere gjysëmfabrikatet e hueja janë zakonisht mâ të shtrejta prej produkteve të vendit. Prandej dhe produktet e gatshëme janë mâ të shtrejta. Gjysëmfabrikatet i shtrejton shum edhe transporti, veçanisht kur eksportojmë mâ parë xehet — me shpenzimet tona — e mandej e marrim si gjysëmfabrikat.

Tash e kemi të qartë se pa industrinë e randë nuk ka liri. Industrija e randë âsht ai themeli i ekonomisë populllore, që duhet ta ndërtojmë sa mâ parë. Me këtë rast duhet të mendojmë patjetër për shtetin si tanësi dhe të pregatitemi për vepra t'ardhshëme.

Pa industrin e randë do të mbetëshim mbrapa, e »ai që mbetet, e shkelin«, thotë shoku Stalin. E shkelin të gjithë ata që janë para tij, ashtu sikurse e kanë shkelë Jugosllavinë e vjetër. Na nuk duem mâ të mbetemi mbrapa. Prandaj realizimi i Planit pesëvjeçar do me thanë — »me i çrranjosë definitivisht mbeturinat e sistemit kapitalist në vendin tanë, me konsolidue definitivisht pushtetin populluer në sektorin e ekonomisë populllore dhe me vû themele të forta për ndërtimin e socijalizmit në shtetin tanë« (Kardel).

5. Kur do të prodhojmë aeroplana?

— Kur do të prodhojmë aeroplana na vetë? — më pyeti nji i ri. — A thue se aeroplanat nuk janë aq të nevojshëm sikurse automobilat? Sod, me anën e aeroplanit bahen edhe mbjelljet. Me anën e tyne asgjasohen dâmtuesat e pyjeve, burimet e malarjes e kënetat, të cilat stërpiken me mjetet për zhdukjen e mushkajave. Kam lexue se aeroplanat i përdorin edhe si njiheoj spitalesh; me anën e këtyne i hypin fëmijtë, që kanë kollin e keq, në naltësi prej 3.000 metrash. Mjaftojnë disa fluturime të këtilla — dhe fëmija të shëndoshet!

Padyshim nuk guxoj me e lanë në heshtje pyetjen e këtij të riut. Sod shpesh herë ndodh që »voja të dijë mâ tepër se pula«.

Rinija shkon krah për krah me kohën, ase para saj. Mirëpo, shum të rritun tërhiqen zvarrë mbas ngjarjeve.

Të përpiqemi me iu përgjegjë të riut. Duhet të jemi të kujdesshëm që të mos na shtijë në kurth. I riu tashmâ ndërton aeroplane të vogjël, modele, por prap âsht nji farë specjalisti në nji farë mase, ndërsa na nuk jemi kësish. Pra, ta pyesim se shka nevojitet për ndërtimin e aeroplanit.

— Motori i aeroplanit âsht gjaja kryesore — na mësoi ai. Mandej metali për skelet, llastra, alumini, ase duralumini. Natyrisht aeroplanat janë të shumllojshëm. Skeletet e tipit të vjetër janë kryesisht prej drunit. Atëherë nevojiten instrumentet...

Afërsisht kështu na u përgjegj i riu. Nuk ka nevojë që ta shqyrtojmë me hollësina se shka i duhet edhe mâ ndërtuesit t'aeroplanit, sepse nuk jemi as ingjinjera, as konstruktora aeroplanash. Do ta pyesim vetëm sa aeroplana prodhon fabrika moderne e aeroplanave.

— Me qinda, me mija! — U përgjegj ai ngadhnjyeshëm. — Natyrisht, unë këtë gjâ nuk mund ta dij me saktësi, sepse fabrikat janë shum të ndryshëme. Fabrikat e mëdha prodhojnë padyshim me mija aeroplana, mirëpo, puna âsht e ndame në disa fabrika — disa prodhojnë vetëm motora, e të tjerat vegla të tjera të parandësishëme.

Iu përgjegjem:

— A thue nuk âsht gjâ e tepërtë — me mija aeroplana A mendon se do të na nevojiten kaq shum?

— Gja e tepërtë? Aeroplana nuk mund të ketë kurr me tepri. Tash gjithkujt i nevojitet aeroplani. Pse te na çdo njeri të mos ta ketë aeroplanin e vet, ashtu sikurse n'Amerikë që ka gadi çdo njeri automobilin e vet! — u përgjegj i riu me enthuzjazëm.

— Me të vërtetë, mirë — pëshpërita. — Por para kësaj asht e nevojshëme që çdo banor të ketë nga nji palë këpucë të veta.

— Jo vetëm nji palë! — bërtiti i riu. — Duhet patjetër të ketë mjaft, për t'i zgjedhë!

— Të paktën nji palë — vazhdova. — Në Jugosllavinë e paraluftës ka pasë për çdo banor vetëm nga nji këpucë, e bile edhe ajo ka qenë e grisun, sepse në vjet nuk prodhoheshin as

aq palë këpucë sa ishte nevojë për gjysmën e mbarë popullsisë. Nuk mendoj që me industrinë »time« të këpucëve të hjedh poshtë industrinë »tande« t'aeroplanave. Edhe dishka tjetër. Motorat e aeroplanave do t'i prodhojmë kur të kemi industrinë e randë të maqinave të zhvillueme mirë. Deshta vetëm me thanë se çdo gjâ duhet të rregullohet bukur. Si në mulli: Kush vjen i pari — bluen mâ parë.

E tash të shohim pak se si këto gjana rregullohen n'ekonomi. Në rend të parë na duhet »drithi« për mulli, që e quejmë shkrijatore, shka do të thotë, se mâ parë na duhen xehet dhe qymyri. Ky »drith« vjen në radhë të parë. Natyrisht xehet duhet mâ parë t'i rëmihë dikush. Do me thanë se në fillim duhet të hyjmë thellë nën dhé si urithi — por edhe mâ thellë — në mënyrë që të mujmë edhe na nji herë me fluturue nalt në qiell me aeroplanat tanë të vendit.

Po thuejse për këtë gja na duhet alumini. Në të vërtetë xehen e aluminit nuk ka nevojë me e rëmihë aq thellë. A e din se kjo asht nji lloj deltine dhe se e quejmë boksit. E quejmë me këtë emën prej nji krahine në Francë, ku âsht fillue rëmihja e tij. Mirëpo, alumini âsht metal i çuditshëm. Në fillim nuk i kushtojshin ndonji kujdes të veçantë. Edhe metalet kanë nga ndonjiherë të njajtin fat sikurse disa njerëz që gjatë kohës së rinisë nuk janë »kurgja e veçantë« — nuk i çmon kurkush. Derisa alumini nuk ka fillue të përpunohet me anën e energjisë elektrike, dukej i shtrejtë për së tepërmi. Flitej se âsht edhe i butë për së tepërmi. I kanë gjetë »mungesa« të ndryshëme, sikurse ndodh edhe me njeriun kur fillon me e sulmue.

Ndoshta të gjitha këto ti i din mâ mirë se unë, por nuk âsht keq që t'i përsërisim pak. Mirëpo, prodhimi i aluminit nuk âsht aq punë e thjeshtë. Mâ parë duhet me e nda deltinën prej boksitit, ase oksidin e aluminit. Për këtë gjâ na duhet energjija elektrike. Që të mundemi me e nda oksigjenin prej aluminit, përdorim sasina të mëdha energjije elektrike, e kjo do me thanë e përpunojmë deltinën n'alumin të farkuem. Me fjalë tjera, oksigjeni dhe alumini bashkohen me nji njazim që e quejmë oksidi i aluminit. Për të mujtë me prodhue nji tonelatë alumin duhet të përdorim 20

deri 25 mijë kilovat korent elektriku. Me këtë rast na duhen kodra të mëdha qymyri, në qoftë se duem me prodhue sasina mâ të mëdha alumini. Me pasë vetëm xehe, nuk don me thanë ende kurrgjâ.

Je i squet, prandaj e ke kuptue se — nuk ka alumin pa centrale të fuqishëme elektrike dhe pa industrinë e zhvillueme të qymyrit. Xeha në vetvehte nuk don me thanë kurrgjâ, në qoftë se mungojnë edhe të gjitha gjanat e tjera.

Po thue se kemi gjithshka mjaft dhe për së shpejti do të fillojmë me prodhue alumin në Stërnishqe afër Ptujit? Përveç kësaj, na tashmâ e prodhojmë edhe në Llozovac afër Shibenikut. Pse pra, të mos prodhojmë edhe aeroplana?

Kur të jetë e mundshëme dhe e nevojshëme — do të prodhojmë edhe aeroplana. Për prodhimin e aluminit për nevojat tona, afër 13 miljonë tonelata alumini, na nevojiten 26 mijë tonelata deltinë. Në vjetin 1951 do të prodhojmë 56 mije tonelata deltinë, kështu që gjysmen e kësaj do të mundemi me e eksportue. Deltina âsht shum e çmueshëme, sepse në botë nuk ka boksit gjithkund. Mâ mirë âsht me e transportue dhe me e shitë deltinën se sa boksitin, sepse për një tonelatë alumini duhen 4 tonelata boksit.

Jugosllavija e paraluftës e ka shitë boksitin gadi për kurrnji send, në vend që t'i shtinte në punë njerëzit tanë në përpunimin e xehes dhe të përdorte lignitin. Sikurse e din ligniti âsht një lloj i dobët i qymyrit që nuk e vlen barra qeranë për ta transportue tepër larg. N'industri ai përdoret vetëm nepër fabrikat e aluminit. Për këtë arsye ligniti âsht si gjâ e lindun posaçërisht për prodhimin e aluminit, sepse kështu ky mund të shitet mâ mirë. Kjo do me thanë se në këtë mënyrë do të nxjerrim edhe mâ tepër visare, të cilat kanë ndejtë pa u shfrytzue deri tash, në mos e paçin përdorë centralet dhe ekonominat shtepijake.

I riu, i çili mendon ende gjithnji në radhë të parë për aeroplanin, ndoshta âsht tue pritë ende që t'i përgjigjem se kur do të fillojmë prodhimin e aeroplanave. Ai e din se tashmâ jemi tue prodhue automobila dhe mendon se nuk ka mâ kurrfarë penge-

sash teknike për prodhimin e aeroplanave. Me gjith'atë, nuk âsht lojë me prodhue motora për automobila dhe aeroplana. Shum shtete, të cilat e kanë teknikën shum më të zhvillueme se sa na, nuk janë në gjendje me i prodhue. Por na me siguri nuk do të mbetemi të fundit.

Pra, i riu duhet patjetër të pranojë se industrija jonë po zhvillohet tashmâ, e gjithashtu duhet të kuptojë se shka vjen në rradhën e parë. Mbi shka folëm pikërisht gjatë të gjithë kësaj kohe?

Folëm për industrializim dhe elektrifikim. I riu që po e ndërton fabriken e maqinave e veglave të randa afër Beogradit, shokët e tij që po punojnë në ndërtimin e maqinave hidraulike në Zagreb, ata që po ndërtojnë Hekurudhën e rinisë, si dhe ata të tjerët që po ndërtojnë nepër vendndërtimet e ndryshëme — do ta kuptojnë këtë gjâ, po ashtu si na të dy.

6. »A nuk po e sheh-që jam zdeshë e zdathë?«

Kështu më ka pyetë nji puntor bujqësije kur i drejtova pyetjen në se âsht i kënaqun apo jo. Me gjithë këtë, nuk ka qenë zdeshë. E madje edhe në kambë ka pasë këpucë, me gjithë se jo nga ato më të mirat.

— Po punojmë e po punojmë, po prodhojmë sa më tepër, e ku po shkon e gjithë kjo që po e prodhojmë? — përshpëriti ai.

Edhe vetë njehem si puntuer e prandej e dij se shka do me thanë »jam zdeshë e zbathë«. Për shembëll dikur në nji kohë, kam qenë me të vërtetë gjysëm zdeshë e gjysëm zbathë. Edhe po këtij puntori i ka ndodhë kjo gjâ. Me gjith'atë, atëherë ai nuk pëshpëritte kaq. Edhe unë pëshpëris, prandej e kam fillue bisedën.

— Nuk âsht ende, ashtu si duhet të jetë dhe të gjitha gjanat që na duhen i kemi ende tepër pak — pohova unë.

— As kurr nuk do të ketë — ma preu puntori i dëshpëruem.

— Do të ketë, çdo gjâ do të përmirësohet. Edhe atëherë do të pëshpërisim. Ashtu edhe duhet. Kush nuk bân vërejtje, i mësheh gabimet.

Ai u habit:

— A âsht me vend që po bâjmë vërejtje?

— Natyrisht — ju përgjegja. — Njeriu kurr nuk guxon me qenë i kënaqun. Kënaqësija âsht fundi i përparimit. A âsht i kënaqun derkuci i cili, i ngimun shtrihet në brrakë, dhe nuk e çan kryet fare për kungjâ. Vetëm bâni vërejtje! Don pra rrobe të reja? Këpucë? Mâ shum rrobe dhe këpucë? Ushqim mâ të mirë? Banesë mâ të mirë dhe shka don tjetër? A do t'ishe kështu i kënaqun?

— Nuk do t'ishje i kënaqun? — U përgjegj ai.

— Nuk besoj! Kur të kesh gjithshka me tepri, do të jesh i formuem mâ tepër ase, si thuhet, i kulturuem. Do t'interesojnë shum gjana, për të cilat tash për tash nuk e çan kryet. Do të shohish se gjithkund ka nevojë me u ndryshue, me përmirësue dishka.

Ai nuk flitte. Ndoshta nuk më ka kuptue.

— Tash nuk të vjen mirë që fabrikat tona nuk po prodhojnë ende gjithshka »sa duhet« dhe se nuk ka mjaft tekstil e këpucë. Do të vijë dikur koha kur s'ka me t'ardhë mirë që çdo familje të mos ta ketë aparatin e vet të televizionit, me anën e të cilit mund të shikohet se shka po ndodhë në vende të largëta, sikurse sod që mund të ndigjohen lajmet me radjo-aparate prej Azís, Amerikës dhe Australís. Tash nuk je i kënaqun pse disa puntorë janë mâ të vetëdijshëm, por do të vijë koha kur nuk do të jesh i kënaqun sepse të gjithë puntorët nuk janë mjaft të vetëdijshëm.

A thue nuk jam i vetëdijshëm? — u trondit.

— Jo ende sa duhet. Do të mujshe me qenë edhe mâ i vetëdijshëm, dhe kishje me qenë, sikur ta dijshe se si punon e tanë maqinerija që lëviz ekonomin popullore. Por edhe ti vetë nuk je fajtuer. Puntori mâ parë nuk ka guxue me mendue. Tash si vjen në konferenca, dhe ai që mendon, kërkon të flasë. Me gjithë këtë, na ende shpesh herë nuk dijmë me folë me të.

— Ashtu âsht! — vërtetoi ai me të shpejtë.

— E sheh, ashtu âsht. Disa puntorë kanë mësue vetëm me pohue: »Ashtu âsht!«, e disa, që mendojnë se nuk âsht »ashtu«, kanë mësue të heshtin. Në qoftë se do të them tash se prodhimi

i maqinave âsht mâ i nevojshêm se sa prodhimi i tekstilit dhe i këpucëve, a do të thuesh »ashtu âsht«?

Pra, mâ tepër dëshiron me heshtë? Herën tjetër do t'i bâsh vërejtjet kur të flasish me ndonji që nuk do të kundërshtojë. Kur të merrni kështu për të keq vet për vehten tuej, padyshim kurkush nuk do të shpjegojë sepse maqinat janë mâ të nevojshëme se sa rrobet.

— Pra, rrobet nuk janë të nevojshëme? E pse atëherë vishesh? — m'u përgjegj.

— Janë të nevojshëme fort madje. E sheh, pikërisht për shkak se janë kaq shum të nevojshëme, janë edhe mâ të nevojshëme gjanat e tjera. Për shembëll, maqinat, sepse pa maqina nuk mund të bâjmë rrobe.

— Si nuk kemi maqina! — tha ai.

— Sigurisht nuk kemi! Disa maqina na mungojnë fare, prandaj duhet t'i importojmë dhe t'i paguejmë me dru — e ti han bukë misri. Maqinat tjera, po qe se edhe i kemi, janë vjetrue, punojnë përkohësisht dhe japin prodhime të dobta. E ku i kemi maqinat që prodhojnë maqina tjera? Puntori, në mos kurkush tjetër, duhet të shohë se çfarë randësije kanë maqinat për prodhimin e veglave. Shokët puntorë të metaleve do të munden me na e shpjegue këte gjâ. Maqinat për prodhimin e veglave janë themeli për industrín e lehtë, e jo vetëm për të lehtën. Edhe industrís së randë i duhen maqina dhe stabilimente. Shka mendon, a thue se na nevojiten, për shembëll, turbinat për centralet elektrike apo jo? Tash do të fillojmë me prodhue këso turbinash në »Litostroj« në Lublanë. Po e shoh se të gjitha këto nuk t'interesojnë aq sa duhet. Por kur qortimet tueja të vlejnë ndonji send, kur të kritikosh me qellim që dishka të përmirësohet, atëherë do të duhet patjetër që të pajtohesh me të gjitha »vogëlsinat« e këtilla. Nuk do të damtohesh në qoftë se të paktën do ta lexosh Ligjin mbi Planin tanë pesëvjeçar. Puntori âsht krijues krenar, i cili e ndryshon botën, e jo ngucaq i pavetëdijshëm. Kritikon keq ai që s'din kurgjâ, e aq mâ keq ai, që nuk don të dijë kurgjâ, e flet se keshe din gjithshka. Në qoftë se ma more këtë gjâ për të madhe, ke provue vetëm se nuk je i vetëdijshëm.

7. E pse vetëm në Bosnjë?

— Pse i ndërtojmë të gjitha vetëm në Bosnje? — murmuriti qytetari. Para lufte çojshim çdo gjâ në Beligrad, e tash të gjitha vetëm në Bosnjë. Në Bosnjë tashmâ po e ndërtojmë hekurudhën tjetër të madhe. Ndoshta edhe xeherore po hapen vetëm në Bosnjë. Fabrika po ndërtojnë — në Bosnjë.

Po grindem pa dashtë me qytetarët, sepse ata zakonisht i dijnë vetë të gjitha dhe kurrkush nuk mundet me ua shpjegue. Grindem vetëm për të provue se vetëm ata kanë të drejtë.

Pra, qytetarin e pyeta në mënyrë të marrë, pikërisht si duhet me folë me zotnij të këtillë.

— Me të vërtetë, pse nuk e hapin ndonji xeherore në kënetën e Lubjanës?

— Sikur këneta e Lubjanës t'ishte në Bosnjë, do ta hapshin kaherë — murmuriti qytetari. Atje me nji herë do ta derdhshin ndonji miljardë. Do t'u shkonte lang për goje për kënetën e këtillë. Kush e din se shka mëshihet në të?

— Po, thashë, për shembëll, barít.

Natyrisht me njiherë ma preu fjalën:

— E cila kënetë në botë mund të japë barít mâ të mirë prej kësaj kënetës sanë? Por, kur do ta shohin këtë gjâ këta injorantat tanë? (Qytetari ynë i respekfon shum njerëzit e huej). Duhet të vijë ndonji i huej që të fillojë me shfrytëzue barítin e Lubjanës. Në kohën e vjetër në çdo shtëpi të ndershëme të Lubjanës zjarmi ndezej me barít.

— Ndoshta deshët me thanë me turbë — i thashë në mënyrë modeste. — Në këneten e Lubjanës turba tashmâ ka mbarue. Vetem do të bajshin dam, po qe se do të rëmihshin tokën dhe t'ia merrshin humusin me mbeturinat e turbës. Tash barítin po e nxjerrim në Rudnik afër Lubjanës, afër kënetës. Aty afër dikur nxirrej qymyrguri, po shtresa ka qenë aq e hollë, sa nuk ka mujtë me u zhvillue ndonji xeherore mâ e madhe qymyri.

— Mos më tregoni atë që e dij! Padyshim, barít ka mjaft edhe në vendet tjera. Nuk do të kishim nevojë me importue landë tjera djegëse — më tha ai në mënyrë profesjonale.

— Baríti i Rudnikut âsht krejt i mirë — shtova. Por tash nuk po e përdorim ende si landë djegëse. Shkenca nuk ka përparue ende aq sa duhet. Tash për tash përdoret vetëm për prodhimin e ndonji ngjyre.

— A thue nuk ju thashë? Injoranta! Të marrë! Nuk e ndezin zjarmin me të! Natyrisht, qymyri i Bosnjës âsht mâ i mirë!

— Me të vërtetë âsht i mirë — mora guxim me ju përgjegjë. Qymyri i Bosnjës âsht — për kah vlefta e tij kalorike — i mirë gadi si qymyrguri.

— Kurr mos ju besoni të gjitha gjanave që iu tregojnë. Më besoni se në botë nuk ka lignit mâ të mirë nga ai i Tërbovles.

— Me të vërtetë ligniti âsht mâ i keq prej qymyrit të zi të Tërbovles — u »pajtova«. Kështu, ligniti në çdo rast âsht mâ i dobët se sa qymyri i zi. Prap se prap, âsht fat i madh që Sllovenija ka shum lignit.

— Shka, shum? Kush ka mâ shum? A thue çdo njeri i mençëm nuk do të ndërtonte, për shkak të lignitit, hekurudha në Slloveni se sa në Bosnjë! Do të kishte dobi, sikur ta eksportojshin lignitin tanë... — kërkohej dhe enthuzjazmohej qytetari ynë ndërmarrës.

— Me të vërtetë, te na nuk do të ndërtohen hekurudha për shkak të lignitit. Për fat të mirë, ka qellue që xeherorja e qymyrit në Velenje të gjindet brî hekurudhes së Velenjës. Asht fat edhe mâ i madh që ligniti i Velenjes lëshohet me tel — shtova.

Transportimi i qymyrit me anën të teleferikut âsht vjetrue! — fliste tue u trondite qytetari — profesjonalist.

— Natyrisht, prandaj âsht mirë që në Velenjë e kemi centralin e madh elektrik, i cili mund të zgjanohet gradualisht. Në këtë mënyrë qymyrin e dobët e shëndrrojmë n'energji elektrike.

— ... Prandaj korenti qenka aq i dobët, sepse po u prodhueka prej qymyrit aq të keq! — ma preu fjalën qytetari.

— Transportimi i lignitit nuk âsht gjâ ekonomike, sepse lokomotivat përbîjnë në këtë rast për së tepërmi qymyr të mirë. Ato nuk kënaqën me lignit. E përsa i përket korentit elektrik, nuk mund të njihet prej tij se a prodhohet prej uji, nafte a po prej qymyr-

gurit. Pra, lignitin nuk e transportojmë me lokomotiva për shkak se ato nxehen me qymyr të çmueshëm.

— Asht e kuptueshëme! E pse nuk elektrifikohen hekurudhat tona, kështu nuk do të nevojitej aq shum qymyr! — thoshte qytetari ynë me idhnim.

Nuk guxoni me ma zanë për të madhe që vuna shpatën në këllef dhe qytetarit i mbeta borxh për t'iu përgjegjë, jo vetëm në pyetjen e fundit por edhe në shum pyetje tjera. E lashë me u zhytë në mendime të thella që të kujtohej sepse te na ligniti nuk transportohet me hekurudha elektrike. Kush do të mundej krejt me ia provue se pse shî në Bosnjë po hapim xeherore të ndryshëme?

Na të dy e dijmë se âsht »zakon« që mineralet duhet të rëmihen atje ku gjënden; landa e pyjeve të prehet nepër pyje, hekurudhat të ndërtohen atje ku nuk ka ende, e ku toka âsht e pasun me visare.

Padyshim, te na nuk ka pasë gjithmonë kesi zakonesh. Natyrisht, edhe aso kohe ka pasë xeherore të ndryshëme në Bosnjë. Ndoshta do të kishte pasë edhe shum mâ tepër, sepse kapitalistat e huej e kanë pasë hetue se çfarë visaresh gjinden në Bosnjë, por Bosnja ka qenë gadi e pakalueshëme. Hekurudhat e vjetra në binarë të ngushtë nga koha e Austrís nuk duhet me i marrë fare parasyshë. Hekurudha solide âs që janë ndërtue fare. E kush do t'i ndërtonte? Kapitalisti »investon« vetëm aq sa i duhet për të nxjerrë fitimin e vet të çmueshëm. Po shteti i mâparshëm? Shka ka qenë shteti i mâparshëm? A thue nuk ka qenë vetëm nji govatë e madhe për grabitësat kapitalista. Të gjithë kanë dashtë të hanë prej saj, e kurkush nuk ka dashtë me e mbushë. Vetëm turmave punuese u âsht dashtë ta mbushin. Bosnja ka qenë »tokë virgjine«. Të ndërtojnë fabrika në Bosnjë? Kjo gjâ ka qenë tepër e rrezikshëme. Me gjith'atë, janë përpjekë ta bâjnë edhe këtë gjâ. Stojadinoviqi ka investue disa miljona në fabrikën e hekurit në Zenicë — në mënyrë që ajo t'ia këthente në miljarda. Në të vërtetë, ai ka investue aty të hollat e shtetit.

Tash po përdorim zakone të reja. Fabrikat po i ndërtojmë afër burimeve të pasuna me landë të para, po hapim xeherore,

atje ku janë të paprekuna vendet e qymyrit me miljarda tonelata. Po ndërtojmë hekurudha deri te depot e xeheve, sepse xehet nuk do të vinnë vetë deri te fabrika, ashtu sikur se produktet nuk do të shkojnë vetë prej fabrike n'ato vise, ku janë të nevojshëme. Landët e para dhe produktet industrijale i bartim me hekurudha; nuk i ngarkojmë në kuaj dhe mushka, sikurse ngarkohej deri tash visari i Bosnjës, ashtu si ngarkohet ende në viset ku nuk ka as rrugë.

Natyrisht, të gjitha këto nuk ia tregova qytetarit, sepse ai nuk do të më besonte.

Kreu i pestë

TA SHIQOJME TË VËRTETËN NË SY!

1. Edhe njerëz ka tepër pak...

Njerëzit e thjeshtë kanë folë dikur: »ka tepër njerëz në botë, e prap do të ketë luftë!« Këtu ka pasë pak urtësi, që mëshihet nga ndonjiherë me fjalët e thjeshta të njeriut tanë, me gjithëse e gjithë kjo gjâ në të vërtetë nuk ka qenë aq e thjeshtë.

Na sod themi se te na ka tepër pak njerëz, jo vetëm nga shkaku se lufta ka kërkue flijime miljonshe njerëzore. Njerëz ka pak edhe nga shkaku se na duhet shum mâ tepër fuqi puntore. Pse na duhet ajo? Për shkak se po punojmë shum mâ tepër. Për këtë arsye fuqín puntore shpesh herë e gjejnë vështirë edhe ata që nuk kërkojnë profesjonalista, por fuqí të thjeshtë të pakualifikueme puntore.

Katundari kërkon shërbtorin dhe nuk mund ta gjejë. Nuk ka mjaft njerëz në vendet e ndërtimeve. Nuk ka mjaft puntorë pyjesh. Nuk ka mjaft xehetarë. A thue me të vërtetë kanë mbetë mbas lufte kaq pak njerëz? A thue edhe në shtetet tjera nuk ka mjaft puntorë?

Nuk âsht gjithkund kështu. Dikund ka puntorë për së tepërmi. N'Amerikë ka, për shembëll, gadi 6 miljonë njerëz kryekëput të papunë ase të futun në punë pjesërisht. Këta miljona përbâjnë »tepricën« e ashtuquejtun të fuqís puntore. Edhe në disa shtete t'Europës perëndimore ka për së tepërmi njerëz. U nevojiten në të vërtetë xeheroret, a në disa degë industrijale kishin dëshirë me shtî në punë mâ shum puntorë. Prandej ka njerëz

nër së tepërmi, të cilët nuk gjejnë punë në degën e tyne. Të gjithë punëtorët nuk mund të hyjnë në punë. Te na do të gjejshin punë lehtazi.

Shka në vërtetë do me thanë »njerëz për së tepërmi«?

Themi, ase thonë, se ka për së tepërmi aq njerëz, sa që nuk mujnë me gjetë punë. Pra, sikur të mujshim me i shti në punë në nji numër mâ të madh, atëherë do të kishte asish tepër pak. Sikur në botë t'ishte çdo gjâ e rregullueme, nuk do të kishte kurr njerëz as tepër shum, as tepër pak. Puna do të ndahej drejt në të gjithë njerëzit dhe çdo njeni do t'ishte i nevojshëm. Për të gjithë njerëzit do të kishte mjaft punë dhe bukë.

Botkuptimi se në botë ka njerëz për së tepërmi ka kohë që âsht hjedhë poshtë në vjetërsina. Në shekullin e katuem âsht përpjekë njifarë anglezi Malitus me provue se njerëzit shumzohen mâ shpejt, se sa rriten mjetet për ushqimin e tyne. Pra, për së shpejti do të vijë koha, në qoftë se tashmâ nuk ka ardhë, kur toka nuk do të mundet mâ me i ushqye të gjithë njerëzit dhe njerëzimi nuk do të guxonte me u shtue mâ, se per ndrysho njerëzit patjetër do të vdisshin urije. Duhet me kufizue natalitetin,*) e tue qenë se njerëzit e vorfën shumohen mâ shpejt se sa ata të pasunit, duhet dasi me rregullue që të pengohet shumëzimi i të vorfënve.

Me gjithë se kjo pikëpamje âsht rrëxue dhe hjedhë poshtë kaherë, me gjith'atë po paraqitet ende gjithnji në disa forma tjera. Në shtetet kapitaliste ka edhe sod shum spekuluesa të bukës dhe të jetës njerëzore, të cilët provojnë me gjithë dëshirë se në botë nuk ka mjaft ushqim, se Europës i kërcnohet urija, se nuk ka rezerva drithi. Kështu flasin spekuluesat, të cilët dëshirojnë me i ngritë çmimet e drithit. Si pronarë të magazinave të monopolizueme të drithit, ata dëshirojnë me e frigësue mbarë botën. Janë të ngjajshëm me pronarin e madh, i cili i jep punë pronarit të vogël, si me i bâ ndonji nder të veçantë. Pronari i vogël do të vdiste për së shpejti prej ujës, sikur pronari i madh të mos ishte aq »fisnik« për t'ia dhanë nji copë bukë. Natyrisht, pronari i madh

*) Natalitet — të lindunit, numëri i lindjeve në krahasim me numrin e popullsisë.

nuk jep kurrgjâ kot. Kapitalistat nuk u japin drithë Kinezëve dhe Hindasve t'unët, të cilët në disa vjetë vdesin ujet me miljona, por mâ me dëshirë e hjedhin në det, që mos t'i bjen çmimi. Në nji kohë politikajt dhe »ekonomistat« e tyne i predikojnë botës se janë shterrë rezervat botnore të drithit.

Nji shkencëtar sovjetik ka llogaritë se me mjetet e sodshëme prodhuese teknike mund të prodhohen njizet e pesë herë mâ tepër gjana ushqimore. Kjo do me thanë se në botë do të mujnë me jetue njizet e pesë herë ma shum njerëz. Natyrisht, me këtë rast duhet me i plotsue edhe disa kushte. Të gjitha gjanat ushqimore dhe të gjitha frytet, të gjitha frytet e punës, duhet të ndahen drejt patjetër në mes të të gjithë njerëzve. Buka nuk do të guxonte me qenë mâ objekt spekulimi. Gruni duhet të prodhohet patjetër, në mënyrë që të gjithë njerëzit të kenë mjaft bukë, e jo të spekulojnë me drithë disa pasanikë. Mirëpo, në shtetet kapitaliste pasunit materjale ndahen në mënyrë të zhdrejtë e se vetëm pakica ka mâ shum fitime. Prandaj njerëzit atje jetojnë gjithmonë në skamje, pa marrë parasyshë, në se âsht prodhue tepër pak, ase tepër shum ushqim, në se korra ka qenë e mirë apo e dobtë. Atje kapitalistat janë krejt të kënaqun, kur njerëzit vuejnë dhe kur ka njerëz për së tepërmi — sepse ata e duen armatën e të papunëve, tue qenë se fuqija puntore âsht aq mâ e lirë, sa mâ i madh të jetë numëri i të papunëve.

Pse te na ka pak njerëz?

Mbassi te na ka tepër punë për secilin.

Duem me mbërrijtë të gjitha ato shka kemi lëshue gjatë krejt vjetëve të kalueme. Dëshirojmë të bâhemi të pamvarun ekonomikisht. Na duhet patjetër me zhvillue industrinë, të cilën nuk e kemi ende. Dëshirojmë me prodhue dy herë, tri herë, madje edhe njiqind herë mâ tepër artikuj të ndryshëm se sa para lufte.

A âsht e mundshëme kjo gjâ? Në qoftë se dëshirojmë me e shtue prodhimin, duhet të kemi edhe shum mâ tepër pronarë — a po jo? Kah t'i marrim, mbassi na mungojnë qysh tash në fillim? Tash kryesisht nuk ka mâ tepër puntorë se sa para luftës, ndoshta ka edhe mâ pak, sepsé as banorë nuk ka mâ tepër.

Sikur çdo njeni prej nesh të punonte dy herë më tepër, numëri i punorëve në të vërtetë do të dyfishhej. Me shtimin e produktivitetit mund të zavendësohet numëri më i madh i punorëve.

A thue, pra, të vuejmë si kafshët? Natën dhe ditën?

Jo si kafshët, por si njerëz të kuptueshëm. Në kohën e Napoleonit malli bartej nëpër rrugët tona me qerre kuajsh. Qerret i bajshin barrët e vogla — që nuk ishin as sa gjysma e vagonit tanë të sodshëm — dhe kjo vazhdonte tetë ditë, ndërsa sod treni ban pesëdhetë vagona mall në të njajtën largësi, vetëm për gjashtë orë. A âsht e nevojshëme që për këtë shkak të mundohemi aq më tepër? Duhet me pa se kërkohen metoda të tjera të punës — për përmirësimin dhe lehtësimin e saj.

Edhe në punën tanë shum gjana do të munden me u ndryshue, që do të mundemi me lehtësi të punojmë dy herë, tri herë e madje edhe njiqind herë më tepër. Në shum vende maqinat do të zëvendësojnë punën e dorës. Do t'i përmirësojmë metodat e punës. Do të punojmë me norma. Kjo do me thanë se për çdo punë do të përdorim vetëm kohën e caktueme të punës. Prandaj krejt punën do ta rregullojmë, në mënyrë që ajo të jetë me të vërtetë e mundshme. Do të punojmë me mend, e jo me duer. Vazhdimisht do të kërkojmë metoda të reja të punës, në mënyrë që punën ta përparojmë, ta thjeshtësojmë dhe ta përmirësojmë sa më tepër.

Por para kësaj duhet patjetër me krijue dhe me bâ shum gjâna të ndryshëme. Prandej nuk ka mjaft njerëz. Veçanisht ka pak punëtorë profesjonalista, të cilët i quejmë edhe punëtorë të kualifikuem. Maqinën duhet ta drejtojnë punëtorët e mësuem. Punëtorët as nuk mund t'i ndërtojnë maqinat, të cilat deri tash nuk i kanë pa kurr. Kemi nevojë për teknikë — elektroteknikë, teknikë të maqinave, teknikë të ndërtimeve. E teknik nuk mund të bahesh para se të fitosh dijen profesjonale të zëjes ase në shkollë. Mësimi kërkon kohë, ndërsa teknikët na nevojiten qysh tash. Na nuk mund të presim disa vjetë deri sa ata ta kryejnë shkollën. Përveç kësaj, prej vjeti në vjet do të na duhen sa më tepër. Koha na shtyn dhe na ndjek. Mû për këtë ârsye na duhen shum punëtorë të kualifikuem. Na duhen shum profesjonalista në të gjitha degët.

Mirëpo, a do të mundemi me i plotësue të gjitha këto detyra? Po në rast se nuk do të kemi mjaft puntorë dhe profesjoialista? Po, do të na ndodhte po sikur atij puntorit që ka fillue me e ndërtue shtëpinë e ju kanë mbarue gurët qysh me ndërtimin e themeleve. Në këtë rast do të ndërtojshim në zall dhe, çdo shî i madh, do t'i rrenonte muret.

Ndërtesa e ekonomisë sanë do të rrenohej. Kjo do me thanë se ajo do të na zente përfundi. Do të bâheshim përsëri skllavë të përbindëshit, i cili do të na kapte me qëllim të keq e do të na përbinte për kurgjâ.

Nuk po flas vetëm për ndonji rrezik të trilluem. Ai rrezik âsht i tmerrshëm dhe i vërtetë.

Na mujmë dhe duhet patjetër ta largojmë. Si do t'ia dalim këtij qëllimi, le të na tregojë llogarija që e quejmë Plani pesëvjeçar i zhvillimit t'ekonomisë popullore. A e njeh këtë llogari ase preventiv? A u informove, ase a të kanë informue mbi detyrat që të presin?

2. A don rrobe të reja? — kjo gjâ nuk më intereson!

Me të vërtetë do t'ishte ushtar shembulluer ai që do të pyeste në valën e luftës: »shka të bâj?«

A do t'ishte ai ushtar i mirë? A do t'ishte puntuer i mirë ai që as tash, gjatë Planit tanë të parë pesëvjeçar, nuk do të dinte ende se shka të punojë!

Me gjithë këtë, ka ende shum njerëz që nuk e shohin se shka duhet të punojnë. Madje jo vetëm kaq. Ata ende nuk duen me pa se duhet dishka të punojnë. Ata nuk pyesin vetvehten se shka duhet të punojnë. E aq mâ keq, disa madje nuk duen me pa se tash gjëndemi në vjetët e Planit pesëvjeçar.

Ata nuk i intereson kjo gjâ ... »Plani pesëvjeçar? Shka mund të jetë ky? Pse duhet të më interesojë edhe mue kjo gjâ. Ndoshta unë nuk jam ndonji ekspert ekonomik! Kjo gjâ nuk âsht as puna ime as dega ime. Shka më intereson mue kjo gjâ! A mos e kam shpikë vetë? Ai që e ka shpikë, le ta ketë për nder!«

Pyete se a mos dëshiron të ketë rrobe të reja? Ase ndoshta dëshiron banesën mâ të mirë? Ase don që djali i tij t'i vazhdojë studimet?

A do të përgjegjej: »Kjo gjâ nuk më interesón! Le të ketë rrobe ai që i ka shpikë. Le të ketë edhe banesë të mirë — shka më interesón banesa, unë banoj në kasollë! Shka më interesón djali — në qoftë se nuk mund të shkollohet, le të mos shkollohet«.

Në gjithë tanë ka këso sorrash të bardha. Asht vështirë me gjetë njeri të kënaqun me ato shka ka dhe që nuk dëshiron kurrgjâ tjetër përveç këtyne. Shumica e njerëzve dëshirojnë me jetue sa mâ mirë, me u veshë mirë, me u ushqye mirë, me banue në banesa të mira dhe të mos detyrohen me punue për së tepërmi. Kurkush nuk e kundërshton rrogën e mirë. Disa duen që edhe të zbaviten, të tjerët shkojnë në theatër, koncerte, ekspozita; të tretët dëshirojnë libër të mirë. Në qoftë se janë të shëndoshë dhe të rij, dëshirojnë me formue familjen. Dëshirojnë me pasë fëmijë. E ata mâ të vjetrit gëzohen për sukseset e fëmijve të vetë dhe dëshirojnë që ata të kenë suksese sa mâ të mira në jetë.

Kurrgjâ nuk âsht mâ natyrale se sa të gjitha këto, me gjithë se disa nuk duen, ase nuk mujnë me kuptue se të gjitha këto deshira janë të lidhuna aq ngushtë me Planin pesëvjeçar, sikurse drithi e buka. Pa drithë nuk ka as bukë.

Pa plotësimin e Planit pesëvjeçar do të mbeteshin pa u krye të gjitha andrrat tona për nji jetë mâ të bukur.

Në qoftë se nuk punojmë, jo vetëm se nuk do të hamë, por nuk do të mujmë as me jetue, po që se nuk do të punojshin që të rregullohet çdo gjâ, e cila nevojitet për ndryshimin rranjësuer të krejt jetës sanë.

Vetëm ai që nuk e han bukën, të cilën e ka prodhue katundari ynë, ai nuk banon në shtëpín që e ka ndërtue muratori ynë dhe ai që nuk vishet me rrobet që i ka ba puntorja jonë — do të mundej me thanë se nuk ka interes për Planin tanë pesëvjeçar.

Plani pesëvjeçar nuk âsht dishka e veçueme prej jetës dhe komunitetit; ai âsht prona e përbashktë e të gjithë banorëve të shtetit tanë — e të të gjithë njerëzve të gjallë.

Kjo gjâ madje âsht e qartë si drita. Kur po e provoj këtë gjâ, po më duket se po flas kështu: kur dielli shëndrit, atëherë shihet çdo gjâ. Përsëri, asht e nevojshëme me folë edhe për punën, sepse ka të verbët që nuk e shohin dritën, edhe kur shëndrit dielli.

3. Burri dhe grueja

Te na ka shum puntore të vetëdijshëme, gra të kuptueshëme dhe vajza shum të vyeshëme. Shum prej tyne do ta lexojnë edhe këtë libërth. Por jo vetëm se do ta lexojnë, po edhe do ta kritikojnë. Do të dijnë me thanë se shka do t'ishte edhe mâ e nevojshëme me shkrue si dhe shka do të duhej me shkrue ndryshe. Ato e kuptojnë Planin tanë dhe nuk kanë nevojë me ua shpjegue shum gjana. Ato janë të vetëdijshëme se duhet ta ndryshojmë jetën tanë dhe se e ndryshon kushdo që punon. Ato e dijnë se komuniteti ynë po realizon sod veprën historike. Mbas pesë, dhetë ase njizet vjetësh pasardhësat tanë do të flasin mbi ata që »kanë plotësue Planin e parë pesëvjeçar«. Do të flasin se edhe gratë e kanë krye me nder detyrën e vet.

Madje askush nuk do të flasë për ato gra, të cilat nuk e dijnë ende se sod po kryhet Plani pesëvjeçar. Tash do të bisedojmë për një grue t'atillë. Ndoshta gratë e vitëdijshëme do ta kërkojnë mandej — në qoftë se jo shî këtë grue, sigurisht dikë tjetër — do të bisedojnë me të. Unë nuk dij me u gjetë në këtë punë.

— Përsëri! — bërtiti grueja si kapiteni mbi urën urdhnuese t'anijes së vet familjare. Përsëri je thellue në libër. A nuk do t'ishte mâ mirë të shkojmë në kinema! Ka nji javë që nuk kam qenë kurkund! Shka ka njeriu dobí prej jetesës? A thue nuk do të mujshe me shkue deri në »NA-MA« (Magazina popullore) me pa se a mos ka ardhë farë malli. Kam nji tubë bonash që do të më shkojnë dam!

Burri nuk donte me hapë luftë, por vetëm i kishte zanë veshet me gishta.

— A nuk të vjen marre? — ushtojshin fjalët si breshni. — Njeri i rritun, e siellet si nxânës shkolle.

Ja rrëmbeu librin prej dore.

E lexoi titullin: »Ligji mbi Planin pesëvjeçar të zhvillimit t'ekonomisë . . .«

— Këtë gjâ pra, po lexon? Të paktën të lexojshe ndonji romancë! Ato shifra! Shihet se nuk ke kurrfarë kulture. Dëshiroj me dijtë se a ka edhe ndonji gomar tjetër që lexon gjana të këtilla. Do t'ishte mâ mirë që t'interesohesh pak mâ tepër për familje. Duhet të kujdesohesh për jetesë. Në këto kohna, kur më duhet të pëlcas në kuzhinë si ndonji shërbëtore! Kur më duhet të laj tesha, të laj enët, e që tashmâ më janë prishë duert krejt. Natyrisht, shërbtore s'mund të më biesh. Shpenzon kot të hollat vetëm për libra të marra. Sikur t'ishje ti dishka, do të gjejshe ndonji punë mâ të mirë dhe do të mujshe me e mbajtë gruen mâ mirë. Pse martohet fare fukaraja si ti? Ma humbe krejt rininë time. Po vuej kot këtu për nji kësi të marrí! Zieje vetë gjellën! Unë po shkoj! Sod jam ngî me çdo gjâ! Nuk po due me e zî gjellën! Po shkoj në restaurant! Më jep të holla!

Nuk do ta ndigjojmë këtë grindje deri në fund. Nuk do të presim se a do të përgjigjet burri ndonji gjâ, ase do të heshtë edhe mâ. S'ka kuptim me pritë fundin e përrallave të tilla, që janë te na me të vërtetë shum të rralla, por ende të mundshëme. Asht mâ mirë që të bisedojmë me ato gra, të cilat kanë interes të madh se si Plani ynë pesëvjeçar do të ndikojë në zhvillimin e grues sanë. Shka kanë gratë për detyrë me punue.

Në red të parë më duhet me thanë se Planin pesëvjeçar nuk do të mundemi me e realizue pa pjesëmarrjen e grave. Ato gra që kanë lexue me kujdes Ligjin mbi Planin pesëvjeçar e dijnë se atje âsht shkrue edhe kjo gjâ: »Me realizue përfshimjen e fuqisë puntore femnore n'ekonomi në nji masë sa mâ të gjanë«.

Te na ka ende me mija gra që nuk janë përfshi n'ekonomi. Shka do me thanë »me u përfshi n'ekonomi?«.

Shum gra flasin me njifarë vetëdije profesjonale: »Mbajtja e shtëpisë âsht me të vërtetë detyrë shum me randësi! Ekonomija shtëpijake ndikon tepër thellë në ekonominë përgjithësisht. Nepër duert e shtëpijakes kalon së pakut gjysma e të gjitha t'ardhunave. Prej grues mvaret me të vërtetë se si përdoret ajo shumë kolo-

sale të hollash. Gratë shtëpijake janë edhe edukuese të fëmijve — gjâ që âsht detyrë e veçantë.

Prandaj, gratë si shtëpijake dhe edukuese a nuk janë, të përfshime n'ekonomi?«.

Këtê çashtje duhet ta shqyrtojmë edhe nga ana tjetër dhe vetëm atëherë do të mundemi me dhanë përgjegjet e duhuna. E ajo ana tjetër duhet kështu:

Shum gra — në qoftë se jo të gjitha — e skllavënon ekonomija shtëpijake. Grueja që hyn n'ekonominë shtepijake nuk mundet krejtësisht në mënyrë të lirë me e zgjedhë detyrën që âsht direkt e përfshime në prodhim dhe n'ekonomi. Ndodh që vajzat aftësohen për mesuese, për profesoresha, për detyra të ndryshëme tregtare dhe teknike — e mâ në fund i çojnë duert prej të gjitha këtyne dhe bâhen shtëpijake. »U duhet patjetër« me udhëheqë shtepin e për këtê shkak nuk mund të hyjnë në punë tjetër. Asht edhe mâ i madh numëri i atyne grave që nuk mund t'aftësohen për kurrfarë pune. Ekonomija shtëpijake e randon gruen aq shum me punë, sa që e pengon zhvillimin e saj.

Padyshim, ekonomija shtëpijake âsht e nevojshëme, por ajo nuk guxon me u bâ »detyrë« e damshëme. Grueja shtëpijake kryen shum punë të dobishëme, mirëpo, ekonomija shtëpijakë âsht ngarkim i panevojshëm për familjen dhe ekonominë, në qoftë se të gjitha gratë janë vetëm shtëpijake dhe në qoftë se për këtê shkak nuk mund të përfshihen në prodhim. Në kësi rasti — ekonomija shtëpijake âsht gjâ luksi. Me mija e mija gra shtëpijake kryejnë punët e veta në mënyrë joracjonale dhe të vjetrueme. Kryejnë ato punë që do të mujshin me u krye mâ mirë e mâ lehtë prej disa fuqive puntore me anën e maqinave në salla te mëdha e moderne për lamjen e rrobeve dhe në guzhinat moderne. Qytetet moderne socjaliste në viset industrijale e provojnë se kjo gjâ âsht me të vërtetë e mundshëme edhe te na kjo gjâ do të bâhet e mundshëme.

Të gjitha këto duhet t'ia tregonte grues ai burri që rrinte heshtë si peshku. Natyrisht, âsht pyetje e madhe në se ajo a do t'i ndigjonte fare fjalët e burrit, ase a do t'i kuptonte plotësisht. Mirëpo tash ka ardhë koha që do t'i mësojë edhe gratë e këtilla.

Por shumica e grave duhet të shihte, në qoftë se jo sod, atëherë pa tjetër nesër, se shka kërkohet prej tyne. Na kemi tepër pak njerëz për plotësimin e Planit pesëvjeçar. Prej grave që ende e shpenzojnë kohën dhe fuqít e veta gjithënjí me punët shtëpijake mvaret shtimi i armatës së puntorëve — farkuesve t'ardhmenisë sanë mâ të bukur. Prandaj të mos e përqeshin gruen, të cilës nuk i pëlqen mâ ekonomija shtëpijake, e që mû për shkak të saj i âsht mërzitë puna. Ajo ka të drejtë pse dëshiron me e lanë guzhinën. Por para se të shkojë në restaurant, le të hŷjë në fabrikë, puntori, zyrë ase në tjera vende të punës — e gjithkund do ta përshendesin si puntore. Sepse në këtë mënyrë ajo do të rradhitet në mes të njerëzve punuesa, të cilët, jo vetëm se kërkojnë prej komunitetit, por se edhe bâjnë dishka për të. Tue u ndodhë në qendrën e ngjarjeve dhe të krijimeve, ajo do ta dojë punën dhe do të përfshihet në turmat punuese si krijues i vetëdijshëm.

4. »Le të bâhet zotni«!

—Djali im shkon në shkollë, — tha katundari. —Le të bâhet zotni! Në këtë mënyrë atij nuk do t'i duhet, si mue, që gjatë të gjithë jetës, me u dërmue prej pune.

Kush ka qenë mâ parë »zotni« simbas mendimit të këtij katundari? Kush nuk ka pasë »nevojë« me punue?

Djelmoshat e shkolluem të katundit, shpesh herë kanë zgjedhë detyrën e klerit — ase këtë gjâ ua kanë zgjedhë ata mâ të vjetrit. Por, »zotni« ka qenë advokati, mësuesi, gjykatësi, nëpunësi. »Zotnija« ka qenë dishka krejt tjetër prej katundarit. Katundar i i dallonte detyrat e këtilla »të zotnijve«, por në të vërtetë nuk i ka respektue. »Zotnija« ka qenë para syve të tij »sheherli«, shka do të thoshte njisoj sikurse edhe rrugaç i veshun mirë. Prandaj detyra e »zotnijve« ka qenë njifarë mashtrimi. Ka qenë e nevojshëme me krye shkollën për të fitue privilegje që të mos punosh kurrgjâ, të hash dhe të pish mirë, të vishesh mirë — ndërsa katundari duhet patjetër të punojë. Pse edhe djali i katundarit të mos hypë aq naltë? Ka qenë e nevojshëme vetëm me e krye shkollën. Mirëpo, kush don me u shkollue, duhet të ketë të holla.

»Në vend që djalit t'i la trashigim, do ta shkolloj«, mendonte katundari, i cili besonte se ka »pak krypë në kry«.

Po qe se do të dojshim me e gjykue katundarin për shkak të botëkuptimeve të këtilla, do të na duhej me vû në dukje edhe mendimin që kishte qytetari për puntorët e thjeshtë — ase që kánë disa ende edhe sod.

Kur djali i qytetarit nuk mësonte mirë në shkollë, i ati i kërcnohej: »Në qoftë se merr ndonji dysh, do të të jap te këputctari që të bâhesh shegërt! Ase te muratori që te bâsh harasan, në mes të zhelanave dhe të fëlliqunve. Kush nuk don me u bâ zotni, le të bâhet rrugaç«!

Shumica e nxanësve të shkollave të mesme ka qenë nga familjet mâ të pasuna ase të mesme qytetare të nëpunsave. Ma pak ka pasë bij dhe bija të katundarëve e puntorëve. Në shkollat mâ t'ulta teknike shkollohëshin mâ shum fëmijt e zejtarëve.

Titujt teknikë nuk ishin të dishrueshëm te qytetarët. Nëpunsi kishte mâ tepër autoritet se sa, për shembëll, elektrotekniku ase zejtari.

Tregtarin e respektojshin mâ tepër se sa këputctarin ase muratorin.

Zgjuetësija e fëmijës, dëshira ndaj detyrave të ndryshëme, nevojat për detyrat e ndryshëme ekonomike — të gjitha këto kanë qenë gjana të dorës së dytë.

Kush do të mundej me e llogaritë damin që ka pësue shoqnija deri tash për shkak se shum fëmij të zgjuet të puntorëve nuk kanë mujtë me mbërrijtë në detyrat intelektuale — ase deri te ato detyra, ku ata do të mujshin me i tregue mâ mirë zotësít e veta!

»Zotni«, do me thanë profesor, mjek, ingjinjer, — e nga ndonjiherë edhe letrar ase artist — por t'atillë kanë mujtë rregullisht me u bâ vetëm ata të cilëve ua ka caktue »ora« këtë gja, e ajo ka pasë për parim në se prindët e tyne janë të pasun apo jo.

Dikur djali i nëpunësit bâhej mâ lehtë »zotni«, sepse nëpunësi banonte në qytet, afër shkollës, ndërsa familja e fëmijës së puntorit nuk kishte as banesë të përshtatshëme. Fëmijës së puntorit i duhej shum shpesh me ushqye vetvehten qysh para se të kryente shkollën.

Në t'ardhmen nuk do të kemi nevojë për zotnij dhe jozotnij. Në të gjitha degët e jetës ekonomike, shoqnore dhe kulturale na nevojiten profesjonalista, e kjo do me thanë puntorë që e kanë përvehtësue mirë degën e tyne, të cilët e kryejnë me gëzim detyrën e tyne dhe që janë t'aftë, jo vetëm për të punue, por edhe për të veprue e krijue në misionin e tyne.

Detyrat nuk mund të ndahen në detyra »të zotnijve« dhe »të ndyeta«. Këpuctari, muratori, oxhakfshisi, mekaniku etj. — janë profesjonalista në punën e tyne, e jo zhelana. Nëpunësi, profesori, ingjinjeri, tekniku, gjykatësi, janë shokë të puntorëve, e jo zotnij, të cilve puntori duhet t'u përkulet nga larg, ashtu sikurse njeriu i kulukut që duhej, para disa shekujsh, t'i përkulej aristokratit.

Na kemi nevojë për mija e mija specjalista. Prandaj rinija mundet me e zgjedhë detyren e vet midis nji numërit shum të madh detyrash. Mirëpo âsht e qartë se nuk kemi nevojë vetëm për nëpunësa e profesora; për çdo detyrë na duhet nga nji numër i caktuem kuadrash. Në çdo detyrë nuk guxon me pasë për së tepërmi njerëz në damin e ndonji detyre tjetër.

Prandaj pra po flasim që rinija duhet të drejtohet simbas Planit në zgjedhjen e detyrave. Para se njerëzit e rij të vendosin për detyrën e ardhshëme, duhet të paktën deri diku ta njohin jetën, të shohin se shka do me thanë çdo detyrë dhe shka kërkojnë ato prej njeriut. Ata duhet të dijnë dishka mâ tepër nga aí qytetari dhe katundari, të cilët i kanë nda njerezit deri tash vonë, në njerez që punojnë dhe n'asish që nuk punojnë, i kanë nda — simbas veshjes — në »zotnij« dhe në »njerëz të lanun«.

Rreth kësaj gjâje na duhet të bisedojmë edhe mâ.

5. Ku janë nji miljonë njerëz?

Kërkojmë nji miljonë njerëz.

Deri në mbarim të vjetit 1951 duhet t'i gjejmë patjetër. Por edhe mâ përpara duhet të gjejmë me qinda mija njerëz.

Kërkojmë nji miljonë puntorë të mirë, specjalista — tehnikë, ingjinjerë, kimikë, agronomë, gjeometra. Për nj'a katër vjetë

duhet të punojnë te na patjetër afërsisht edhe nji miljonë njerëz. Për çdo vjet na duhen sa mâ tepër kësish.

Kush pyet ende pse na duhet aq shum fuqi puntore? Në të gjithë kapitujt e deritashëm biseduem mbi themelet e pamvarësisë sanë ekonomike. Unë po përpiqem me provue vazhdimisht se si na nevojiten luftarë të mirë dhe të shumtë.

Jam përpjekë me i bindë shoqet shtëpijake se sa âsht shum e nevojshëme që të bashkohen me né në këtë përleshje të madhe. Asht fjala edhe për ato, e jo vetëm për né.

Çdo puntore, pa marrë parasyshë se a âsht në fabrikë, në zyrë, në punët e ndërtimit, në puntori, në shkollë ase në pasunin bujqësore — mund ta zëvendësojë lehtë mashkullin.

Kam dashtë me thanë gjithashtu se kemi tepër pëk njerëz të shkolluem: puntorë të shkolluem, teknikë dhe specjalista që dijnë me i përdorë maqinat, me udhëheqë punimet; me hartue plane për maqina dhe ndërtime të reja, me ndërtue maqina, me zbulue rezerva xehesh dhe me bâ mrekullina si kimikë. Na kemi tepër pak ingjinjerë. Na duhen shum mâ tepër agronomë. Ka pak edhe shkencëtarë, të cilët do t'iu përvisheshin plotësisht çashtjeve »praktike« të jetës sanë.

Duket si me pasë qenë i friguem prej shifrave, por tash duhet me dalë me fakte para jush. Mos u frigoni pa nevojë.

Në ministrinat tona gjinden me të vërtetë specjalista që punojnë shum, me shifra dhe llogari. Ata na kanë shenue aq shum shifra në Ligjin mbi Planin pesëvjeçar, sa që kryet do të na dhimbte, mâ parë se sa të thelloheshim në to ashtu si duhet. Edhe mâ tepër do t'i dhimbte kryet atij që do t'i shiqonte këto shifra vetëm sipërfaqshëm. Nuk ka nevojë që ato të mësohen përmendësh, sikurse kanë mendue ndoshta disa. Te na shum kush ka fillue me e studjue Ligjin mbi Planin pesëvjeçar, ase, si thuhet, me studjue Planin. Nga ndonjiherë e kanë studjue si tue mësue gjeografinë kineze. »Me të vërtetë âsht gjâ e dobishëme«, kanë mendue, »sikur të mësohet kjo gjâ, por unë nuk shoh se pse do t'ishte e nevojshëme që t'i mësoj këto shifra«. Njerëzit e atillë nuk kanë qenë të vetëdijshëm se në të vërtetë po studjojmë planin për nji luftë të madhe, të cilën duhet patjetër — dashtë e padashtë

— ta fitojmë vetë, sepse ajo âsht lufta për egzistencë, luftë për nji jetë mâ të bukur për të gjithë né, luftë për konsolidimin e lirisë sanë, luftë për socjalizëm.

A e din se shka janë preventivet e specjalistave në Komisjonin e planit? Shka duhet gjatë kohës së Planit pesëvjeçar të bâjnë, jo vetëm të gjitha së bashkut ase dikush tjetër, por edhe shka duhet të bâsh ti vetë? Kush t'i bâjë të gjitha këto? Kemi nevojë edhe për nji miljonë njerëz e madje vetëm deri në mbarim të Planit pesëvjeçar.

Na duhen edhe 370.000 puntorë »të thjeshtë« (të pakualifikuem) dhe 400.000 të mësuem (të kualifikuem). Përveç, këtyne, kemi nevojë edhe për 90.000 specjalista me kulturë të shkollave të mesme. Por edhe me kaq nuk jemi ende të këndaqun. Kemi nevojë edhe për 45.000 njerëz me kulturë akademike, e kjo do më thanë njerëz që do të marrin diploma n'univerzitete. Kur t'i mbledhim të gjitha këto shifra do të dalë numëri 905.000. Këto nuk janë vetëm shifra — këta janë njerëz, njerëz që na duhen. Natyrisht, ky nuk âsht plot nji miljonë, por me kaq nuk mund të pajtohemi. Madje sikur të kishim edhe plot nji miljonë njerëz mâ tepër, nuk do t'ishin shum tepër.

Pra, kërkojmë nji miljonë njerëz. Ndoshta do t'i gjejmë pa vështirësina të mëdha me mijâ puntorë të pakualifikuem. Në katund ka tepër kësish, që jetojnë vështirë nëpër prona të vogla. E madje edhe nëpër prona të mëdha, ku toka po fillon të punohet me maqina, nuk do të ketë ma aq nevojë për nji numër të madh njerëzish. Por ku t'i gjejmë puntorët e mësuem. Zejtari duhet ta mësoje zejen e vet afër tre vjetë. Nxanësi n'ekonomi që punon në fabrikë nuk mund ta mësojë zejen për nji natë. E ai nuk mëson zejen në punë, por edhe në shkollë. Specjalistat kanë vërejtë se nuk kemi mjaft nxanësa n'ekonomi. Në vjetin e kaluem kanë qenë shti në punë, derí në mbarim të vjetit, në mbarë shtetin, vetëm 60.000. Sikur të gjitha sipermarrjet t'i respektojshin dispozitat mbi marrjen në punë të nxanësave n'ekonomi, numri i tyne do të dyfishohej nëpër të gjitha sipërmarrjet. Kjo do me thanë se me katë rast do të kishin 120.000 nxanësa n'ekonomi. A do të mjaftonte kjo? Deri në mbarim të Planit pesëvjeçar do të mësojshin

zejen — natyrisht, në qoftë se të gjithë nxanësat n'ekonomi do të qëndrojshin në detyren e tyne dhe në qoftë se nuk do të sëmundej asnji — 240.000 puntorë, dhe sikur koha e shkollimit të vazhdonte vetëm dy vjetë e gjysëm. E ku janë edhe 160.000 puntorë të mësuem, që të kishim kështu 400.000?

Mandej, janë 90.000 njerëz me kulturë të shkollës së mesme dhe 45.000 njerëz me kulturë akademike shka të gjithë së bashku bajnë 135.000 njerëz. Sa nxanës e ndjekin shkollën? Në vjetin e kaluem, në klaset e fundit, ka pasë nëpër gjimnaze 47.000 nxanësa, në shkollat e mesme profesjonale — 50.000 dhe n'univerzitete — 38.000. Në qoftë se mundohesh pak me llogaritë, do të shohish se po shkollohet nji numër i mjaftueshëm njerëzish, por pyetja âsht se sa prej këtyne do ta kryejnë me të vërtetë shkollën. Nji përqindje bukur e madhe e nxanësave nuk po e kryen shkollën zakonisht.

Afër 3.000 nxanës në këtë vjet do të kryejnë shkollat e mesme profesjonale. Do të regjistrohen afër 16.770 nxanësa të rij; mirëpo, në vjetin e ardhshëm duhet të kemi patjetër 18.000 specjalista të shkolluem, kështu që të kemi mjaft në vjetin 1951.

N'univerzitete kemi mâ se 37.000 ndigjuesa. Në këtë vjet do të diplomojnë afër 2.000 studenta. Me këtë rast nuk duhet të harrojmë se numri i studentave nuk iu përgjigjet nevojave të çdo dege. Në disa degë do të ketë nevojë me pasë mâ pak, a në disa mâ tepër. Gjithashtu duhet të dijmë se shum studenta nuk i japin ende provimet rregullisht. Kjo do me thanë se studimet i vazhdojnë për nji kohë mâ të gjatë se sa âsht parapa. Sivjet do të regjistrohen n'univerzitete afër 9.000 studenta. Numër mâ i madh studentash, nuk mund të regjistrohen, sepse mund të regjistrohen vetëm aq sa kanë krye shkollën e mesme. Përveç kësaj, shum vetë prej atyne që kanë krye shkollat e mesme nuk i vazhdojnë studimet mbas kryemjes së shkollës së mesme.

Ashtu! Tash e shiquem të vertetën me sy. Numëri i nxanësave në shkollat e mesme profesjonale duhet të trefishohet patjetër gjatë Planit pesëvjeçar. Nuk do të numëroj mâ. Shkurt — njerëz të shkolluem ka tepër pak. Duhet të ndërtojmë patjetër shum shkolla të reja, në të cilat do të dërgojmë shum mâ tepër

nxanësa. Specjalistat që udhëheqin ekonominë tanë do të propozojnë masa krijuese që t'i jepet fund njiherë e përgjithmonë shkollimit të pakujdesshëm dhe të caktimit me hamendje të fuqisë puntore për çdo detyrë. Në këtë drejtim Plani pesëvjeçar âsht gjâja jonë e përbashktë. Prandaj edhe këtu duhet të ndihmojnë patjetër njeni tjetrin. Duhet të ndihmojmë që të kërkohen dhe të gjinden nji miljonë njerëz.

6. Orat janë hutue

Dikur besohej se fjalën e parë dhe vendimtare mbi ardhmeninë e njeriut e kanë orat e njeriut. Fundi i fundit, atëherë nuk ndodhte kurrgjâ pa pjesëmarrjen e disa fuqive mâ të nalta të mëshehta, që i prijshin njeriut, e që ky nuk ka mujtë me i kundërshtue. Pra, për këtë arsye qysh me rastin e lindjes së njeriut ora ishte aty, që i jepte në dorë — para se të qante — dikuj pendën, dikuj lopatën, dikuj kallëpin e këpuctarit, e atij për të cilin kishte veçanisht simpathi — arkën e bankës. Çdo gjâ ishte pregatitë-bukur dhe vulosë qysh përpara. Ti do të jesh pastrues, e ti profesor; ky do të jetë fabrikant, e ai zjarmndezës. E shka kanë caktue këto ora për ne?

Më duket se orat te na janë mashtrue në llogari. Nuk na intereson kurgjâ se çfarë qellimesh kanë pasë ato me ne, mbassi se shka do të mbërrijë gjithkush mvaret prej vetë atij. Tash shkollat janë të hapuna për të gjithë, madje për mâ tepër edhe për puntorët e rritun, të cilët mund të shkollohen në gjimnazet e natës. Dikur orat kanë pasë parasyshë, në radhe të parë, se në çfarë familje ka lindë secili. Atëherë njerëzit lindeshin si të vorfën dhe pasanika t'ardhshëm. Kurgjâ nuk mund të ndryshohej. Para të vorfënve mbylleshin të gjitha dyert; dyert ishin të vulosuna për këta me shtatë. vula — për çdo hap përpara nevojitej nji betejë e vështirë. Mirëpo, para pasanikëve çdo derë hapej vetvetiu.

Profesorat që japin mësime n'univerzitete dhe akademitë tona kanë shkrue para disa kohë librin »Shka të studjoj«? Ata, si njerëz me përvojë, kanë paraqitë para maturantave, të cilët i

lanë shkollat e mesme pasqyrën e mbarë dijes njerëzore dhe të detyrave të bukura, pasqyren e botës me ardhmeni agadhnjyese. Njeriun, që pregatitet për një jetë më të bukur, e tërhjek gjithkund dishka interesante. Për shka të vendosish? Mund të bâhesh profesor ase mjek, ingjinjer ase gjykatës, fotograf ase artist — kësish ase asish.

Ti do të kesh ende kohë për me vendosë, kurse shum prej nesh nuk kemi mâ. I kemi përvjelë duert dhe tashmâ po krijojmë atë që mundemi secili në detyren e vet. As nuk mundemi me ta përshkrue se me çfarë kënaqësije do të ndërroheshim me tyj, para të cilit janë hapë dyert e univerzitetit. Çdo gjâ âsht ende para teje, do të hapen të gjitha dyert, tashmâ nuk ndahemi në pasanikë dhe të vorfën.

Do të të pranojnë me krahë hapët si ingjinjer ase mjek, si veterinar ase arkitekt, si agronom ase profesor. Ndoshta ke prirje për artin theatral? Kush e din, ndoshta do të bâhesh skulptor ase fotograf i njohun? Ndoshta do të bâhesh kimik, e do t'i ndash

»Kemi nevojë për mija specjalista të shkolluem... Tash shkollat janë të hapuna për të gjithë«

atomet? Ndoshta do të bâhesh mjek e do të shërosh sëmundje tash për tash të pashërueshëme, e ndoshta do të ndërtosh aeroplana të çuditshëm, për të cilët na tash as nuk andrrojmë? Kush e din — ndoshta do të bâhesh ekonom, shkencëtar, që do të drejtojë jetën, që maqina ekonomike të na nënshtrohet, ashtu si automobili timonit.

Tash vendos vetë. Profesorat të kanë shpjegue se çfarë degësh të shkencës mësohen në çdo fakultet dhe akademi. Të kanë thanë mjaft qartë se studimet nuk janë të lehta. Studimi n'univerzitet nuk âsht dëfrim, me gjithë se ndonjeni do të dëshirontë me e bâ kështu. Simbas planit të ri mësimuer u ka kaluë koha atyne që përsëritshin klasat, të cilët studjojshin n'univerzitet nga dhetë vjetë dhe krenoheshin me titullin »student i përjetshëm«. Ai që regjistrohet n'univerzitet, duhet patjetër edhe të studjojë. Kështu âsht kjo punë; kush jeton, duhet patjetër të punojë. Edhe nxanësi duhet t'i kryejë detyrat e veta. Shka do të bâhej sikur puntori t'i lente mbas dore detyrat e veta; sikur katundari të shtrihej në fllad, në vend që të lëvronte? Kjo gjâ nuk do t'ishte e mirë për kërkend. Do t'asgjasoheshim nga skamja, mbrapambetja dhe padija.

Kemi folë mjaft gjatë se sa njerëz na duhen që të përmirësohet jeta. Na edhe ty të llogarisim n'atë miljonin e puntorëve, që duhet patjetër ta kemi qysh në vjetin 1951. Edhe prej teje mvaret se si do të jetojmë në vjetët e ardhshëm. Do të na duhesh me doemos. Nuk do t'ishte shum herët sikur qysh nesër të mundesh me u diplomue. Në qoftë se i kryen studimet në kohën e caktueme, do të jesh në mes t'atyne, të cilët do ta kryejnë me nderë detyrën e vet në luftën tanë për ardhmeninë mâ të bukur. Do të jesh midis atyne, të cilët duen me e shlye turpin e madh të rinisë sanë universitare, sepse deri tash, për shembëll, në Fakultetin e teknikës — i cili duhet me na dhanë patjetër mâ shum specjalista shum të nevojshëm — i kanë krye provimet rregullisht, pa shtyemje kohe, vetëm 20 përqind të ndigjuesave. Kjo do me thanë se shum studenta e kanë vijue univerzitetin mâ shum vjetë se sa ka qenë e nevojshëme. Kështu i kanë zgjatë studimet universitare, e kanë humbë kot kohën. Nuk i kanë shërbye kurgjâ

komunitetit, por e kanë damtue edhe mâ tepër. Disa prej tyne nuk kanë dhanë as provime. Brumbuj të këtillë nuk do të ushqejmë mâ.

Rinija sod përpiqet me provue se do të jetë edhe mâ e mirë se sa luftarët burra të vetëdijshëm. Ajo merr pjesë kudo që luftohet për ardhmeni mâ të bukur. Rinija sod ndërton vetë hekurudha dhe tabrika. Ajo ndodhet në ballin e garës së përgjithshëme popullore. Ajo po fiton. Na shërben si shembëll.

Por, rinija do të korrë fitore mâ të madhe, në qoftë se gjatë Planit pesëvjeçar, i plotëson rradhët e specjalistave tanë — teknikëve, ingjinjerëve, puntorëve të kualifikuem, ndërtuesave dhe të mjeshtërve — në të gjitha fushat e punës dhe të krijimit, në qoftë se deri në vjetin 1951 do të shkollohen 135.000 specijalista nepër shkollat e mesme, shkollat profesjonale dhe nëpër univerzitete. A thue nuk po të tërhjek kjo luftë, që të hysh në rradhat e para të saj?



Krue i gjashtë

PUNTORI ME NJIMIJË DUER

1. »Ta kemi prû shtëpinë«

Në nji shtet do të ndodhin gjâna të çuditshëme. Për shembëll:

Puntori do të dëshirojë shtëpinë e bukur. Puntorët kanë dëshira të këtilla edhe në viset e tjera të botës, por ato zakonisht mbeten të parealizueshëme. Por n'atê shtet puntori do të ketë gjithshka të dëshirojë dhe t'i duhet.



Pra, puntori do të dëshirojë shtëpín. Derisa ai e këqyrë me kënaqësi vendin se ku do të ndërtojë shtëpín, do të mbërrijë nji varg komisjonesh. Ata do të ndalen dhe dikush do të bërtasë: »ta kemi prû shtëpinë«!

Shtëpín do ta shkarkojnë prej automobilave. Me njiherë do të fillojnë me e çue, ashtu sikurse të kishin të bâjnë me ato lojnat, që i vejnë fëmijt njenën mbi tjetrën kur »ndërtojnë«. Me gjithë

këtê, ajo shtëpi nuk do të jetë prej druni. Ajo nuk do t'i përngjajë aspak kasolles. Ajo do të jetë shtëpi e vërtetë, me të vërtetë e bukur. Në fillim nuk do të mundesh me e vërejtë se prej çfarë landë janë pjesët përbamëse të saj. Sod nuk ka ende aso landesh. Do t'i gjejmë. Gjatë Planit pesëvjeçar do të fillojmë me ndërtue t'ashtuquejtunat masa plastike. Ato do të jenë materje të krijueme në mënyrë artificjale: dru artificjal, tulla artificjale, llastër artificjale, porcellan artificjal.

Mbrenda pesë vjetëve.

Mos pyet kurrsesi se ku gjindet ai shtet. Ai shtet quhet Republika Federative Popullore e Jugosllavisë. Këto katër fjalë a nuk ta tregojnë mjaft qartë? Apo nuk i besojmë vetvehtes sanë, a nuk i besojmë Planit tanë pesëvjeçar?

Mbrenda pesë vjetëve do të ndërtojmë edhe këso shtëpijash. Do të kemi fabrika për ndërtimin e shtëpive. Nuk do të prodhojnë mâ në fabrika vetëm ciment, tulla, hekur dhe materjal tjetër të ndërtimit. Para njiqind vjetëve nuk ka pasë ende fabrika cimenti, ase fabrika të mëdha për tulla të pajosuna me maqina. Atëherë nuk dihej ende për betonarmé. Edhe arqitektura po përparon. Ajo deri tash ka qenë në të vërtetë në shkallen e zejtarisë, e tash do të fillojmë me prodhue edhe shtëpija në mënyrë industrijale. Te

na fabrikat prodhojnë tashmâ disa pjesë përbamëse te ndërtesave. Na tashmâ prodhojmë në mënyrë industrijale betonarmé, simbas metodes së Ferjanovit. Kemi fillue tashmâ me ngritë ndërtesa, e jo vetëm me i ndërtue dhe me i bâ me beton.

Me prodhimin e shtëpijave të gatshëme, punët e ndërtimeve do të lirohen dhe do të shpejtohen shum. Në këtë mënyrë edhe shum njerëz tanë, të cilët kanë banue deri tash nëpër baraka, podrume dhe kasolla të ndryshëme do të kenë shtëpija të përshtatshëme. Në banesa të reja ata do të ndiejnë vehten me të vërtetë si njerëz. Do të dalin prej kasollave dhe podrumeve johygjenike të shekullit të mesëm. Mb'anën tjetër edhe katundari nuk do të jetë i gjykuem që të vuejë në kasolla me ajr të ndyet, t'errta dhe me lagështinë. Do të bâhemi njerëz të vërtetë. Do të kalojmë prej kasollave në shtëpija të vërteta. Me të vërtetë do të fillojë koha e re, sikur atëherë kur njeriu ka lanë shpellën e nëntokës dhe kur ka fillue të dallohet prej kafshëve t'egra për kah vendbanimi i vet.

Po flitet për ligjin, nuk po tregohen përralla. E ligji mbi Planin pesëvjeçar, përveç tjerash, sjell edhe këtë gjâ: »Me ndërtue (mbrenda pesë vjetëve) 15 miljonë metra katrorë sipërfaqe ndërtesash të reja banimi nëpër qytete dhe katunde«.

Sipërfaqja e ndërtimit, âsht ndërtesa e mbulueme. Në qoftë se shtëpija âsht e gjatë dhetë metra dhe e gjanë tetë metra, atëherë sipërfaqja e ndërtueme përfshin 80 metra katrorë. Sipërfaqja e këtillë përbân me të vërtetë nji banesë të bukur, të përshtatshëme. Mirëpo, te na ka shum pak puntorë që kanë banesa me dy dhoma. Ka pak edhe banesa që kanë dhoma me nji sipërfaqe prej 16 deri 20 metra katrorë.

A e din se sa banesa me dy dhoma e me sipërfaqe prej 80 metrash katrorë do të kemi në 15,000.000 metra katrorë ndërtesash të reja? Njiqind e tetëdhetë e shtatëmijë e pesëqind! Në qoftë që marrim se familja ka mesatarisht katër pjesëtarë, tri të katërtat e nji miljoni njerëz, do të hyjnë mbrenda pesë vjetëve, nën kulmin e shtëpijave të reja moderne. E në qoftë se sipërfaqen e re të banimit e ndajmë vetëm në banesa me nga nji dhomë, në to do të mujshin me u vendosë afër 1,500.000 njerëz. Në çdo rast qysh në vjetin 1951 në shtëpija të reja do të mujnë me banue mâ

së paku nji miljon njerëz. Në të gjitha këto nuk janë marrë parasysh shtëpijat e meremetueme dhe të rindërtueme që janë damtue gjatë luftës.

Kjo kurrsesi nuk âsht pak. Duhet patjetër të kemi parasysh se muratorëve tanë do t'u duhet me ndërtue edhe shum ndërtesa tjera, e jo vetëm shtëpija për banim. Shuma prej 30 miljarda dinarësh, sa âsht caktue për qëllime ndërtimi nuk âsht e vogel padyshim. Kurr mâ parë nuk kemi ndërtue kaq shum. Kurr nuk kemi pasë nevojë për kaq shum tulla, ciment, hekur dhe dru: Na duhen kodra të tana gëlqereje dhe zalli. Na nevojitet ciment shum mâ tepër — prandaj kërkojmë që edhe fabrikat e cimentit ta shtojnë prodhimin, prandaj po i zgjanojmë edhe fabrikat e vjetra të cimentit, e do të na duhet me ndërtue edhe fabrika të reja.

Na duhet t'i shpejtësojmë patjetër punimet e ndërtimeve. Muratorët nuk kanë mjaft duer. Kush t'iu vijë në ndihmë? Këta ndihmohen prej banorëve të qyteteve dhe të katundeve në kohë të lirë. Ata iu pregatisin landët dhe bajnë punë të ndryshëme, të cilat kryhen zakonisht prej njerëzve të paspecjalizuem.

Por të gjitha këto janë ende shum pak. Me miljona orë pune vullnetare janë dhanë tashmâ për ndërtesat e panumërta të rindërtueme, për rrugët, urat, hekurudhat, për rregullimin e lumejve, për pyllzimin e kodrinave të zdeshuna — e me gjithë këtë të gjitha këto janë tepër pak. Do t'ishte mirë sikur çdonjeni prej nesh të kishte nga dhetë palë duer. Duhet dikush të na ndihmojë patjetër. Na duhen puntorët, të cilët kanë nga nji mijë duer. Na i njohim ata puntorë e disa prej tyne i kemi qysh tash. Këta puntorë do të na ndimojnë edhe në ndërtesa, e jo vetëm në fabrika, në rrugë, me rastin e hapjes së tuneleve dhe në punët bujqësore.

2. Mirë se keni ardhë!

Kemi nevojë për qinda mija puntorë të rij. Prandaj gëzohemi dyfish për emigrantat tanë, të cilët po këthehen nga vendi i huej shfrytzues. Ata nuk do të janë mâ shërbëtorë. Do të punojnë për vendin e vet dhe për vehten e tyne. Do të punojnë për vehten e tyne. Po gëzohemi që po këthehen dhe se nuk do të jenë mâ njerëz

të humbun për atdheun e tyne. Po gëzohemi edhe për arsye se ata do të na ndihmojnë në ndërtim. Mirë se na vini!

Do t'i përshendëtshim edhe puntorët me duer të hekurta, që çojnë barrë shum të mëdha, si me qenë lojë fëmijsh, të cilët hapin kanale me lopata shum të mëdha, të cilët çajnë shkrepa, sikurse t'ishin ata prej dylli, të cilët tërheqin kodra të tana barrësh. Kemi nevojë edhe për nji numër të madh puntorësh tjerë të ngjajshëm. Jo vetëm se kemi nevojë — ata duhet patjetër t'i kemi se japë të doemosdoshëm. Na i presim ata si miq dhe shpetimtarë mâ të mirë.

Do t'i presim kot, po qe se mendojmë që ata ndihmësa do të na vijnë vetiu. Sikur të na i dërgojshin prej shteteve tjera, nuk do të mujshim me i përshëndetë dhe do t'i pranojshim me mërzi, sepse bota e jashtëme nuk fal kurrgjâ; ajo synon vetëm me marrë. E me shka do t'ua paguejshim? Me duer të ndrydhuna e të përgjakuna ase me atë shka duem mâ tepër se të gjitha visaret e tjera — me lirin tanë.

Prandej kemi nevojë sa mâ parë dhe për sa mâ shum puntorë mekanikë — maqina prej fabrikave tona.

Dëshirojmë të kemi maqina ndërtimesh, të cilat do ta shpejtojnë punën në ndërtesa të shumta. Ato maqina do të ndërtojnë fabrika të reja, centrale elektrike, do të na ndihmojnë me ndërtue hekurudha dhe tunele, do të hapim kanale me anën e të cilëve do të mund t'ujitim fusha të mëdha në mënyrë që të na japin fryt të paktën nga dy herë në vjet. Do të punojnë në fabrika mâ me dobi se të vjetrat, do të prodhojnë atje pjesë përbamëse për ndërtesa t'ardhshëme. Gjithkund do t'i përshendesin me »Mirë se na erdhët«!

Vetëm mos pyet se kush do të na i japë!

Edhe të vetë e din mirë se maqina nuk fal kurrkush; na duhet patjetër t'a prodhojmë. Do t'i prodhojë industrija e jonë e metaleve, ase fabrikat tona të maqinave. Do t'i prodhojmë në fabrika të mëdha Maqinat për prodhimin e veglave do t'i prodhojmë në Zheleznik afër Beligradit. Atje rinija po e ndërton fabrikën e madhe, e cila duhet të jetë e gatshëme sa mâ parë. Ajo fabrikë do të prodhojë maqinat mâ të randa të veglave. Në Zagreb ka

fillue tashmâ nga puna fabrika për prodhimin e maqinave të veglave të mesme — »fabrika Nji Maj për maqina veglash«. Por ajo nuk âsht e madhe aq sa duhet. Prandaj po e zgjanojmë: Në Sarajevë do të ndërtojmë prap fabrikën e maqinave të veglave të lehta. Na flet për maqinat bujqësore, të ndërtimit dhe për maqina tjera. Kemi nevojë për kazana avulli, për turbina, për vinça, për stabilimente xeheroresh. Jugosllavija para luftës, mbassi ka qenë vend gjysëm kolonjal, nuk i ka prodhue të gjitha këto.

Shteti ynë gjindet në rrugën për në socjalizëm. Këtê rrugë do të na e hapin puntorët me nga nji mijë duer-maqinat. Kushdo që ta vërejë dhe të çmojë dallimin në mes të Jugosllavisë së para luftës dhe të shtetit tanë populluer, do të shohë se Plani ynë pesëvjeçar âsht koha e mrekullive, kohë e këthesës sanë historike.

3. Çfarë dallimi ka midis katundarit dhe puntorit?

Dikur katundari nuk e nderonte puntorin sa duhej. E kanë edukue në mënyrë që punën e puntorit të mos ta çmojë si të vehten. I kanë thanë madje se ai mundet me jetue pa puntorin, e se puntori nuk mundet me jetue pa të. Aq mâ tepër, i kanë thanë se katundari e bân krejt barrën në shpinën e vet. Të gjithë jetojnë prej katundarit dhe në të vërtetë janë çanaklëpimësat e tij. Të gjithë të tjerët janë dembela, prandej katundarit i duhet me punue edhe mâ shum, sepse duhet me ushqye shum njerëz që humbin kohën kot.

Tash katundarët nuk iu besojnë mâ fjalëve të këtilla. Të paktën nuk iu besojnë shumica. Sikur ndonjeni prej tyne të harronte, të tjerët do të mësojshin dhe do t'i kallzojshin se mashtrohet keq. Katundari dhe puntori janë sod miqtë mâ të mëdhaj. Ata e ndihmojnë njeni tjetrin dhe e dijnë se nuk mund të jetojnë pa njeni tjetrin. Do të iu dukej marri që të prishin fjalet, tue thanë se cili âsht prej tyne mâ i nevojshëmi — njilloj sikurse nuk do të mundte të prishte fjalët asnji njeri i mençëm se kush âsht mâ e randësishëme rrota apo boshti i qerres. Katundari nuk i mbaron mâ vetë as rrobet as veglat. Qerrepunuesi ia mbaron qerren, farkatari ia farkon pllugun, puntori i fabrikës ia prodhon kosën, sopatën,

sharrën. Puntorët prodhojnë pleh artificjal, rregjin lëkura, mbarojnë kapucë, enë shtëpijake, voj, shkrepsa, gurë mullini, përpunojnë gazin dhe krypën. Pa të gjitha këto gjana, katundari nuk do të mund të jetonte, ashtu si jeton sod. Pa të gjitha këto ai do të jetonte sigurisht sikur shum shekuj mâ parë, kur lëvronte ende me parmendë, kur vishej me lëpura të kafshëve dhe ndezte zjarmin me unur. Në të vërtetë, ai nuk do t'ishte mâ katundar i vërtetë, por do t'ishte gjysëm i egër. Do të punonte shum mâ pak, e do t'i duhej me bâ punë shum mâ të vështira. Shpesh herë do të vuente. Do të vijshin vjetët e ujës së tmerrshëme dhe të sëmundjeve të pashërueshëme. Do të vdisnin katunde të gjitha. Njerëzit do të sulmoheshin prej bishave t'egra. Damtuesat do t'ua asgjasojshin korrën shpesh herë. Kështu do t'ishte edhe sod sikur të mos kishte ndryshue kurrgjâ. Por sod kanë ndryshue shum gjana. Para shum shekujsh katundari ka qenë ende i vetëm, e tash e ka me vehte aleatin e fuqishëm — punëtorin.

Puntori që rëmih thellë xehen në dhé, ku se sheh diellin kurr — nuk e rëmih për vehten e vet. Ai nuk vuen prej nxehtësisë së tmerrshëme dhe ajrit të ndyetë të furrave të Martinit dhe të furrave, për shkrimje, në fabrika të karpitit dhe të plehut artificjal — për t'i përdorë vetë ato produkte. Ai nuk hap kanale për ta ujitë fushën e vet, nuk ndërton shkolla që në to të shkolloheshin vetëm fëmija i tij. Ai nuk bân stof dhe pëlhura vetëm për fëmijt e vet. Ai nuk prodhon maqina, vetëm për t'ia lehtësue punën vetvehtes. Të gjitha këto ai i bân edhe për katundarin. Ato gjana që nuk mundet me i punue dhe me i prodhue katundari, i bân punëtori. E tue qenë se punëtori âsht i zanun në punën e vet ai nuk mundet me lëvrue vetë, për të prodhue bukë për vehten e tij. Puntori dhe katundari i kanë nda punët midis tyne. Do t'ishte marre me u zanë se cila punë âsht mâ e nevojshëme, sepse që të dyja janë të nevojshëme, si mbjellja ashtu dhe korrja. Në qoftë se nuk prodhon drithë, nuk do të mundesh as me blue, e të bâsh bukë prej tij. Në qoftë se don me pasë bukë, nuk mjafton vetëm të kesh drithë — pa miell nuk ka bukë.

Punëtori dhe katundari krijojnë pasuni materjale, të cilat janë tepër të nevojshëme për jetesë. Ata që të dy në të vërtetë

janë puntorë: njeni punon në fushë, e tjetri në fabrika ase në xeherore.

Ata dallohen vetëm për kah mënyra e punës. Puna bujqësore âsht vjetrue tashmâ kaherë. Punetori përdor mâ tepër maqina. Prandaj çdo puntuer bân mâ tepër punë se katundari. Katundarit i duhet gjatë gjithë ditës me lëvrue me kafshë pune. Sikur ai të lavronte me maqinë në vend të pllugut, krejt atë punë do ta bânte për dy deri në tri orë. Katundari që shtyp drithin me shtypës, shpenzon mjaft mund e shum ditë me rradhë për ta krye atë punë, të cilën maqina moderne fshimëse do ta kryente për disa orë.

Ky âsht nji dallim i madh. Natyrisht, kësi dallimesh do të zhduken patjetër. Toka do të na japë fryte shum mâ të mëdha tue derdhë mâ pak mund. Puna bujqësore do t'i afrohet patjetër punës industrijale. Atëherë punëtori dhe katundari do t'afrohen edhe mâ tepër — do t'i afrojë maqina. Shî për këto gjâ deshta me folë — por kjo gjâ qe e pamundshëme pa e bâ hyemjen e duhun.

4. Të dy anmiqtë: gardhi dhe traktori

Gardhi te na âsht nji gjâ aq e thjeshtë, sa të duket se nuk vlen të flasësh për të. Mirëpo, gardhi i vërtetë âsht në jetë pengesa mâ e madhe se sa lumi mâ i madh. Përmbi lumej mund të ndërtojmë ura dhe jeta nuk ka me u ndalë për shkak të tyne. Përmbi lumej kalojnë trena dhe automobila. Kurrkujt as nuk i shkon ndërmend se për shkak të lumejve nuk do të mundeshin me u ndërtue hekurudha ase, të paktën, të ndalej treni para tyne.

Mirëpo, para gardhit ndalemi të gjithë. Shpesh herë nepër të as nuk shohim se shka ndodh në botë. Nuk shohim se bota ka ndryshue; nuk shohim se tashmâ në shum vende kanë ra poshtë gardhiqet, të cilat, sidomos te na ndërtohen ende për së tepërmi. Te na lëvrohet ende mbrenda gardhiqeve, ashtu si lëvrohej, para njiqind vjetësh. Edhe vetë koha asht ndalë para gardhiqeve. Në cilin shekull po jetojmë? Në qoftë se shiqon kalendarin do ta keshë të qartë plotësisht se ky âsht shekulli i XX, e në qoftë se shiqon gardhin, do të vëresh se në disa katunde tona jetohet ende sikur t'ishte shekulli XIX ase madje i XVIII-ti.

Tash para gardhiqeve presin traktorat, maqinat kositëse dhe mbjellëse... Gardhi nuk largohet. Katundari as nuk shiqon nëpër te se shka ndodhë n'anën tjetër. Atij nuk i interesón se shka ka atje përtej gardhit.



»Kush do të fitojë — gardhi apo traktori? Fotografija jep përgjegjen e qartë.

Por qe, në katundin fqî i kanë rrëxue gardhiqet. Atje katundarët janë bashkue në kooperativa dhe lëvrojnë me traktor. Në nji katund tjetër, katundarët tashmâ po lidhin kontrata me stacjonet e traktorave për lëvrimin e tokës së vet. I kanë përmbysë gardhiqet, që traktori të mundet me lëvrue pa pengesa. Traktorat kanë lëvrue braza mâ të gjata dhe mâ të thella. Nuk ka mâ kufij të pashfrytzuem midis arave të vogla. Nuk ka mâ as ara të vogla. Arat e vogla janë bashkue në fusha shum të mëdha. Toka âsht lëvrue shpejt dhe mirë. Puna âsht krye me kohë. Tashmâ edhe tokat hamullore po fillojnë me u thye. Në vjeshtë toka bâhet

ugar, në mënyrë që të ngrihet më mirë, për të thithë më tepër azot dhe lagështinë dhe në mënyrë që të bâhet më e imtë. Arat filluen me dhanë fryt më të madh.

Por kjo gjâ âsht m'atë anë gardhit. Katundari âsht shum më tepër i pabesueshëm se sa kureshtar. Ai thotë: »Kështu ka punue edhe baba im dhe ka qenë mirë«. E kur t'ia tregosh traktorin që âsht ndalë para gardhit të tij, katundari do të përgjegjet: »Dikur jetohej më mirë, me gjithë se nuk dijshin se shka janë traktorat«. Me gjithë këtë, pyete pra katundarin se a âsht i kënaqun. A thue me të vërtetë nuk dëshiron kurrfarë ndryshimesh? A mos dëshiron me jetue si dikur, kur lëvrohej me parmendë dhe prashitej me shatë? A thue mos dëshiron që toka të japë fryt më të madh e që korra të jetë më e madhe?

Natyrisht nuk âsht i kënaqun. Për këtë gjâ koha âsht faktore Më parë as ajo nuk ka qenë aq e keqe. Thatësija, e mandej përsërj vetëm shi. Por edhe, pleh nuk kishte mjaft. Nuk kishte mjaft bagëti. As fara nuk ishte e shëndoshë. Gruni ishte me unthë. Damtuesat shkaktojshin mjaft dame. »Shka të bajmë, vështirë âsht në botë«, do të përgjegjej ai, tue besue se fati âsht i këtillë.

Shka të bâjmë? Nuk duem që të jetë keq në botë. Nuk duem që korra të mvaret aq shum prej kohës. Nuk duem që prodhimi të rrezikohet për shkak të mungesës së punëtorëve. Duhet të ketë mjaft pleh patjetër. Fara nuk guxon me qenë e keqe. Duem që të ndryshohet çdo gjâ me shka nuk jemi ende të kënaqun. Do të ndryshohet, sepse po përpiqemi me e mbërrijtë këtë gjâ.

Nji nga ndryshimet e para âsht përmbysja e gardhiqeve midis arave. Kjo gjâ âsht e nevojshëme që nëpër ara të fillojnë me punue punëtorët që kanë me qinda e mija duer hekuri. Gjatë Planit pesëvjeçar do të prodhojmë edhe mjaft maqina bujqësore. Mbrenda pesë vjetëve toka duhet të japë patjetër fryt më të mirë. Mbrenda pesë vjetëve duhet të ndryshojnë nga themeli patjetër edhe vetë jeta e katundarit tanë. Mbrenda pesë vjetëve duhet të shihet qartë edhe në fushat tona se jetojmë midis shekullit XX dhe nuk jemi më të mbyllun ndërmjet gardhiqeve të shekullit të mesëm; se nuk jemi më skllavë të fuqive të ndryshëme të duk-

shëme dhe të padukshëme, të zakoneve dhe paragjykimeve të tjera.

A ka qenë i kënaqun katundari në Jugosllavinë e para luftës? Në vjetin 1925, kur kanë qenë çmimet mâ të përshtatshëme dhe korra relativisht e mirë, velfta e punës së tij, e kjo do me thanë vlefta e prodhimeve të tij, ka qenë për nji hektar — në Sllloveni 3.370, në Sërbi 2.407, në Vojvodinë 4.223 në Kroaci dhe Sllloveni 3.700, e në Bosnë e Hercegovinë vetëm 617 dinarë. Katundari që ka pasë katër hektarë tokë fitonte në vjet, për shembëll në Sllloveni, produkte të ndryshëme me nji velftë prej 13.480 dinarë. Në ketë shum âsht numërue edhe vlefta e bagëtisë për farë. Duhet me pasë parasysh se katundari shpenzonte shumicën e prodhimeve. Ai shite vetëm aq sa i duhej me shitë për të mujtë me pague tatimin dhe me blé gjânat mâ të nevojshëme. Prandaj nuk ka qenë kurgjâ e jashtzakonshëme që disa familje katundari nuk kanë pasë as krypë.

A duhet të jetojë katundari gjithmonë kështu? A duhet të mbetet gjithmonë i rrethuem me gardhiqe, në skamje, në mosdije, me mashtrimet e vjetra dhe me frigë për shpirtin e tij, po qe se shiqonte nëpër gardh?

Kush do të fitojë, gardhi apo traktori? Pádyshim traktori, këtu nuk duhet me pasë kurrfarë dyshimi.

Kreu i shtatë

FABRIKA E JETËS

I. Vrasësi mâ i madh.

Vetë njeriu âsht vrasësi mâ i madh dhe mâ i tmerrshëm në mbarë botën. Pse? A thue nga shkaku se njerëzit çfarosen në luftnat midis tyne? Jo vetëm për këtë arsye, por edhe nga shkaku se asgjasojnë pyjet. Kur njeriu asgjason drunin në menyrë t'egër dhe pa u mendue, ai jo vetëm se ia zhgul vetvehtes rranjët e jetesës, por âsht edhe vrasës i të gjitha krijesave të gjalla. Kush nuk e din se shka âsht pylli, ai nuk e din se shka âsht jeta.

Në qoftë se dëshiron me kuptue se shka âsht pylli, duhet të dish mâ parë se shka âsht bima. Njerëzit, kafshët dhe bimët — të gjitha këto përbajnë nji komunitet të madh që quhet jetë. Në këtë komunitet gjithkush ka detyren e vet jetësore. Sikur të mos ishte njeriu, jeta nuk do të ndalej, — komuniteti do të jetonte edhe mâ. Por, sikur të shuheshin bimët, patjetër do të shuhej edhe bota e kafshëve, e së bashkut me këtë edhe njeriu. Por edhe bimët nuk do të mujshin me jetue gjithmonë vetëm. Kështu, për shembëll, në tokë-gjinden bakterije të shumta që prodhojnë materje ushqyese; ato materje thithen mandej prej bimëve. Ato këpurdhëza hyjnë në dhe me anën e plehut t'ahrijeve. Pa aleancën midis botës së bimëve dhe të kafshëve jeta nuk do t'ishte e mundshëme.

Bimët janë të vetmet mâqina të çuditshëme në planetën tanë, të cilat e ngjallin materjen e vdekun, xehet me materjet që i shërbejnë si ushqim njeriut dhe kafshëve. Ato janë materje organike. Bimët kanë atë veti që materjet inorganike t'i shëndrrojnë

në materje organike. Pra, pa bimë as njeriu as kafshët nuk do të kishin ushqim sepse guri nuk mund të shëndrrohet n'ushqim vetvetiu dhe na nuk dijmë ende me prodhue gjana ushqimore prej xeheve të vdekuna. E gurë nuk mund të hamë sigurisht.

Pra, shka »bajnë« bimët? Ato thithin prej tokës dhe ajrit si ushqim të vet ato materje, të cilat njeriu dhe kafshët nuk mund t'i hanë dhe i përpunojnë n'atë gjâ që âsht ushqim për né.

Bimët janë laboratori (punëtori) mâ i mrekullueshëm kimik dhe ato në nji kohë janë edhe kimista. Edhe vetë njeriu mëson prej këtyne kimistave, me gjithë se ende nuk u ka dalë në skej të gjitha mëshehtësive. Në natyrë ka shum elementa, që do të mund t'i quejshim pjesë themelore të mbarë botës së gjallë dhe të vdekun. Disa elemente si për shembëll, karboni, oksigjeni, azoti dhe hydrogjeni, janë të domosdoshëm për jetesë. Natyrisht, na nuk mund t'i hamë këta elementa ashtu si janë. Këta janë vetëm dofarë landësh të para, të cilat bashkohen prej bimëve në disa njazime, sikurse për shembëll, albuminet, hidratet e karbonit dhe yndyrnat. Shka janë hidratet e karbonit? Sheqeri! Bimët janë fabrika të vërteta të sheqerit.

Por bimët nuk na japin vetëm sheqer; ato janë edhe burimi i të gjithë ushqimit tanë. Pa bimë nuk do të kishte as albumine, dmth, mish, e nuk do të kish as yndyrna. Bimët u japin kafshëve disa gjysëmprodhime e ato mandej i përpunojmë në mish, n'ushqim me albumine dhe yndyrna. Bimët na japin zakonisht yndyrna dhe në mënyrë direkte.

Prandej, bimët prodhojnë »gjysëmfabrikate« nga materjet e vdekuna. Këto gjysëmfabrikate përpunohen mandej nga organizmat e kafshëve. Plehu i organizmave të kafshëve âsht përsëri landë e parë për bimët. Me fjalë tjera, kafshët u japin bimëve ushqim me anën e plehut.

Bimët janë gjithashtu edhe fabrika për perpunimin e ajrit. Bimët thithin ajr, ashtu sikurse i duhet me thithë çdo qenjes së gjallë, vetëm se mënyra e thithjes s'ajrit âsht e ndryshëme te ato. Bimët e qesin ajrin me nji përbamje tjetër e jo si kafshët dhe njerëzit. Ajo përbamje e ajrit u duhet kafshëve dhe njerëzve, të cilët përsëri e qesin në nji përbamje tjetër që âsht e nevojshëme

për bimët, Që, kështu bimët dhe kafshët shkembejnë midis tyne përbamjen e ajrit dhe e përpunojnë atê.

Prandaj njeriu âsht vrasesi mâ i madh, kur i çrranjos bimët verbnist. Ai me kêtê rast nuk mbyt vetëm bimët, por shkatrron edhe aleancen midis të gjitha formave kryesore të jetesës në Tokë.

2. Kur ta nxjerrësh nga shtëpija gurin e themelit...

Ti je ngutë tepër, në qoftë se më ke akuzue për anmik vdekjeprues t'industrisë së drunit. Dije se te na shum katundarë jetojnë prej të ardhunave të pyjeve të tyne. Gjithashtu dije se industrija e drunit dhe sharrat përfshijnë në punë nji numër të madh të punëtorisë sanë. Jam i vetëdijshëm se shka do me thanë eksportimi i drunit. Sigurisht edhe midis katundarëve janë të rrallë ata që do të pyetshin: »Pse, nuk guxojmë me pre dru? Cili »sheherli« e shpiku kêtê gjâ përsëri?«

Shpresoj se jemi kuptue. Deshta me thanë: në qoftë se nuk do të dijmë me i çmue pyjet, në qoftë se me njiherë nuk kuptojmë se shka janë pyjet, askush nuk do të jetojë gjatë prej shitjes së

drunit të pyjeve. Në këtë rast industrija e drunit do të asgjasohej shpejt. Katundari do të humbte t'ardhuna të shumta, për shumicën — t'ardhunat e vetme. E ti e din mirë se nji të katërten e Sllovenisë e mbulojnë pyjet.

Por në qoftë se do të shkatrrohej industrija e drunit, kjo nuk do t'ishte ende disfata mâ e madhe. Rreziku âsht edhe shum mâ i madh. Sikur të çeleshin sipërfaqe shum të mëdha pyjesh, do të ndryshojshin edhe shum gjana tjera. Do të ndryshonte mbarë vendi ynë.

Ai që do të jetonte edhe për nji kohë dhe t'i shiqonte me sy çelë ndryshimet graduale, do të verente se si bota po shkatrrohet. Kjo gjâ do të dukej kështu:

Prej vjeti në vjet do të tërboheshin ernat sa mâ të forta dhe do të përlajshin tokën e pllejshëme. Prrojet do ta gërryejshin tokën sa mâ shum dhe egërsisht. Temperatura do të ndryshohej shpejt. Ditën do të kishte nxehtësi të paduruesheme; prej vapës do të vyshkëshin të gjitha bimët e fushës. Natën do të bânte shum ftohtë e në mëngjez do të gdhinte nëpër fusha brymë e madhe. Uji i lumejve do të paksohej sa mâ tepër prej vjeti në vjet, prrojet do të thaheshin, e shum burime do të shterreshin. Disa kafshë do të fillojshin me u çfarosë.

Shkurt — toka do të shëndrrohej në shkretinë. Pse? Vetëm për shkak pse nuk do të kishte mâ pyje. Me i zhdukë pyjet do me thanë me nxjerrë nga shtëpija gurin e themelit, dhe — shtëpija fillon të shkatrrohet. Natyra do të humbte ekuilibrin. Jeta do të fillonte të zhdukej. Toka pjellore do të shëndrrohej në kodrina të zdeshuna e të paujë, të ngjajshëme me shkrepat tanë. Mâ në fund vetëm edhe guri i thatë do t'i kundërshtonte fuqit e natyrës. E si do të jetonte njeriu në gurin e thatë?

3. Aleat ase anmik i jetës?

Shka do të ngjante sikur prej detnavë t'avullohej mâ shum ujë se sa kanë ata? Asht e qartë se deti herët a vonë do të thahej. Në fund të detnave do të zejshin shtresë krupa dhe materjet, që

nuk avullohen. Ky do t'ishte mbarimi i jetës së zhvillueme shum n'ujin e detit. Gjithashtu âsht e qartë se pyjet do t'ishin t'asgjasuem, po qe se prehen mâ tepër dru se sa rriten në të. Spërfaqja e pyjeve do të çelej prej vjeti në vjet, dmth. pyjet do të rralloheshin sa mâ tepër. Në qoftë se brezi i nji vjeti do t'ishte mâ i vogël, se sa sasija e drujve të premë gjatë vjetit, atëherë qysh në fillim të premjeve të pamasë pyjet do të rralloheshin sa mâ shum në vjetet e ardhshëm, sepse brezi i ri nuk do të mundte të mbërrinte madhësín e sipërfaqes së çelun. Kjo do të thotë se pyjet do të zhdukeshin sa mâ shum. Mâ në fund do të shkaktohej nji dam i atillë, sa që nuk do të mundte të përmirësohej as me dhetësha vjetë, madje edhe sikur të fillohej përmirësimi sa ma i kujdeshëm. Pylli nuk mund të rimëkambet për pesë vjetë. Nuk mjaftojnë edhe dhetë, edhe njizetë vjetë. Koha e jetesës së drunit âsht shum mâ e gjatë se sa e njeriut. Rritja e disa llojeve të drujve yazhdon mâ se njiqind vjetë, e vetëm mandej piqen.

Asht mâ keq puna sepse për nji kohë të pakët nuk do t'ishte mâ e mundshëme me e pyllzue pyllin e çelun, sepse uji do ta shpërlante prej brigjeve shtresën e sipërme të tokës me plot materje ushqyese. Pyllzimi i shkrepavet âsht punë e vështirë dhe e padobi.

Pra, si ta largojmë rrezikun e çeljes së tepërt të sipërfaqeve të pyjeve? Si ta mbërrijmë ekuilibrin midis premjes dhe rritjes së drunit?

Njeriu që âsht me të vërtetë i kuptueshëm dhe zotnues i lirë i visarëve të natyrës nuk do të lejojë që në natyrë të shkelet ekuilibri — midis fushave dhe pyjeve, midis sipërfaqeve t'ujit dhe të tokës. Këtë përpjestim midis sipërfaqeve të blerta dhe t'ujit ai do ta përmirësojë edhe mâ. Njeriu do ta përmirësojë natyrën në vend që ta prishë. Ai do të jetë aleti i jetesës, e jo anmiku i saj. Ai nuk do ta zêvendësojë kurrsesi kriminelin kapitalist, i cili, në poterën për fitim, asgjason krahina të tana, sikur Hunët dikur, në mënyrë që mâ vonë të investonte kapitalin në ndonji vend tjetër ku parasheh prê të mëdha.

Që të mos i asgjasojmë pyjet, por t'i shfrytzojmë me mend, si burim të pashterrëshëm visaresh dhe të jetesës, mâ parë duhet

të vërejmë patjetër se çfarë âsht pra pasunija jonë e pyjeve. Na tash elhe nuk e dijmë me saktësi se shka kemi në të vërtetë. E dijmë se sa dru kanë dhanë pyjet gjatë nji vjeti, ndonse edhe këtë gjâ e dijmë vetëm afërsisht, sepse nuk âsht e mundun me llogaritë me saktësi se sa dru kanë përdorë pronarët e vogjël të panumërt të pyjeve. Por me gjithë këtë ka qenë e mundun në bazë të shenimeve jo të plota me vërejtë se kemi pre gjithmonë mâ shum dru se sa janë rritë ato. Kjo do me thanë se kemi fillue tashmâ kryen e gjasë e se nuk kemi qenë ende të kënaqun vetëm me kamatën që na jepshin pyjet. Asht e qartë se kamatat janë aq mâ të vogla, sa mâ e vogël të jetë kryegjâja.

Por vetëm ky konstatim nuk âsht ende i mjaftueshëm. Deri tash nji shumicë e madhe pyjesh iu përkitte pasunive të vogla. Pronat pyjore kanë qenë shum të coptueme. Në pyjet e vogla nuk âsht e mundshëme me bâ nji ekonomi me plan. Asht e mundshëme me e zhvillue si duhet silvikulturën, kur me mija pronarë të vogjël qeverisin këto prona ashtu si i detyrojnë rrethanat dhe i sulmojnë visaret e tyne sa herë që janë në gjendje të keqe, tue i lanë kështu vetëm kaçuba ase djerrina.

Pamë se prej pyjeve mvaret edhe fati i komunitetit. Sikur të zhdukeshin pyjet, nuk do të vuejshin vetëm pronarët e pyjeve, por të gjithë nenshtetasit tjerë. Për këtë arsye edhe komuniteti duhet ta thotë patjetër fjalën e vet kur âsht fjala për ekonominë e pyjeve. Pyjet duhet me i sigurue në dobinë e komunitetit, e në këtë mënyrë do të sigurohet edhe çdo individ. Do ta bijmë Ligjin mbi pyjet, i cili do të jetë rregulli kryesuer për udhëheqjen e silvikulturës. Qysh tash, kur silvikultura jonë âsht përfshi në Planin pesëvjeçar, duhet ta kemi të qartë se shka janë pyjet. Prandaj Ligji mbi Planin pesëvjeçar nuk parasheh as kurrfarë shtese të premjes së pyjeve. Përkundrazi, atje na lexojmë se do të jetë e nevojshëme që të pyllzohen kodrat e zdeshuna, të ndërtohen brezat pyjorë për bri shum prrojeve që gërryejnë tokën, të shfrytëzohen sa mâ me kujdes të gjitha mbetûrinat e drunit dhe të rregullohet si duhet industrija jonë e sharrave.

4. Visare shum të mëdha humbin n'ajr

Nuk do të flasim për ata që pijnë duhan, të cilët në formë të tymit të duhanit hjedhin n'ajr aq e aq miljona dinarë. Në botë ka shum »duhanxhij« mâ të këqij. Kështu do të mujshim me folë mbi oxhaqet e fabrikave, të cijët hjedhin n'ajr në formë tymi gazna, të cilat do të mund të shfrytëzoheshin n'industri, e që me to do të pengohej në nji kohë rreziku që gaznat helmuese ta helmojnë ajrin dhe t'i asgjasojnë bimët. Pra, do me thanë se duhet të bisedojmë mbi duhanxijt, të cilët janë damtuesa edhe mâ të këqij. Për çdo ditë hidhen n'ajr me anën e oxhaqeve të thjeshtë të shtëpijave visare shum të mëdha.

Nuk ka asnji arkë banke nëpër të cilën kanë kalue aq shum visare se sa nëpër këto oxhaqe. Këtu nuk âsht fjala vetëm për oxhaqet e fabrikave, sepse fabrikat gjithmonë i shfrytëzojnë landët djegëse; nuk âsht fjala aq shum as për oxhaqet e shtëpijave, që nuk janë damtuesa të mëdhej, por për votrat e shumta të hapta. Në disa krahina, si për shembëll në Sërbi dhe në Bosnje, digjen ende gjithnji nën kazana copa të tana drujsh, të gjata nga nji pash. Vetëm në nji shtepi katundare me votër të hapët digjen mâ shum dru se sa në dhetë shtëpi tjera që ngrohen me shporeta dhe stufa.

Por edhe shum shporeta nuk e meritojnë këtë emën. Duhet t'i quejmë pikërisht batakçij. Në shporeta dhe stufa asgjasohen landë të para të çmueshëme, që prej vjeti në vjet janë gjithnji mâ të shtrejta. Për shembëll a do të ishte e arsyeshëme me e shtrue rrugën me alumin? Aq mâ e paarsyeshëme âsht me asgjasue pyje të tana në stufa dhe në shporeta. Na përdorim landën e parë mâ të çmueshëme, që e quejmë »dru«; e s'don me thanë gjâ sikur të paktën secili të dinte me e shfrytëzue mirë. Mirëpo, asnji stufë nuk âsht e përsosun; çdo shporet ka nga ndonji mungesë.

Shumkush prej nesh nuk mundet me e kuptue ende e plotësisht këte gjâ e thonë: A thue se te na âsht e nevojshëme me kursye drutë e zjarmit dhe landen e drunit? A thue se nuk guxojmë mâ me e ndezë zjarmin me dru? Mirëpo, duhet të pajtohemi për së shpejti me këtë fakt. Nuk do të shkaktohet kurrfarë gjâje e keqe

për këtë punë. Kurkush nuk do të mërdhihet nga ky shkak. Banesat tona do të ngrohen edhe më mirë. Ushqimi ynë do të zihet më mirë, dhe padyshim do të jetë shum më mirë se sa kur ai të zjejë në votra të hapta ase në furrat e bukës nëpër katunde.

Pra, shka do të djegim? Qymyr; më shum qymyr — më pak dru. E që shpejti do të përdorim kryesisht elektrikun dhe gazin. Në vendet më të mëdha do të kemi centrale nxehtësije, të cilat me anën e qypave do t'ua dërgojnë nxehtësinë në formë avulli ase ujit të valë mija shtëpijave. E, kur të përdorim qymyrin, nuk do të harxhojmë dru as për të ndezë zjarmin: qymyrin do ta ndezim me aparat të veçantë, të cilin tashmë e ka shpikë nji nga shpiksat tanë të shumtë.

E shka do të bajmë me dru? Me drutë që kalben në sasina aq të mëdha në pyll. Po me mbeturinat e shumta të sharrave që janë gadi me u zanë frymën secilit?



Tash duhet me fillue të shkruejmë librin e ri me titullin »Druri si landë e parë« ase »landa e parë për të gjitha llojet e industrisë«. Ai libër do t'ishte tepër i trashë, e më duhet me hjekë dorë prej tij. Por në qoftë se do të shkruej, ti nuk do të kundërshtojshe për ta lexue. Specjalisti do të mundtte me shkrue nji libër edhe mâ të trashë; me fjalë tjera, këtë gjâ duhej ta shkruejshin shum specjalista: ingjinjerat e pyjëve, specjalistat e sharrave, përpunuesat e ndryshëm të drunit, — tue fillue prej zdrukthëtarit e deri të ndërtuesi i anijeve — konstruktorat e aeroplanave, ingjinjeret e punëve botore, specjalistat që punojnë në fabriken e vagonjave etj. Por para të gjithëve, kimistat duheshin me thanë fjalën e vet. Ata do të përshkruejshin ngjarje t'atilla të çuditshëme, mbi të cilat nuk ke lexue n'asnji libër. Do të mjaftonte vetëm ajo që ata të na përshkruejshin se shka mund të nxjerret prej celulozës ase prej peshkvës.

Padyshim ke ndigjue ase lexue shum herë se sod prodhohen prej drunit edhe pej të ndryshëm tekstili ase — fije të celulozës. Materjet që ka grumbullue bima në qelizat e veta gjatë rritjes në pyll, si nga ajri (dioksid karboni), ashtu edhe nga toka, kimiku i përdor si landë të para për magjit e veta të shumta. Edhe qymyrxhiu âsht kimist, sepse të djegunit e qymyrit âsht proces kimik, me gjithë se mjaft primitiv. Në qoftë se drunin »e ziejmë« (destilacjoni i thatë), dishka mâ ndryshe se qymyrxhiu, prej atij mund të nxjerret shum mâ tepër se sa prej qymyrit. Kimisti din me prodhue prej drunit mëndafshin artificjal, thartinen e uthullës, alkoolin, zaharinën dhe shum gjana të tjera, për të cilat shum kush prej nesh as nuk andrron se ato janë mëshehë në dru. Në dru mëshihen: ushqimi, rrobet, municjoni, kauçuku, voj të ndryshëm dhe të gjitha ato që i qujmë shkurtimisht — kimikalie. Por druni do t'ishte landë e parë e çmueshëme edhe atëherë sikur të na jepte vetëm celulozen për prodhimin e letrës.

Prandaj ka mundësi që të gjitha mbeturinat e drunit të përdorën me shum dobi. Prej zdrukthe mund të mbarohen pllaka për ndërtesa. Ndoshta zdrukthën do të mundemi me e përdorë edhe për dishka mâ të vlefshëme. Kush e din se edhe shka tjetër

do të mundet me u prodhue prej mbeturinave të drunit. Kjo âsht detyrë e kimistave.

Specjalistat duhet të na mësojnë edhe mâ, se shka âsht druni, në mënyrë që të dijmë me e çmue mâ mirë dhe të mos e shiqojmë vetëm si »landë djegëse«.

5. Damtuesi mâ i madh i pyjeve

Pyjet asgjasohen prej shum damtuesave. Dihet, për shembëll, se nji prej damtuesave mâ të rrezikshëm âsht që duhet ips typographicus, mirëpo, damtuesi mâ i madh i pyjeve âsht njeriu. Kësi damtuesash ka te na tepër shum dhe prandaj, edhe rreziku që i kërcnohet pyjeve, âsht shum i madh. Mâ keq âsht se as ata vetë nuk janë të vetëdijshëm për këtë dam të tyne.

Nga ndonjiherë i tanë katundi âsht damtues i pyllit. Gjithkush pret simbas dëshirës së vet. Mbeturinat i len të kalben në pyll. Në lëkuren, që âsht landë e parë shum e çmueshëme, hyjnë damtuesat parazitë. Në mbeturinat e drujve të rrahishtave të lanuna mbas dore formohen shum strofuj të parazitëve të pyjeve.

Katundi e ka sharrën e vet. Katundarët krenohen me të e do t'ofendoheshin madje po t'iu thoshte ndokush se janë mâ të mira disa sharra të tjera. Këso sharrash të vogla ka te na me qinda. Disa pohojnë me kambëngulje se sharrat e këtilla janë shum të nevojshëme dhe se kanë randësi të madhe për industrinë tanë të drunit. Të tjerët tregojnë, prap, se sharrat e atilla të vogla janë shkatërruese të drunit të mirë dhe se prodhimet e këtyne sharrave janë t'ashpër. Sharrat e vogla e të vjetrueme nuk i prejnë drrasat, në mënyrë që ato të kenë trashësinë e përpikët dhe të barabartë; e përsa i përket trashësisë së drrasës së caktueme, nji milimetër te ajo mund të luejë rol të madh. Përveç kësaj, në sharrat e vogla nuk âsht e mundun me i shfrytëzue mbeturinat si duhet. Por fatkeqësija kryesore qëndron në punën se me qinda sharra të vogla e pengojnë organizimin e disa sipërmarrjeve të mëdha të sharrave e të rregullueme mâ mirë. Rreth sharrave të mëdha mund të ndërtoheshin vargje sipërmarrjesh, si për shembëll, fabrika e mobiljeve, fabrika e celulozes, fabrika e letrës, fabrika për

përpunimin e mbeturinave të drunit etj. — shkurt, nji kombinat i tanë, me të cilin na quejmë nji grumbull fabrikash të këtilla të lidhuna midis tyne.

Na kemi nevojë për kombinatet e industrisë së drunit. Pse? Për ta përdorë drunin sa mâ racionalisht, që t'i shfrytëzosh sa mâ mirë mbeturinat, që prodhimet e sharrës të jenë sa mâ të lira, që të mundemi me prodhue shtëpija të lira për montim dhe pllaka ndërtimi prej mbeturinave të drunit; që të mundet me u zhvillue industrija kimike në bazën e shfrytëzimit të drunit; që të mundemi me prodhue mâ tepër celulozë; që të mundet me u zhvillue mâ mirë industrija e tekstilit, e cila përdor fijet e celulozes që të mundemi me prodhue mâ shum letër.

Pse mâ shum letër? Mâ shum letër, do me thanë mâ shum libra e revista mâ të lira; mâ shum libra dhe revista, do me thanë, nji shkallë mâ e naltë e kulturës. Pa letër nuk ka as kulturë intelektuale. Pa letër nuk ka as kulturë. Pa kulturë intelektuale, prap, nuk ka kurrfarë përparimi. Pa kulturë intelektuale nuk ka as punëtorë të kaulifikuem as specijalista të shkolluem. Shkurt pa letër nuk ka mjaft fuqi profesjonale as fuqi të thjeshtë punëtore. Prej sasisë së letrës mvaret edhe realizimi i Planit tanë pesëvjeçar. Tash nuk kemi ende letër. Nuk ka mjaft as në vendet e tjera të botës. Te na duhet të ketë patjetër gjithshka me shumicë, e kështu edhe letër.

Prandej, sharrat e vogla e të panumërta e pengojnë të gjithë përparimin — jo vetëm të silvikulturës, por edhe të mbarë ekonomisë sanë. Këtë gjâ specjalistat mund të na e provojnë lehtë me anën e shifrave.

Kreu i tetë

PLEHU — BUKA — KULTURA

1. Plehu asht fjalë e bukur

Disave prej nesh u vjen keq ende kur përmendet në kuvendim fjala pleh. Vet fjala »pleh« i duket pak e papërshtatshëme. Mirëpo, fjala »bukë« nuk u duket aspak e shemtuetë. Për bukën mund të flasësh sa të duesh dhe kur të duesh. Natyrisht, jo në lidhje me plehun, sikur të ishte krejt e pamundshëme.

Në kohnat e lashta puna ka qenë turp. Atëherë kanë punue vetëm skllavët. Mirëpo, me hangër nuk ka qenë turp as në kohnat e lashta. Kurkujt nuk i vinte turp me hangër bukën që kishin prodhue skllavët me duert e tyne »të ndyeta«. Kurrkush atëherë as nuk ka mendue se sa marre âsht me jetue si brumbulli në shpinë të njerëzve tjerë, të cilët duhet të vuejnë për tyj dhe të flijohen plotsisht. Gjatë gjithë jetës ata punojnë, vetëm punojnë, vuejnë dhe shkatrrohen për të mujtë ti me hangër dhe me u bâ përtac.

Shum mâ vonë, kur nuk kishte mâ skllavë t'atij lloji (por prap kishte skllavë të llojit tjetër) ka pasë për së tepërmi njerëz (kush e din në se janë shfarue tashmâ apo jo?), që e shiqojshin prej naltësije çdo gjâ, që kishte lidhje me punët e dorës, që nuk i vinte era lule dhe që nuk ishte »e naltësueme«. Ata trilluen madje edhe nji farë shkence mbi të bukurit (me gjithë se vetë kanë qenë shemtimet mâ të mëdha), të cilën e quejten estetikë. Simbas kësaj shkencës së këtyne puna nuk ka kurrgjâ të përbashkët me të bukurit. Simbas asaj puna nuk âsht »estetike«. Por njimen-

dësija bjen shpesh herë në kundërshtim me astetikën. Simbas estetikës njimendësija nuk guxon të çfaqët në mënyrë që të bâhet e qartë për të gjithë. Çdo gjâ duhet me e mbështjellë me fjalë t'ambla dhe hipokrite.

Fjala pleh nuk âsht »estetike«. Në shoqnín e njerëzishëme nuk guxohej me folë mbi plehun. E kulmi i ashpërsís do t'ishte atëherë, kur ndokush të përpiqej me kuvendue mbi plehun dhe me provue se si mû prej tij mvaret mbarë kultura.

A po e sheh, edhe unë jam ashtu i pagdhendun. Plehu dhe kultura! A më dënuet qysh tash kur mora guxim me krahasue kulturën me plehun? Nuk jam historjan, por sikur t'isha, do ta filojsha këtë libër me historín e Asirasve dhe t'Egjyptasve, ase me kulturën mâ të vjetër — sikurse tashmâ âsht bâ për zakon kjo gjâ. Do të shkruejsha (ndoshta në mënyrë shum të njerëzishëme se kultura âsht zhvillue së pari atje ku toka ka qenë pjellore. Kultura mâ e vjetër âsht zhvillue në luginat pjellore të lumejve. Nuk dëshiroj me hŷ mâ thellë në shpjegimin e fjalës »toka pjellore«, e po kështu nuk due me nxjerrë nga kjo gjâ përfundime të thella, sepse kultura âsht në lidhjen mâ direkte me pjellëshmenín e tokës, e toka pjellore nuk âsht kurrgjâ tjetër, përveç se tokë e plehnueme mirë.

Po ju flas me fjalë krejt të thjeshta se si ndodh kjo. Kultura zhvillohet atje, ku toka âsht e plehnueme mjaft. Luginën e Nilit ase Egjyptin e plehnon lumi Nil për çdo vjet. Pa lumin nuk do t'ishte kultura egjyptjane. Pa pleh nuk ka jetesë, e kultura âsht



e mundshëme vetëm atje, ku âsht jetesa e zhvillueme. Këtê gjâ e kemi të qartë madje edhe na, me gjithë se ndoshta nuk jemi kush e din se sa të kulturuem. Kjo âsht e vërteta mbi kulturën dhe plehun — edhe po qe se i vjen ase nuk i vjen mirë ndokujt.

Atje ku toka jep pak fryte, atje edhe buka âsht e paktë. Por atje nuk mbretnon vetëm mungesa, por edhe mungesa për çdo gjâ tjetër. Jeta kulturale zhvillohet në mënyrë të ngjajshëme me atê të bimëve: në qoftë se toka âsht e pasun edhe bimët janë mâ të vrullshëme e mâ të forta. Me fjalë të tjera edhe njeriu duhet të hajë mâ parë. Për deri sa njeriu të jetë vazhdimisht i unët dhe i rrezikuem, do t'i përngjajë mâ tepër ujkut se sa njeriut. Nuk do të këndojë, por do t'ulurojë; nuk do të shkruejë vjersha, por vazhdimisht do të gjurmojë ushqimin. Do të luftojë për jetën lakuriqe. Për derisa njeriu të mos ketë aq mjete që të mundet me e ndërtue kasollen, nuk do të ndërtojë shkolla dhe theatra. Pra, kjo âsht e vërteta mbi plehun dhe kulturën.

Nga ndonjiherë në katundet do të hasësh në shtëpija nji-katëshe interesante. Përdhesa âsht e ultë, shum e vjetër, me vrima të vogla. Dritare nuk ka fare. Përdhesa âsht ndërtue qysh atëherë kur njerëzit tanë as nuk kanë dijtë për xhamin. Në vend të xhamit ata kanë gozhdue n'ato vrima fshika të thame të kafshëve. Mirëpo, kati i parë âsht krejt ndryshe. Atje janë tashmâ xhamat, me gjithë se ende shum të vogjël. Në katin përdhesë tash âsht ahri, e në katin e parë »shtëpija«. Në kohnat e lashta, kur nuk kishte ende kat të parë, njerëzit banojshin në katin perdhesë, që përdoret për ahër. Dikur ndoshta kanë banue së bashkut me kafshët, të cilat âsht dashtë me i mprojtë prej egërsinave.

E njajta gjâ ndodh edhe me kulturën. Ajo që na quejmë ekonomi ase kulturë materjale, âsht gjâja fillestare, mâ e vjetër — kati përdhesë dhe themeli; kulturë shpirtnore ase »e vertetë« âsht kati i parë. Âsht e qartë se kati i parë nuk mund të ndërtohet pa katin përdhesë. Në qoftë se kati përdhesë âsht i dobët, nuk mund ta mbajë katin e parë të fortë dhe të fuqishëm. Që të mundemi me të vërtetë me u bâ të kulturuem, duhet patjetër me e ndërtue të fortë katin përdhesë.

Kur tashmâ jetojmë në katin e parë, nuk guxojmë të flasim kurrsesi se kati përdhesë âsht dishka i panevojshëm, dhe se nuk na interesëson kurrgjâ, në qoftë se ai rrënohet dhe përmbyset. Asht mâ mirë që katin përdhesë ta shtrojmë me mur dhe ta rregullojmë ashtu si duhet. Të ngjitim xhamat dhe t'i lyejmë muret. Kati përdhesë do të bâhet i paştërt dhe i fortë, prandej mâ vonë edhe kati i parë do të jetë i shëndoshë. Mbas kësaj do të mundemi me marrë frymë mâ lehtë në katin e parë, do ta ndijmë vehten mâ të sigurtë, sepse e dijmë që kati i parë mbështetet në themele të forta.

Por kjo gjâ ndodh vetëm atje ku nuk dihet për t'u çmue vlefta e plehut. Plehu âsht fjalë e bukur.

2. Grindja për theatër dhe për gropat e plehut

Në Jugosllavín e para luftës kanë qenë të mundshëme shum gjana të pamundshëme. Prandaj kanë qenë të pamundshëme edhe ato gjana që për shtetin tanë të sodshëm janë të mundshëme. Kështu, për shembëll, katundarët nuk kanë pasë mundësi me ndërtue gropa plehu. Toka jonë ka pasë nevojë me doemos për pleh, si t'ahrijave, ashtu dhe për plehna artificjale, mirëpo, ata derdheshin nëpër rruga dhe oborre, e diku madje edhe para pragut të shtëpisë.

N'atë kohë, në mbarë shtetin tanë prodhimi i grunit prej nji hektari ka qenë mesatarisht 11,3 kuintal (në Sllloveni vetëm 9,5 kuintal), ndërsa në Holandë prodhoheshin 28,6 kuintal, në Gjermani — 20,5 kv., n'Austri — 15,6 kv. etj. Kemi qenë në vendin e parafundit n'Europë. (Në vendin e fundit ka qenë Romanija — 9,1 kuintal).

N'atë kohë »punëtori i kulturës« ka mujtë me shkrue dizertacjonin me anër e të cilit ka shprehë krejt idhnimin e vet të shejtë për shkak të përlyemjes së kulturës, sepse në preventivin e »banovinës«*) gjindej dotacjoni (ndihma) »tepër i naltë« për ndër-

*) Banovina — një province në Jugosllavín e vjetër. Ajo ka qenë e ndame në nandë provinca të këtilla.

timin e gropave për pleh në krahasim me dotacjonet për theatra. A thue gropat për pleh duhet të kenë mâ epërsi se theatrî? Në të vërtetë, ndihma për ato gropa ka qenë aq e vogël, sa me ato të holla nuk ka mujtë të hiqet as pluhni prej theatrit. Asht e nevojshëme me e mprojtë dhe me e madhue kulturën, në qoftë se dëshiron të të quejnë si puntor të kulturës. E do ta mprosh mâ me sukses, në qoftë se u kërcnohesh gropave të plehut. »Në rend të parë kultura! Në rend të parë theatri! Vetëm njerëzit e egër i çmojnë mâ tepër gropat e plehut, se sa vendin tanë të shejtë t'artit!« Padyshim ka harrue të tregojë se në shtetet kapitaliste janë interesue për gropa plehu dhe për theatër vetëm, sepse ato u kanë sjellë fitime direkte atyne dhe aq sa ka qenë e nevojshëme sa për t'u hjedhë njerëzve pluhunin syve.

Kjo gjâ ka qenë e mundshëme n'atë kohë kur njeriu ynë punues as nuk ka shkue fare në theatër, sepse nuk ka qenë në gjendje; kur banorët e vorfën të provincave jugosllave vdisshin prej sëmundjes që ishte rrjedhim e përdorimit të bukës së misrit si ushqim kryesuer; kur Jugosllavija ka qenë në mes të shteteve mâ të fundit për kah sasija e hekurit të prodhuem; kur Jugosllavija ka qenë në vendin e fundit për kah sasija e plehut artificjal që përdorej (0,3 kgr. për nji hektar); kur prodhojshin në vjet vetëm 155 kgr. grunë për nji banor — e me gjithë këtë spekulantat e gjanave ushqimore eksportojshin me mija e mija tonelata.

Ai që përpiqej atëhere për t'i dhanë theatrit disa mija dinarë, në vend që ketë t'ia jepte katundarit, provonte me këtë se nuk e shihte skamjen e tmerrshëme, në të cilën jetonte populli ynë. Ai nuk pyeste se sa njerëz tanë nuk e kanë pa as ndërtesën e theatrit. Ai nuk ka dashtë me pa se në Jugosllavín e vjetër rastet e vdekjes së fëmijve kanë qenë aq të shpeshta, sa edhe te njerëzit e egër. Njeriu i atillë nuk ka dashtë me pa se sëmundjet shoqnore te na kanë kositë tepër shum njerëz dhe nuk ka qenë i mundun me parapa n'asnji preventiv ndihmën mâ të nevojshëme për dispanzerët kundra tuberkulozit, me gjithë se krenoheshin me organizimin shembullor të pengimit të tuberkulozit. Ai që bânte komedi me gropat e plehut, në të vërtetë përqeshte skamjen e



»Po ndërtojmë shtetin, në të cilin nuk do t'iu shërbejmë kapitalistave.
Fabrikat e reja janë themeli i pamvarësis sanë.

katundarit tanë dhe provonte se nuk jetonte në Tokë, por dikund në Hanë... Ai përpiqej me mëshehë pikërisht atë gjâ, për të cilën ishte fjala në të vërtetë, shkakun e skamjes — për të cilin nuk ka pasë të holla as për bujqësi as për kulturë. Ka dashtë me provue se bujqësija, ase mâ mirë me thanë ekonomija, dhe theatri janë në kundërshtim me njeni tjetrin — gjâ që nuk mund të ndodhë n'asnji mënyrë.

Grindja për theatrin dhe për gropat e plehut tash-ka marrë fund. Nuk do të tregoj mâ se si theatri ashtu dhe çdo gjâ që e quejmë kulturë janë të lidhun ngushtë me bujqësinë dhe industrinë. Ti e din mirë se nuk mund të fillet mbi kulturën në vendin, ku lëvrohet ende me përmenda, në vendin që prodhon mâ pak drithë, prej të gjitha shteteve tjera europjane, me gjithë se quhet vend bujqësuer, në vendin ku çdo njeri nuk ka as shtrojë as këpucë.

Na duem që populli jugosllav të jetë i kulturuem; të shpërngulet nga përdhesa mesjetare, që të zen frymën, në katin e parë të ndritshëm. Na duem që katundari i vorfën ta njohë theatrin, të blejë dhe lexojë libra, shkurt, të jetojë si njeri.

Prandaj nuk do t'i bâjmë me ciment vetëm gropat e plehut. Në vjetin 1951 do të prodhojmë pesë herë më tepër pleh artificjal se sa ka prodhue Jugosllavija e para luftës. Atëhere do të shtohet bukur shum prodhimi për nji hektar. Nuk do të jemi më ndër më të fundit n'Europë. Do të prodhojmë shum më tepër grunë dhe produkte tjera bujqësore e në punë të mos derdhim shum mund.

Kulturës sanë do t'i shtojmë themele të forta. Bujqësija dhe industrija do të na japin aso t'ardhunash, sa që do të mundemi me ndërtue shkolla e ente bujqësore, të cilat do të kujdesen për përparimin e bujqësisë. Do të ndërtojmë edhe spitale, theatra dhe shtëpija kulture. Kurrkush më nuk do të ketë nevojë me bâ pyetje në se theatri do të marrë ase jo disa qinda dinarë më tepër në damin e gropave të plehut.

Kreu i nandë

MESHEHTESIT E LLOGARIS SE MADHE

1. Mâ tepër qymyr, mâ tepër hekur, mâ tepër bukë, mâ tepër...

Gjithska mâ tepër! Gjithshka? A nuk kemi rëmihë mjaft qymyr? Shka të bâjmë me kaq shum hekur? Pse duhet të prodhojmë mâ tepër, kur dikur i eksportojshin prodhimet tona dhe detyroheshin me ua dhurue të tjerëve aq lirë? Shka të bâjmë me të gjitha këto prodhime industrijale dhe bujqësore?

A thue te na mundet edhe ndokush me bâ pyetje të këtilla? Në kapitullin e mâparshëm vumë në dukje se Jugosllavija e para luftës ka qenë në rradhën e shteteve europjane të fundit. Ka qenë tepër shum e mbrapambetun. Flitej se ka qenë vend bujqësuer, mirëpo, a e ka meritue fare këte emën bujqësija e saj? Rrethanat në të cilat kemi jetue na njerëzit punuesa a mund të quhen fare jetesë e denjë për njeriun?

Pse gjithshka mâ tepër?

Jo për arsye që kapitalisti të ketë mâ tepër fitim. Kapitalistave te na u ka kalue koha. Na duhet gjithshka mâ tepër për të mos vuejtë kurrkush, që gjithkush të bâjë jetë të denjë si njeri si dhe për të qenë mâ të fortë të gjithë së bashku që të gjithë së bashku të mujmë mâ lehtë me e mprojtë lirinë tanë. Kjo do me thanë se vetëm shteti i fuqishëm ekonomik mundet me qenë i pamvarun. Vetëm n'atë shtet, ku populli punon vetëm për vehten e vet nënshtetasit jetojnë me të vërtetë të pamvarun, të lirë dhe të lumtun. Na po ndërtojmë shtetin, ku kurrkush nuk do të jetë shërbëtor' i kapitalistave të huej, shtetin, i cili nuk do të ketë

nevojë me blo prodhime të lueja të shtrenjta me visarin e vet me frytet e duerve të veta punuese. Me visarin dhe punën tanë nuk do të kënaqen më, as kapitalistat n'atdhe, as ata përjashta.

Asht e nevojshëme që kjo gjâ t'iu tregohet shum herë njerëzve tanë, prandaj unë po e përseris. Përsëritua edhe ti. Njerëzit nga njiherë janë tepër harramana. Disa kanë harrue madje edhe se si ka qenë te na gjatë okupacjonit. Nuk iu kujtohet se i ka përzanë okupatori nga votrat e tyne personale, se ua ka djegë shtëpijat, ua ka vra fëmijtë dhe ua ka hjedhë të gjallë në zjarm vllazënit, motrat dhe prindët...

Të tjerët, prap kanë harrue se në Jugosllavin e para luftës kanë qenë shërbëtorë dhe se nuk kanë jetue më mirë se skllavët e dikurshëm. Ndoshta ndokush prej tyne nuk e din as sod se n'ish Jugosllavín nuk ka qenë kurrgjâ e jona. Xeheroret kanë qenë pronë e kapitalistave të huej, akcjonet e centralëve elektrike dhe të fabrikave kanë qenë gjithashtu në duer të të huejve; shum prej pasunive më të mira kanë qenë pronë e kontave të huej, pronë e bankjerëve dhe e kishave. Pyjet i prejshin për të huejt, kafshët dhe drithin ua epshin po të huejve me gjysëm çmimi. Mandej erdhi lufta; te na erdhën të huejt, si me pasë qenë zotnuesa të vendit tanë qysh në kohë të para. Njerëzit tanë shpesh herë nuk lejojshin me vdekë te shtëpija — dergoheshin në ferrin e llogoreve gjermane.

Prandej, pra, duhet gjithshka më tepër! Prandej edhe mend më shum! Për të pasë më shum bukë dhe liri! Për t'u bâ njerëz!

Tregoju se kjo gjâ âsht shkrue edhe në Ligjin mbi Planin pesëvjaçar; se kjo gjâ âsht shenue me shifra. E që ato shifra të bâhen qymyr, hekur, korent elektriku, shtëpi, bukë dhe liri, duhet çdonjeni prej nesh të kryejë dishka. Jo vetëm dishka — por duhet të punojë patjetër gjithshka mundet.

2. Nuk dij me llogaritë

Po hutohesh, se edhe ti po llogarit. Ndoshta nuk din me numrue as rrogën tande? Ndoshta nuk numëron kurr dhe nuk i njeh të hollat? Ndoshta nuk bën bukë? Të gjitha këto janë me



bâ llogari. Kush numëron, bân llogari. Kushdo që don me jetue, duhet të bâjë llogari.

Kjo, prap, do me thanë se gjithkush duhet me bâ ekonomi. Si do t'i përdorësh të hollat që i ke fitue — âsht e mëshehtë e ekonomisë sate. Kushdo që ushqen vetvehten bân llogari dhe ekonomi dashtë e padashtë. Në qoftë se ndokush e bân llogarinë mâ të dobtë — âsht mâ keq për të.

Gjithkush dëshiron që llogarít e tij të jenë sa mâ të përshtatshëme, — t'ardhunat sa mâ të mëdha, e të dalunat sa mâ të vogla. Disa prej nesh mendojnë se këtë gjâ njeriu nuk mundet me e çmue n'asnji mënyrë. Në lidhje me raportin midis të dalunave dhe t'ardhunave vendosin disa fuqi të panjohuna për të. Njerëzit flasin nga ndonji herë se duhet mâ parë me largue shtrejtësinë, e mandej çdo gjâ ka me qenë mirë. Këtë gjâ e flasin tue mendue se shtrejtësija mund të pengohet me ndonji dispozitë të vetme ligjore. Ata padyshim as nuk mendojnë që ende vetë marrin pjesë në caktimin e raportit midis çmimeve dhe rrogave.

Po thue se nuk din me llogaritë. A nuk beson, se do të na damtonte, edhe në qoftë se na do të bajshim llogari? Shka i cakton çmimet? Prej shka mvaren ato? Po rrogat e mëditjet? Pse nuk janë mâ të mëdha? A thue nuk mundkam unë vetëm me bâ kurrgjâ, per t'u përmirësue ky raport?

Të gjithë duhet të fillojnë me mendue kështu. Kështu duhet të mendojnë ata që marrin në dorë për herë të parë Ligjin mbi Planin pesëvjeçar, të gjithë ata që duhet ta studjojnë patjetër ligjin praktikisht, e jo ashtu si fëmijtë që mësojnë katekizmin. Pa këtë librin tanë të madh arithmetik do të jetë e pamundun me llogaritë në çdo mënyrë. Po thue se aty âsht llogaritë çdo gjâ. Shka të llogaritim mâ? Me të vërtetë nuk ka nevojë që të shtojmë edhe ndonji llogari të veçantë. Na as nuk do ta ndryshojmë as nuk do ta »ndreqim« llogarinë e madhe mbi Planin pesëvjeçar, por duhet patjetër të pyesim se shka duhet me bâ, që llogarija të mos mbetet vetëm llogari, por që ato shifra të shëndrrohen në prodhime industrijale dhe bujqësore.

Pra, e këtillë do të jetë ardhmënija jonë; kështu e kemi parapa. Çdo gjâ që përfshin ajo llogari e madhe, duhet me e krijue

mbrenda pesë vjetësh. Ky âsht me të vërtetë libër i çuditshëm. N'asnji libër tjetër mâ të mirë se ky nuk do të mundet me u përfshi mâ mirë e mâ drejt ardhmenija e vendit tanë. Në qoftë se ndokush dëshironte me shkrue ndonji romancë mbi ardhmenín tanë, nuk do të mundte me e shkure pa ndihmën e këtij libëri llogarije — të paktën asi romanci, që duhet t'ishte deri diku i besueshëm. Sepse në Ligjin mbi Planin pesëvjeçar âsht përfshi e tashmja jonë dhe âsht paraqitë e kaluemja.

Mirëpo, gjâja kryesore âsht se me atë llogari âsht planifikue mbarë jeta jonë, si lumi që rrjedh drejt, me shtrat të rregullum. Shtrati vjetër bânte lakime, e nuk dihej mirë se kah po rrjedhte lumi. Mandej ndahej në shum dega, qëndronte nëpër këneta dhe gjina, përplasej për shkambij dhe thente qafën. Tash ecë në nji masë, i kullluet — nuk e pengon kurrgjâ. Ai shkon përpara, atje për ku âsht nisë.

Kështu âsht edhe me jetën tanë. Të gjithë na as nuk e kemi pa deri tash, se jeta paska ndonji farë kuptimi; nuk kemi jetue si duhet, por me halle. Nuk kemi pa se për shka duhet të kujdesëshim dhe për kend të punojshim. Nuk kemi mujtë me përmirësue kurrgjâ. Ajo që ka qenë keq, keq ka mbetë. Padrejtësija na dukej e përjetshëme dhe e pandryshueshëme. Skamja ka qenë »ligj natyre«. Disa madje kanë mendue se në botë duhet të ketë patjetër edhe njerëz të vorfën, sepse të gjithë nuk mundemi të jemi të pasun. Në botë âsht dashtë »të ketë patjetër« të vorfën dhe të pasun, shfrytzues dhe të shfrytzuem, sepse kështu ka qenë qysh prej kohës që mban mend njeriu. Kush ka mendue ndryshe ka kenë i rrezikshëm »për rendin në fuqi«. Në qoftë se nuk e ka mëshehë atë shka mendon, atëherë e kanë burgosë ase edhe e kanë vra.

Kështu ka qenë, e këtë gjâ e vërteton edhe libër-llogarija jonë e madhe. Shifrat flasin mbi skamjen dhe mbrapambetjen tanë. Në llogarinë që âsht âq e madhe sa që përfshin mbarë jetën tanë duhet të gjejë vend edhe e kaluemja jonë, sepse ajo âsht i vetmi trashigim për ne. Na duhet ta vemë në dukje patjetër — sepse nuk mund të qendrojmë të verbët për mbrapambetjen e

deritashëme. Edhe na rrjedhim prej së kaluemes, e llogarit e vjetra tërhiqen mbas nesh. Nuk do të kishte llogari të reja, po të mos i shqyrtojshin të vjetrat.

3. Qysh?

Dëshiroj që ardhmenin tanë ta vizatoj me ngjyra të gjalla. Vetëm, tash jemi ende gjysëm të verbët për ngjyrat mâ të mira t'ardhmenís, ashtu sikurse âsht zakonisht i verbët njeriu që del prej territ në diellin e shkelqyeshëm. A do të mundemi fare me ia parafytyrue vetvehtes aq sa duhet në mënyrë të gjallë jetën që gjindet para nesh? Katunde të reja, ku âsht çdo gjâ aq terhekëse e ndritsheme, e blertë e gëzueshëme; fabrika të reja, ku do ta ndiejsh vehten si në salla të mëdha, si me pasë ardhë në ndonji të kremte, shkolla të reja — të mëdha, të ngjajshëme me tempuj të mëdhej; njerëz të rij, të kuptueshëm, të gëzueshëm, me ball hapët, me mendime të kthjellta, kangë të reja, të cilat kumbojnë po si vetë jeta...

T'ua lamë këtë gjâ të tjervë — poetëve. Libri ynë do të kryhet shum shpejt, që të mundëte me përfshi krejt pamjen e botës së re. Na të dy do të kuvendojmë vetëm për të shpjegue se si do të ndodhi pikërisht me të gjitha këto, se si do të krijohet bota e re.

Natyrisht, ne na interesón edhe »shka«, e jo vetëm »qysh«.

Shka do të ndodhë dhe do të ndryshojë në krejt gjanat.

Ajo »shka — do me thanë se prej kapitalizmit do të marim rrugën e socijalizmit; nga mbrapambetja do të dalim në dritën e socijalizmit. Do të bâhemi njerëz — deri tash kemi qenë skllavë. Kjo gjâ sigurisht nuk âsht e paktë.

Me marrë rrugën — nuk do me thanë me bâ vetëm nji hap, duhet me bâ me mija hapa. Kjo âsht ajo »shka«. Çdonjenit prej nesh i duhet patjetër me shkue përpara. Kjo do me thanë se çdonjeni prej nesh duhet me iu përveshë detyrës së vet me vetëdije. Çdonjeni duhet patjetër me llogaritë: »kaq e kaq më duhet me bâ unë vetë, në mënyrë që të gjithë t'i kryejmë të gjitha sendet. Në librin e madh të llogarisë janë mbledhë të gjithë hapat tanë

përpara — në nji hap të madh prej territ në diell, prej shekujve të terrshëm në shekuj të ndritshëm.

Atje nuk âsht vû në dukje me hollësina se si do të ndodhë e gjithë kjo gjâ. Por me gjithë këtë, do ta gjejmë përgjegjen edhe për këtë pyetje. Në qoftë që e dijmë se dëshirojmë krinë ekonomike, se dëshirojmë me e krijue shtetin socijalist, se duem me nxjerrë visare shum të mëdha për vehten tanë, jemi të vetëdijshëm se të tana këto nuk do të mundemi t'i mbërrijmë pa mjete. Visarin nuk mundemi me e rëmihë duerthatë.

Prandaj na duhet industrija e fortë.

Shka âsht industrija?

Do të mundtë të thuhej se industrija âsht arma e fuqishëme në duert e organizatës së fuqishëme punuese. Industrija âsht aleanca e fibrikave të mëdha, xeheroreve dhe e të gjitha maqinerive përgjithësisht.

Maqinat vetvetiu nuk përbajnë ende industrinë. Burimet e xeheve nuk janë ende industri xehetarije. Vetëm ndërtesat e fabrikave nuk janë ende industri.

Vetëm kur fabrika të vehet në lëvizje dhe aty të hyjnë puntorët në punë, kur t'organizohet puna e tanë, ase, sikurse thohet, proces'i prodhimit — vetëm atëhere realizohet industrija.

Na duhet të shpjegojmë se shka âsht në të vërtetë prodhimi ase përpunimi të mirave materjale. Prodhimi — sasija e prodhimeve të punimeve ase e landëve të para të fitueme — mvaret në radhë, të parë prej mënyrës së punës, me të cilen, padyshim, ka randesi vendimtare puna krijuese e njeriut, sepse maqinat pa njerëz janë të palëvizshëme. Nji numër i madh gjanash prodhohet vetëm me anen e maqinave ase me anën e veglave të posaçme. Nji numër i madh prodhimesh prodhohet, prap, në sasina të mëdha vetëm me maqina, me gjithë se do të mundte me prodhue edhe me punë dore. Puna me anën e maqinave dhe të veglave mund të zbatohet vetëm në sipërmarrjet industrijale. Fabrika âsht në të vërtetë bashkimi i madh i maqinave. Për të mujtë me vû në lëvizje vetëm nji seksjon të fabrikës, duhet shpesh herë me vû në lëvizje maqina të panumërta, të cilat janë

të gjitha të lidhuna me njëna tjetrën. Maqinat e ndihmojnë njena tjetrën, sikurse puntorët që e ndihmojnë shoqi shoqin. Ato plotësojnë njena tjetren dhe i ndajnë punët. Bashkimi i puntoreve të tillë mekanikë — maqinave, të cilat drejtohen prej puntorëve të fabrikave, quhet fabrikë. Shum fabrika të nji llojit formojnë nji degë t'industrisë. Të gjitha degët industrijale së bashkut i quejmë — industri.

Në qoftë se dëshirojmë me prodhue gjithshka mâ tepër, na duhet patjetër t'i thërrasim maqinat në ndihmë; na duhet të ndërtojmë fabrika dhe të prodhojmë maqina. Kjo gjâ quhet industrijalizim. Pra, na duhet me i shumue mjetet e prodhimit.

Maqinat nuk vehen në lëvizje vetvetiu. Vërtet, disa njerëz të çuditshëm janë përpjekë me shpikë maqina të tilla, dhe kanë humbë shum kohë të vlefsheme, para se kanë ardhë deri te e vërteta e njohun, se vetëm ajo gjâ që përdor energji mund të lëvizë: njeriu përdor bukën, maqina landët djegëse, elektrikun. Maqina âsht e vdekun dhe vetëm motori mund ta vejë në lëvizje. Sikurse njeriu që nuk mund të jetojë pa ushqim-mbassi organizmi i njeriut âsht njifarë maqine e çuditshëme — âshtu edhe maqina nuk mund të vehet në lëvizje, pa ndonji energji. Këtë energji ia japin landët djegëse ase elektriku.

Energjija elektrike lëvizëse âsht padyshim mâ e lira, e nga ndonji herë krejt e pazavendësueshëme. Prej kah buron energjija elektrike? Ajo âsht krijue prej energjís s'ujit — energjija e ujit âsht pesha e ujit që rrëxohet —e cila n'energjinë elektrike ka marrë vetëm nji trajtë tjetër. Energjinë elektrike na e jep edhe qymyri ase ndonji landë tjetër djegëse. Me këtë rast themi se energjija e nxehtësís shëndrrohet n'energji elektrike.

Por që energjija e ujit ase e nxehtësís të shëndrrohet n'energji elektrike, na duhen edhe centralet elektrike. Madje edhé kjo nuk mjafton. Që të mbërrijë korenti deri te maqinat në fabrika ase deri te shtëpijat, âsht e nevojshëme me ndertue largpërçuesa elektriku ísi dhe transformatora. E gjithë kjo punë quhet elektrifikim.

Pra, hapi ynë në socijalizëm quhet industrilazim dhe elektrifikim.

Tash duhet me shpjegue edhe se pse do të ndodhë patjetër kështu, e jo disi ndryshe.

4. Pse? — Qe sepse!

Shum herë do të pyesish ende: »Pse«? Në të vërtetë, e gjithë jeta âsht nji »pse« e madhe. Ashtu sikurse do të dijmë me iu përgjegë kesaj »pse«, po n'atë mënyrë do ta kuptojme edhe jetën.

Pse prodhimi i korentit elektrik te na duhet të shtohet me doemos në vjetin 1951 aq shum sa që për çdo banor të ketë nga 272 Kwh, ndërsa në vjetin 1939 ka pasë vetëm 69 Kwh? Pse duhet të ndërtojmë aq centrale të reja dhe aq të forta, të cilat të gjitha së bashku do të kenë fuqi prej afër nji miljonë e gjysëm kilovat?

Pse do të na duhen 1,500.000 tonelata xehe hekuri dhe 760.000 tonelata çelik të papërpunuem?

Kështu do të mundeshim me u ndalë për çdo shifër në llogarinë tanë të madhe. Mirëpo, e dijmë se përse, për shembëll, katundari mbjell sa e sa drithë — mbassi e din se t'ardhuna i duhen për t'i sigurue familjes së vet bukën e mjaftueshëme dhe që nji sasi drithi të mundet madje edhe me e shitë. Kjo do me thanë se edhe katundari e ka planin e vet.

Po si do të mundte atëherë me punue pa plan ky komunitet kaq i madh sikurse âsht shteti? Plani ynë âsht preventivi i madh, jo vetëm për të gjitha arat në teritorin shtetnuer, por edhe për të gjitha fabrikat, puntorinat, xeheroret. Na e dijmë se pa drithë nuk ka bukë. Gjithashtu duhet të jemi të vetëdijshëm me doemos se pa qymyr nuk ka as hekur. Pa qymyr nuk ka as alumin. Pra, qymyri âsht nji prej landëve të para themelore dhe të doemosdoshëme. Ai âsht themeli mbi të cilin mbështetet industrija e randë. E pa industri të randë nuk bâhet.

Na kemi llogaritë se sa hekur dhe çelik i papërpunuem na duhet, prandaj e dijmë se edhe sa qymyr do të na duhet për të prodhue sasín e caktueme të hekurit dhe çelikut.

Prej çelikut prodhojmë, përveç tjerash, edhe binarë hekurudhash, vinça, maqina dhe shum gjana tjera. Për prodhimin e nji

tonelate hekur, të papërpunuem na duhet nji tonelatë e gjysëm xehe hekuri dhe afër 0,8 tonelatë koks. Në qoftë se dëshirojmë që këtë koks, ta nxjerrim prej qymyrit të vendit, atëherë për çdo tonelatë hekur të papërpunuem duhet të rëmihim nga 2,1 tonelata qymyr. E hekuri i papërpunuem nuk âsht ende çelik. Për përpunimin e mâtejshëm na duhet ende qymyr. Për nji tonelatë çelik na duhen 2,2 tonelata xehe hekuri dhe 3,6 tonelata qymyr.

Gabojnë shum ata që mendojnë se shifrat në logarin tanë të madhe janë marrë ashtu lehtë, prej ajrit. Kaq e kaq përqindje má tepër xehe hekuri e çeliku — âsht për ta kangë e painelodishëme. Mirëpo, për ne kjo âsht kanga e ardhmenís. Na e dijmë se në logari çdo gjâ âsht e lidhun me njena tjetrën dhe se secila shifër veç e veç e ka vleftën e vet.

Dikur nuk ka qenë e mundshëme me logaritë aspak. Për shembëll kapitalistat kanë vendosë: »Sivjet do të prodhojmë kaq e kaq tonelata çelik má tepër, sepse çmimet »po shtohen« dhe parashihet fitimi i mirë«. Ata nuk i ka interesue aspak se sa çelik duhet për degat e ndryshëme t'industrís, e as ata vetë nuk kanë mujtë me e parapa këtë gjâ. Disa degë t'industrís janë zhvillue qorrazi dhe kanë prodhue aq sa u ka pëlqye. Por kjo gjâ nuk ka

ndodhë vetëm në disa degë ekonomike. N'asnji fabrikë nuk ka mujtë me u llogaritë saktësisht qysh përpara se sa do të prodhohet mbrenda nji vjeti. Ka ndodhë që askush nuk ka mendue për faktin se si të gjitha degët ekonomike janë të lidhuna ngushtë me njena tjetrën dhe se si asnji degë industrijale nuk âsht plotësisht e pamvarun prej tjetrës. Mbarë jeta ekonomike drejtohej atëherë prej »ligjit«, të cilin me të vërtetë, nuk e kanë quejtë me emnin e vërtetë, nuk e kanë quejtë me emnin e vërtetë që kishte — »vrapim për fitime«. Ndërlidhja e disa degëve ekonomike u interesonte vetëm, në qoftë se ajo do të kishte lidhje me atë »ligj« të tyne.

A do të munden trenat me qarkullue rregullisht, në qoftë se nuk rêmihet mjaft qymyr? Asht e qartë se nuk munden, sepse na përdorim lokomotiva me avull. Pra, hekurudhat janë të mvaruna prej industrisë së qymyrit. N'anën tjetër, të shohim a thue se industrija e qymyrit âsht e mvarun prej hekurudhave? Të shohim se shka do të ndodhte sikur trenat të mos qarkullojshin. Në xeherore punohet edhe për nji kohë. Sa mâ tepër qymyr që nxjerret, ai aq mâ tepër grumbullohet. Separcjoni mâ në fund âsht mbushë për së tepërmi. Çdo gjâje fillon t'i zehet fryma me qymyr, kështu që as nuk mund të nxjerret mâ as jashtë grope. E tanë puna prehet.

Gjithashtu edhe industrija e qymyrit âsht e mvarun prej industrís së hekurit, e jo vetëm industrija e hekurit prej qymyrit. Në qoftë se industrija e hekurit nuk âsht e zhvillueme, ase në qoftë se âsht pre puna në te, përdorimi i qymyrit âsht shum mâ i pakët. Me këtë rast nuk mundet të zhvillohet as industrija e qymyrit. Prandaj, përdorimi i qymyrit mund të sherbejë si mâsë për zhvillimin e industrisë.

A mos âsht ndoshta industrija e pamvarun prej bujqësisë? Padyshim jo. Bujqësija, jo vetëm se jep gjana ushqimore të nevojshëme për ushqimin e puntorís, por ajo furnizon edhe industrín me landë të para shum të vlefshëme. Industrija e ushqimeve nuk mund të mendohet fare pa prodhime bujqësore. Pa mbajtjen e bagëtisë nuk do të kishte as industrí të prodhimeve të mishit.

Industrija e tekstilit dhe e lëkurave kanë lidhje më të ngushtë me mbajtjen e bagëtís. Mirëpo, silvikultura âsht nji degë aq me randësi, sa që për të do të flasim veçanisht; po kështu do të flasim dhe për xehtarín. Sa më shum e zhvillueme âsht industrija, aq ma randësi fiton edhe bujqësija. Kështu, për shembëll, industrija jonë e tekstilit ka nevojë për pambuk, lesh, li, konop, e madje edhe për mëndafsh artificjal. Kush do t'ia japë këto landë të para? Vetë do të fillojmë me prodhue pambuk në viset e Jugut — në Maqedoni, Mal të Zi, Hercegovinë dhe Dallmaci. Prodhimi do të zgjanohet kohë mbas kohe edhe në veri. Industrija e drunit dhe industrija kimike do të na japin mëndafsh artificjal, gjâ që nuk do ta kishim pasë pa silvikulturën. Do të ndërtojmë fabrika të mëndafshit artificjal.

Veçmas duhet të flitet mbi randësín e bujqësís për industrín e automobilave dhe për qarkullimin në përgjithësi. Disa katundarë kanë qenë deri tash vonë anmiq të përbetuem t'automobilit. Kapitalistat kanë udhëtue në mënyrë primitive nëpër katundet e tyne, kanë rrezikue jetën e fëmijve të tyne, jetën e të rritunve, e madje edhe të bagëtís. I gjithë rrethi afër rrugës ka qenë i mbuluem me pluhun. Arat afër rrugave kanë dhanë më pak prodhim për shkak të pluhunit.

Tash bujqësija do ta përkrahë zhvillimin e industrís s'automobilave, e gjithashtu edhe zhvillimin e prodhimit të maqinave bujqësore. Mendo vetëm, se edhe traktorave iu duhen gomat për rrota. Bujqësija do ta bâjë të mundshëme që prej landëve të para të vendit të prodhohen edhe prodhime prej gome. Në Sllloveni kanë korrë sukses përpjekjet me bimën e huej që mban emnin e çuditshëm »kok-sagiz«. Kjo bimë âsht prû te na prej Bashkimit Sovjetik, ku kultivohet nepër sipërfaqe shum të mëdha. Ajo jep materje, prej të cilave nxirret kauçuku. Te na kanë zbulue edhe njiloj lule gomari, e cila ka mjaft »qumësht« për prodhimin e kauçukut. Për së shpejti do t'i përpunojmë edhe ato lule. Asht e sigurtë se bujqësija në Sllloveni do të jetë burimi i fuqishëm i bimëve industrijale. Kjo gjâ vlen edhe për prodhimin e rrepës së sheqerit. Për këtë arsye do të ndërtojmë për së shpejti fabrikën, e cila do të prodhojë vetë aq sheqer, sa ka nevojë krejt Sllove-

nija. Tashmâ kemi fillue me e kultivue rrepën e sheqerit — kurse deri tash as nuk kemi dijtë për të.

A ka nevojë me provue ende se si âsht, anasjelltas, bujqësija e mvarun prej industris. Nuk ka nevojë që të zehemi se cila degë ekonomike âsht mâ e nevojshëmja. Kush mendon se gjatë Planit pesëvjeçar do të zhvillohen vetëm disa prej këtyne degëve, ai e shiqon ekonomín ende gjithënji me sy kapitalisti, do me thanë se ekonomín e përbâjnë vetëm këto degë etj., shka âsht njilloj, sikur njerium ta përshkruejshim kështu: »Njeriu përbahet prej kambëve, duerve, trupit, kresë, thojve, lëkurës dhe flokëve...« Me të vërtetë âsht e mundshëme me e përshkrue punën e çdo pjese veç e veç, por, me këtë rast, nuk do të guxohej me u harrue se, për shembëll, kamba nuk âsht asgjâ pa pjesët e tjera të trupit. Madje as kryet, në qoftë se âsht i ndamë prej pjesëve tjera, nuk ka as fuqi e as jetë. »Si bujqësija, si industrija e hekurit, si industrija e qymyrit, ashtu edhe industrija e lehtë etj. — të gjitha s'mund të na japin pamjen e vërtetë t'ekonomís, në qoftë se çdo degë e marrim si gjâ të ndame nga jeta ekonomike, në vend ta studjojmë në lidhjen e saj me të gjitha degët e tjera.

Pra, kur t'i studjosh degët e ndryshëme t'ekonomisë ase kur të shkruesh mbi to, duhesh me mendue me doemos për ekonomín — për mbarë jetën ekonomike. Vetëm në këtë mënyrë do të mundesh me kuptue çdo degë, si dhe mbarë ekonomín, e do të mundesh me u përgjegjë vetë në shum »pse?« — na.

Kreu i dhetë

NE MES TE REPUBLIKAVE TONA NUK KA GARDHIQE

1. Tregimi për të pesë vllaznit

Na ishim nji herë... »Kështu zakonisht fillojnë tregimet e ngjajshëme për të tre vllaznit. Mirëpo, tregimi ynë duhet të fillojë kështu: »Nuk kanë jetue nji herë...«

Nuk kanë jetue, sepse nuk i kanë lejue me jetue. Anmiqtë janë përpjekë me e provue se në të vërtetë as nuk ekzistuekan kësi vllazën. Kroatë nuk ka... Ata janë pasardhësat e Gotëve e Gotët janë fis gjerman. Kroatët nuk kanë kurgjâ të përbashktë me Sllavët, prandaj ata edhe nuk janë vllazën me Sërbët dhe Sllovenët. Gjithashtu nuk ka as Sllovenë. Sllovenët janë vetëm gjermanë t'emigruem ase fis i veçantë që do të quheshin Vendë ase disi në mënyrë të ngjajshëme. Përsa iu përket Sërbëve, ata janë ballkanas ase dofarë melezësh azijatikë. Sërbët dhe Kroatet janë anmiq të përbetuem me njeni tjetrin dhe ata nuk mund të jetojnë afër njeni tjetrit. Në mes të tyne ka për së tepërmi dallime të mëdha kulture, besimi e madje edhe gjuhe. Përveç kësaj, nuk janë as të nji gjakut.

Përsa u përket Malazezëve, duhet me të vërtetë me pohue se janë fis barituer, që jetojnë në miqësi me Sërbët dhe Kroatët, por këtë gjâ le ta harrojnë sa mâ parë, se âsht në dobin e tyne.

Po Maqedonasit? Maqedonasit as nuk kanë egzistue kurr.

Kështu âsht, i çuditshëm dhe i dhimbështëm, tregimi për të pesë vllaznit, të cilët nuk kanë guxue me dijtë se jetojnë, e lene

mâ se janë edhe vllazën. Por tregimi nuk e ka përfundimin e mjeruem. Ai vazhdon afërsisht kështu:

Të pesë vllaznit sllavë jetojnë sod në gjashtë republika popullore si motra, të lidhuna ngushtë në Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë. Të gjithë vllaznit gëzojnë të drejta të barabarta.

Në këtë bashkim vllaznuer jetojnë edhe pakicat e popujve të tjerë — por jo si sherbëtorë. Të gjithë së bashkut ulen rreth nji tryeze, të gjithë punojnë me çdo gjâ që kanë. Për shembëll, Republika popullore e Sërbisë prodhon shum mâ tepër drithë se sa mundet me e shpenzue. Sllovenija, Maqedonija, e madje dhe Malî i Zi, nuk prodhojnë mjaft drithë e vllau Sërb ua jep bukën. Në Sllloveni shum njerëz punojnë nëpër fabrika, nëpër xeherore të qymyrit dhe në pyje. Ata prodhojnë shum mâ tepër mall industrijal se sa u nevojitet. Atë mall e ndërrójnë me drithë.

Vllazenit ndihmojnë njeni tjetrin, ashtu si duhet; kuptohet mâ vetvetiu, porsi vllazën. Kjo gjâ âsht e mundshëme, mbassi ndërmjet shtepijave të tyne nuk ka gardhiqe. Mirëpo, ndërmjet tyne kanë qenë dikur mâdje edhe gremina të tmershëme, gjakatare.... Në mes të republikave popullore nuk ka kurrfarë kufijsh si ato që janë zakonisht midis shteteve. Nuk ka kurrfarë doganash. Nuk ka as fajdexhij, të cilët do të blejshin mall në disa republika e mandej t'ua shitshin mâ shtrejtë të tjerave. Për këtë arsye vllau Sllloven nuk e blen bukën mâ shtrejtë prej vllaut Sërb ase Kroat, me gjithëse ai vetë nuk e prodhon në sasi të mjaftueshëme, e vllau Sërb, Malazez ase Maqëdon nuk paguen mâ shum për rrobe se sa Sllloveni.

Pak ka bashkime të këtilla me harmoni dhe të lumtun në botë, sikurse âsht Republika Federative Popullore e Jugosllavisë. Ai bashkim nuk âsht ende i pasun, por së shpejti do të pasunohet, sepse âsht i vyeshëm dhe çdo gjâ e punon e me mend — me plan.

Tregimi natyrisht do të vazhdojë edhe mâ. Tregimet e këtilla i quejmë histori. Historija jonë, historija e të pesë vllazënve, posa ka fillue. Due me thanë se kjo âsht histori e lumtun. Historija fakteqe ka qenë tepër e gjatë dhe shum e dhimbshëme. Porajo nuk do të përsëritet, sepse historija nuk përsëritet.

2. Parmenda dhe traktori — çift i çuditshëm

Te na nuk âsht aspak e çuditshëme me e pa çiftin e këtillë: kaun dhe kalën të ngjitun në të njajtën zgjedhë. Me çiftin e këtillë katundari nuk mundet me marrë pjesë në vrapimet me kuaj, por mundet me lëvrue, me gjithë se vijat do të jenë të cekta.

E si do të dukej çifti i këtillë: parmenda dhe traktori? Na e kemi pa edhe çiftin e këtillë në shtetin tanë e dikujt le t'i vije në dashte mirë, në dashtë keq. Në një arë traktori lëvronte më thellë dhe bânte vija të drejta, në mënyrë që dheu dukej sikur fluturonte mbas tij, e afër tij n'arën fqinjë, katundari merrte në thue mbas parmendes dhe menxi e grithte tokën e fortë. Një gjâ të këtillë, padyshim, për sê shpejti nuk do të kemi rast me e pa më. Parmendat po kalojnë në muzeum. Përparimi i bujqësís nuk mundet as të mendohet, tue lëvrue në disa ara me traktor, e në të tjerat me parmendë; që disa të korren me kombajn, e të tjerat me drapën.

Përparimin e shtetit tanë na nuk e mendojmë tue lejue që një republikë popullore të mbetet mbrapa të tjerave për gjysëm shekulli. A do të mujshin me e tërheqë trenin dy lokomotiva, prej të cilave njena do të shkonte në një drejtim, e tjetra në drejtimin tjetër? Asht e qartë se nuk munden. Gjithashtu nuk mundet të përparojë as shteti si tanësi, në qoftë se gjysma e tij âsht pa kurrfarë industrije, pa veglat më të nevojshëme bujqësore, e ku njerëzit nuk dijnë madje as me shkrue.

Çifti i atillë do t'ishte i mundshëm dhe i dëshirueshëm në Jugosllavin e para luftës: Vojvodina e pasun, ku toka lëvrobej me traktora, dhe Maqedonija mesjetare e mbrapambetun, ku nuk kishte as pllugje të mjaftueshëm. Shka âsht shkaktue si rrjedhim i jetës s'atillë. Zotnija me ekonomín shtëpijake më të zhvillueme qeveriste populltin e mbramabetun si skllavë kolonjalë. Mbarë Jugosllavija ka qenë gjysëm koloni e kapitalit ndërkombëtar, e popujt tanë veç e veç kanë qenë sherbëtorë të mbrendshëm të kapitalizmit të huej.

Familja e të pesë vllazënve dëshiron që tash vllau i vorfën të forcohet sa më parë. Në qoftë se në të gjitha republikat popullore ekonomija zhvillohet në mënyrë shembullore, stëherë të

gjithë së bashku do të punojmë mâ lehtë. T'ardhunat e përbashkëta do të jenë mâ të mëdha, e të dalunat mâ të vogla. Asnji republikë nuk do të jetë pengesë e ekonomís së përbashktë. I tanë shteti do të zhvillohet në mënyrë të barabartë. Nuk do ta fshijmë drithin mâ me kombajna në nji republikë, e në tjetrën me shtypsa. Çfarë familje do t'ishte ajo ku nji vlla vesh këpucë lustrafini, e tjetri shkon zdathë; njeni shkon në theatër, e tjetri nuk din as me lexue?

Familja e të pesë vllazënve nuk do ta lejojë dallimin e këtillë. Të gjithë vllazënit do të edukohen patjetër ashtu si duhet, do të vishen si duhet dhe do të jenë t'aftë për jetën e përbashktë në komunitetin e kulturuem. Ajo familje nuk do të lejojë që njeni vlla të vishet me mëndafsh, të lyhet me pudër dhe me erna, e tjetri të mos ketë as këmishë, të jetë i ndyet dhe me morra.

Jugosllavija e re âsht shtet i kulturuem. Ajo âsht në rrugën që çon prej robnís koloniale në socjalizëm. Prandaj nji nga detyrët kryesore të Planit tanë të parë pesëvjeçar âsht zhdukja e disproporcjonit në zhvillimin ekonomik të çdo republike veç e veç. Sa mâ parë të zhduken këto dallime në mes të republikave, aq mâ parë do të kalojmë në rrugën që na çon në socjalizëm.



Kreu i njimbëdhetë

KUSH DESHIRON ME E MARRE FJALEN?

1. A ka lindë tashmâ poeti?

Po, presim... A ka lindë tashmâ poeti? Do me thanë, ai poet, që do t'i këndonte të gjitha këto. Mbi rrugën tanë të lavdishëme nga terri drejt lirís së plotë ekonomike, që quhet socjalizëm. Dikush duhet të këndojë, në mënyrë që ta ndijnë edhe të shurdhët.

Të na ka njerëz, të cilët ende janë të shurdhët për të gjithë tingllimën tanë punuese, për zhurmën e maqinave, për shushuritjen e lumejve, të cilët vejnë në lëvizje turbinat e centraleve të reja elektrike... Veçanisht janë të shurdhët ndaj fjalëve mbi detyrat, që duhet patjetër t'i përmbushin gjatë Planit pesëvjeçar.

Disa prej nesh nuk duen fare me i kuptue fjalët: »projekt«, »plan«, »Pesëvjeçar«, ata e ndëgjojnë pa dëshirë edhe fjalën »populli punues«. Atyne u ka shpetue pa ndi çdo gjâ, që âsht bâ dhe që âsht mbërrijtë deri tash. Fakti se Jugosllavija e re âsht ngritë prej gërmadhave, prej rrënimeve të tmerrshëme të luftës, si me thanë mbrenda nji nate, dhe fakti se të gjitha këto i ka krijue prej asgjâje, me gjithë se dukej që për rindertim do të duheshin me dhetë vjetë — të gjitha këto nuk kanë kurrfarë domethanje për ta.

Por në qoftë se ndonji âsht ndalë dhe rrin anash, koha nuk do të ndalet për këtë shkak. Lumi nuk do të ndalet, për shkak të shkumës; sa mâ tepër shkumë të ketë, aq mâ shpejt lumi âsht tue hecë. Prandaj as nuk do të flasim për disa individë, të cilët

nuk meritojnë që t'i përmendim, kur âsht fjala për gjana aq të mëdha — mbi ndryshimin e të gjithë jetës sanë.

Duhet të bisedoj me poetin që do të thurrte nji vjershë të fuqishëme zgjimi për të gjithë, e jo vetëm për ata që flejnë ende. Duhet në rradhë të parë me i zgjue ata që nuk janë me të vërtetë të shurdhët, por që nuk janë ende plotësisht të vetëdijshëm për të gjitha këto që kanë ndodhë, ata, të cilët nuk janë shlirue ende prej zakoneve të vjetra dhe të cilët nuk i kanë hjekë ende syzat, që ua kanë vû në shkollat e vjetra dhe kur kanë qenë t'ulun rreth tryezës kapitaliste. Kësi njerëzish nuk janë mësue me mendue ende me krye të vet dhe gjithnji iu tingllon ende në vesh shkenca e predikuesave kapitalista. Ata nuk interesohen shî për kurrgjâ — e madje as për faktin se si do të mujshin me e përmirësue jetesën për vehten e tyne dhe për fëmijtë e tyne.

Disa thonë se i kanë bindjet e veta e nuk mund t'i ndërrojnë si ndërrohen këmishat. Në të vërtetë, ata nuk kanë kurrfarë bindje, sepse nuk kanë dijtë as me mendue. Për shum të tjerë âsht vonë që të fillonte dikushi me i riedukue në pleqni. Me gjithë këtë, ende shum kujt prej nesh do t'i duhet me shkue në shkollë. Edhe për ata vlejnë fjalët e Leninit.

»... do të ketë nevojë që të riedukohen miljona katundarë dhe pronarë të vogjël; me qinda mija nëpunësa dhe intelektualë borgjezë; ... duhet me i mujtë te ata zakonet dhe traditat borgjeze; por gjithashtu duhet me i riedukue ... edhe vetë proletarët, të cilët nuk mund t'i shkundin paragjykimet e tyne borgjeze — as për njiherësh as me ndonji farë mrekullije ...« (Vepra të zgjedhuna, Libri XXV, faqe 274).

Ata duhet t'i riedukojë patjetër edhe poeti që po e presim.

2. Edhe letrari e ka Planin e vet pesëvjeçar

Për njerëz të mësuem zakonisht merren ata që shkruejnë tregime mbi kohnat e vjetra, mbi ngjarjet dhe njerëzit, të cilat njerëzit e »thjeshtë« nuk mujnë me i dijtë dhe me i kuptue mâ, sepse jetojnë në nji kohë krejt tjetër. Shkrimtarët e këtillë i quejmë historjanë. Por në qoftë se vepra e tyne ka për qëllim

me edukue dhe mësue popujt, do të mundemi me i quejtë edhe mësues të popullit. Me fjalë tjera, historija shqyrton shkaqet e ngjarjeve historike, e ky âsht qëllimi i saj i vërtetë, e jo përshkrimi i thatë i ngjarjeve.

Për shkrimtarë të këtillë nuk do të flasim tash. Nuk duem me i pengue në punën e tyne. Ndoshta ata tash janë tue hulumtue dishka me shum randësi, kështu që as nuk do të na ndijnë. Ata tash ndoshta të tanë kohën e tyne e kalojnë tue ndigjue gjâna nga e kaluemja e lashtë. Mirëpo, na të dy nuk e kemi veshin aq të hollë. Nuk mund të presim derisa dikuj t'i bjen ndërmend me fillue me shkrue mbi kohën tanë. Historjanët, për shembëll, fillojnë nga ndonji herë me kërkue ndonji epokë të kalueme kur nuk gjinden mâ as eshtnat e njikohëtarëve t'asaj epoke.

Mbi kohën tanë duhet me shkrue qysh sod. Ndoshta ndonji shkrimtar do të më përgjigjet:

»Nuk mund të shkruhet qysh tash! Nuk kemi ende perspektiva!«

Me këtë ai do të thonte se tash nuk kemi ende pasqyrë të vërtetë (të ngjarjeve, shkaqeve, rrjedhimeve dhe përgjithësisht të mbarë jetës së sodshëme). »Jemi ende të thelluem në këtë punë«, thonë ata. »Përshtypjet janë ende tepër të fuqishëme. Çdo gjâ âsht aq afër syve, sa që shohim vetëm disa gjâna në vend të tanësís. Kur t'i harrojmë hollësinat dhe kur faktet mâ të randësishëme të dalin në vendin e parë, vetëm atëherë do të jetë e mundshëme me shkrue«.

Këtë gjâ lenja historjanit! — i përgjigjem shkrimtarit t'atillë. Unë jam njeri puntor, asish shka te na ka sod me mija. Jetoj në kohën e sodshëme dhe çdo ditë më sjell dishka »pse«?. Dikush duhet patjetër të më japë përgjegje, dikush duhet të kërkojë fjalën, që të çfaq të gjitha ato që po i ndijmë na njerëzit e thjeshtë punuesa, për t'i ndjekë mendimet tona dhe për të na tregue rrugën e vërtetë në udhëkryq; për të na zgjue gëzimin e jetesës dhe për të na tregue së largu pamje te të cilat duhet të mbërrijmë, në qoftë se dëshirojmë të mbërrijmë dishka.

Shkrimtari duhet të hecë krahas me né në rrugën që çon në socjalizëm, përndryshe ndoshta ai do të qëndrojë anash kolonës

së miljona njerëzve që nxitojnë përpara? Kolonës që din se ku shkon. A guxon shkrimtari me qëndrue anash dhe vetëm të shiqojë, sikur nuk kupton kurrgjâ, për të gjitha që ndodhin; sikur nuk din se shka do të thotë kjo gjâ e flaktë, ai hov dhe zjarm në sy e në zemra? A thue shkrimtarit nuk i intereson aspak jetesa përnjimend?

A nuk lexon ai kurrgjâ? A nuk ka lexue se shka ka thanë shoku A. Zhdanov kur ka çmue revistat sovjetike »Zvezda« dhe »Leningrad«:

»... shkrimtari nuk guxon të tërhiqet në bisht të ngjarjeve, ai duhet patjetër të hecë në rradhët e para të popullit, tue ia tregue popullit rrugën e zhvillimit të tij. Shkrimtari duhet patjetër ta edukojë popullin dhe ta armatosë ideologjikisht, tue pasë për parim metodën e realizmit socjalist, tue studjue me ndërgjegje dhe me kujdes njimendësín tanë, tue u përpjekë me hŷ sa mâ thellë në substancën e proçesit të zhvillimit tanë«.

A do t'ishte farë shkrimtari ai që do të thonte: »Nuk më intereson kurgjâ për të gjitha këto që ndodhin rreth meje. Le të punojë gjithkush shka të dojë, mendimi im qëndron mbi të gjitha ato. Unë prap se prap jam shkrimtar dhe nuk shkruej reportazha vulgare. Mue nuk më intereson buka e zezë, por krijoj të bardhën. Unë jam — nuk më kujtohet se kush e ka thanë këtë gjâ — ingjinjer i shpirtit. Nuk jam puntor i randë që të bâj gurë të coptuem. Unë prap se prap jam shkrimtar.

Shka t'i përgjigjem, si puntor, »ingjinjerit të këtillë të shpirtnave«?

Shpirti yt âsht i mjerë, o »ingjinjer«! Ia ke ndërtue vetvehtes nji shpirt plotësisht të përgjumshëm. Shpirtnat tanë i ndërton puna në ndërtesat e panumërta, sepse ndërtojmë socjalizmin — pa tyj. Ti po rrin anash dhe për së shpejti do të mbesish mbrapa, sepse na po shkojmë përpara. Atëherë do të kesh »përspektivë« — do ta shiqojsh jetën si njeriu që shiqon trenin kur âsht vonue e s'ka mujtë me e zanë.

Mirëpo, shkrimtari ynë e ka Planin e vet pesëvjeçar. Ai ndërton qysh tash, ashtu sikurse ndërtojmë të gjithë na të tjerët. Shkruen. Mbi shka shkruen? A do t'ishte letrar ai që do të dety

roheshin me e porositë se për shka të shkruejë? Çfarë shkrimtari do t'ishte ai që nuk do ta vërente Planin pesëvjeçar, që nuk do të shihte se shka ka realizue dhe shka po realizon rinija jonë? Shkrimtari do të shkruejë mbi jetën, prandaj atij nuk do të mundet me i shpëtue pa i vërejtë detyrat tona.

Ai nuk do të mundet me shkrue mbi Planin pesëvjeçar, atëherë kur plani të kryhet; nuk do të mundet me fillue studimin e jetës sanë të tashëme, atëherë kur të jetojmë ndryshe. Ai nuk do të mundet me u enthuzjazmue për fitoret tona punuese, vetëm atëhere kur edhe ai t'i gëzojë frytet e tyne; nuk do të mundet të hyjë në radhën e herojve, mbassi të kryhet lufta. Asht e nevojshëme me dalë qysh tash në fushën e betejës, e jo me pritë kohën kur triumfuesave t'iu shpërndahen kunorat e dafinës.

3. Shkencëtarit me dyer të mbylluna

Në dyer ishte mbishkrimi: »Mos pengoni! Nuk pranoj!«

Para dyerve njii varg i gjatë njerëzish. »Pse po pritni?« E pyeta të parin.

»Jam ingjinjer«, m'u përgjegj, sikurse me këtë t'ishte thanë çdo gjâ. »Kërkojmë xehe, e nuk dijmë se si qëndron çashtja me shtresat e tokës. Na duhet dikush që e quejmë gjeolog. Ai âsht shkencëtari, që shiqon thellë në dhé. Kemi nevojë edhe për shkencëtarë, të cilët do të zbulojshin mënyrën se si të nxirren metalet, tue mos i rëmihë xehet prej thellësinave aq të mëdha. Dikur jam përpjekë më kot me e nxjerrë arin prej metaleve tjera, e tash kjo gjâ do t'ishte e mundun. Pse shkencëtari nuk shpik vegla t'atilla, me anën e të cilave njeriu do të shihte në terr pa kurrfarë drite? Pse ai nuk shpik dishka që do t'i pengonte të gjitha eksplozjonet në xeherore? Pse nuk âsht e mundshëme që xehet të shëndrrohen në metale aty në xeherore sikurse për shembëll, qymyrin që e shëndrrojnë në gaz ndriçues në xeherore. Gjithshka ka qenë mâ parë e pamundshëme, tash âsht realizue«.

Nuk më kujtohet mâ se për çfarë mrekullimash të pabesueshëme flitte ingjinjeri. Në fillim mendova se e ka kapë tempe-

ratura nga të pritunit e tepërm në koridorin me ajr jo të pastër. Por edhe të gjithë të tjerët flitshin në mënyrë të çuditshëme.

»Jam puntor«, tregonte një tjetër, »dëshiroj me i tregue shkencëtarit se një herë jam helmue me plumb — natyrisht, jo me dashje. Punoj në shkrijatoren e plumbit. Ndoshta shkencëtarët as nuk dijnë se sa të rrezikshëme janë disa detyra të puntorëve. Kam mendue se ndoshta do të kishte mundësi me u shpikë ndonji gjâ që të pengonte helmimin me plumb. Pse jo? Janë zbulue serume të ndryshëme kundra sëmundjeve të shumta. Le të shpiket dishka e ngjajshëme kundra helmimit me plumb. Kush e din, ndoshta do t'ishte e mundshëme që ajri nëpër shkrijatore të përzihet me ndonji gjâ, e cila do të bante që avulli i plumbit të mos jetë mâ i rrezikshëm për shëndetin? Natyrisht, unë nuk kuptoj gjâ ne këtë punë, prandaj janë këtu shkencëtarët...«

Unë i ndigjojsha vetëm të gjitha këto. Të gjitha ishin për mue gjâ e re. As nuk kam mendue kurr se njerëzit e thjeshtë mendojnë mbi mirekullina të këtilla.

»Burrin e kam tuberkuloz«, tha një grue që pritte para dyerve të mbylluna.« A nuk âsht marre që nuk kemi ende mjekë ashtu si duhet kundra tuberkulozit? Shka s'kanë shpikë njerëzit, e ende nuk kemi bar kundra tuberkulozit... Po shkruhet mbi bombën atomike... Pse të mos shpiket një bombë e atillë që t'i përvlonte të gjitha mikrobet helmuese?«

»Jam kopshtar. Plotësisht i shëndoshë, sepse punoj n'ajr të pastër. Por me gjithë këtë nuk jam i kënaqun. Më âsht kujtue një ide, pse njeriu të mos fillojë me prodhue vetë materje po ashtu si bimët që prodhojnë tash. Me këtë rast nuk do të mvareshim prej kohës, prej të korrunave të dobta ase të mira. Sigurisht ti e din se njerëzit tashmâ prodhojnë kauçuk artificjal. Pse mos të prodhojmë edhe drithë, shka do të thonte mâ tepër miell, ose me fjalë tjera bukë? Në qoftë se bima mundet me i gjetë të gjitha landët e para, pse të mos i gjente edhe njeriu. Landët e para janë këtu. Duhet vetëm me i përpunue. Bima âsht njifarë maqine a në të njajtën kohë edhe fryt, e dielli âsht motori. Në blerimin e gjetheve gjinden landë të para, të cilat bima i merr dhe i thith vetë prej tokës dhe prej ajrit, si dhe i shëndrron n'atë gjâ që na

e quejmë ushqim ase qelizë e bimës. Aty krijohen hidratet e karbonit, amidoni dhe të gjithë të tjerët. Të gjitha këto i dijmë, e si ka mujtë atëherë me ndodhë që shkencëtarët nuk e kanë shqyrtue ende rranjësisht këtë gjâ? Kam lexue se si do t'ishte e mundshëme me i ngjyrosë disa elektrone, ase ato pjesë përbamëse t'atomeve që fluturojnë kur shkatrrohen atomet. Natyrisht nuk e dij se si bâhet kjo punë. Thonë se do t'ishte e mundshëme me i pa elektronet e këtilla të ngjyrosuna në blerimin e bimëve. Në këtë mënyrë do të mujshim me pa se si toka po shëndrrohet në bukë . . .«

»Jam lëkuraxhi«, ia priti tjetri. »Për asgjâ mos u frigo, me gjithë se lëkura e rregjun nuk ka nji erë aq të kandshëme. Edhe unë kam dëshirë me bisedue me shkencëtarin rreth punës se kurkush deri tash nuk ka shpikë aso kemikalesh që do ta bâjshin të mundshëm punimin e shojeve të përjetshëme. Do ta shtijshim lëkurën n'atë »dishka« dhe shojet nuk do të shkyheshin kurr«.

»Edhe unë po mendoj për shpikje të ngjajshëme«, shtoi bojaxhiu. »Tash, kur punojmë për vehten tanë, e jo për fitimet e kapitalistave, nuk kemi pse të frigohemi se do të mbetemi pa fitim po të prodhojshin pëlhura të pashkyeshëme. Do t'i ngjyrosim me dishka . . .«

Në këtë kohë dyert hapen papritmas dhe na zuni frymën era e qelbun si prej ndonji vorreze të vjetër rromake. E gjithë turma u vu në lëvizje, sepse gjithkush ngutej — jeta nuk pret. Në prag të derës duel njeriu me mantil të bardhë.

»Si asistent i punturit tanë shkencuer të lavdishëm dhe të njohun me famë botnore, ju urdhnoj të gjithëve që t'i leni besidimet me njiherë. Mos na pengoni në punë! Na duhet qetësija! Kemi nevojë për qetësi dhe heshtje të plotë, së paku për njiqind vjetë! Po e shkruejmë nji dizertacion të kohës »mbi gjatësinë e mjekrrës së Grekëve të vjetër me nji komentim të veçantë mbi

heksametrin e Homerit dhe mbi ndërrimet e hanës në lidhje me baticën dhe zbaticën në detin Jon, para tre mijë vjetëve.«

Mandej përplasi derën si me dashtë me e mbyllë me të vërtetë së pakut për njiqind vjetë. Për nji kohë mbetëm që të gjithë të shtanguem, e mandej u ndigjue zâni i nji puntorit.

»Kështu duhet të na ndodhë, kur kërkojmë ndihmësa në shtëpizën e kërmillit. T'i kërkojmë midis njerëzve të gjallë! Midis atyne që nuk i mbyllin dyert para nesh!«

Edhe na të dy do t'i përshendesim ndihmësat tanë nga gjiu i njerëzve të gjallë. Do të përshëndesim ata shkencëtarë që punojnë me nxanësa nepër shkolla dhe n'entet shkencorë, në laboratore, e madje edhe në fabrika ata që i kryejnë detyrët, që ua ngarkon industrija, që marrin pjesë në punën e qendrave shkencore bujqësore; ata që krijojnë lloje të reja të bimëve dhe i përmirësojnë llojet e dobta të bimëve. Ata nuk presin që dikush t'ua ngarkojë ndonji detyrë, por e shtrojnë vetë para vehtes së tyne. Ata nuk mbyllen nëpër kabinetet e tyne, por e studjojnë jeten rreth vetvehtes dhe interesohen për zhvillimin e shkencës në botë, veçanisht në Bashkimin Sovjetik. Ata nuk i shkatrrojnë vetëm atomet, por shkatërrojnë edhe besimet e kota edhe mosdijen. Ata janë të vetëdijshëm se âsht detyra e tyne, që me anë të punës ta përmirësojnë jeten, të hapin rrugën drejt përparimit — të hecin para turmave ase së bashku me to, e jo me numërue në vend, mbas jetës.

4. Shoku ingjinjer

»Nuk kam kohë! Plani pesëvjeçar!«

Asht e kuptueshëme, s'ka kohë për të kuvendue, sepse i duhet të punojë. Ai na duhet gjithkund: me ndërtue fabrika, centrale elektriku, me hapë xeherore të reja, me bâ trasena të rrugëve dhe të hekurudhave të reja, me vizatue me qinda plane, me llogaritë aq sa nuk i mjaftojnë as tabelat e llogaritmeve, as maqinat e llogarisë. Ai na duhet edhe në pyje, edhe në vendet e ndërtimit, në laboratore dhe në fabrikat e hekurit, madje edhe n'ara. Ingjinjeri âsht profesjonalist. Kjo do me thanë — ai âsht ndërtuesi i të gjitha gjanave të reja dhe transformuesi i të gjitha të vjetrave, tue filue prej maqinave e deri te jeta.

Ingjinjeri nuk punon mbrapa dyerve të mbylluna, por në byrot e mëdha për vizatime në mes të grumbullit të puntorëve, në mes të maqinave me zhurmë, për bri ujvarëve të fuqishëm të lumejve tanë që do t'i rregullojë ai, për bri kompresorëve që ngulen në shkrepat e gjallë, në tunele dhe në galeritë e xeheroreve. Ai punon gjithkund, ku punojmë na dhe mund ta takosh në çdo vendndërtim dhe vendpunim.

Ai nga ndonji herë, kur ka kohë, edhe shkruen. Shkruen dizertacjone interesantë mbi industrinë e hekurit ase t'aluminit, mbi pyjet tona, mbi prodhimin e masave plastike, mbi mënyrën e re të punës, mbi elektrifikimin tanë ase mbi dishka tjetër, që âsht në lidhje me Planin tanë pesëvjeçar. Lexojmë me dëshirë gjithshka shkruen ai — sepse gjanat e këtilla do të na ndihmojnë që të bâhemi profesjonalista. Kur nuk jemi të sigurtë se a âsht ndonji gjâ e këtillë ase e atillë, profesjonalisti, pa nji pa dy, do te na i shpjegojë të gjitha.

Me të vërtetë âsht dam i madh që shoku ingjinjer s'ka kohë të shkruejë mâ shpesh!

Sikur ta lejonte koha, ai do të shkruente nji varg librash, të cilat do të lexoheshin nëpër shkolla, në kurse, e madje edhe gjatë vetë punës. Ka ende shum gjâna që nuk i dijmë. Na duhet patjetër të lexojmë me kujdes edhe shum libra. Shum prej këtyne librave as nuk janë shkrue ende. Dikush duhet patjetër t'i shkruejë. Ndoshta do t'i shkruente ndonji ingjinjer, si për shembëll, Ilini, shkrimtari i njohtun sovjetik. Edhe Ilini âsht ingjinjer. Neve patjetër duhet të na flitet në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë, në mënyrë që të gjithë të kuptojmë, sepse do të shkruhet për né, e jo për profesjonalista që i dijnë tashmâ të gjitha këto gjana.

Shok ingjinjer, je gabim pra, në qoftë se mendon që ingjinjerat nuk duhet të shkruejnë. Ti duhet me plot dëshirë me u dhanë shenime atyne që iu vjen penda mirë përdorësh, duhet të japësh me dëshirë këshilla profesjonale atje ku nevojiten.

Por të gjitha këto janë tepër pak. Dega e profesjonit nuk âsht shtëpizë kërmilli, por fushë e gjanë, N'atë fushë duhet me mbjellë, e madje edhe me i mësue të tjerët se si duhet me mbjellë. Duhet me i mësue në mënyrë, që të tubosh rreth vehtes sate sa

mâ shum ndihmësa, të cilët që të gjithë do të bâhen mbjellësa të vetëdijshëm dhe të shkathët.

5. Po punoj për familjen e madhe

Dikur njerëzit kanë shkrue tregime të këtilla. »Na jetonte nji herë nji mbret...« Ndoshta n'ato kohna kanë jetue me të vërtetë vetëm mbretnit, sikur populli as të mos kish qenë fare. Me të vërtetë, populli atëhere as nuk ka jetue — ai ka jetue keq. Por mû për këtê arsye tash âsht e nevojshëme që të shkruejmë tregime tjetër lloji — mbi jetën dhe popullin. Duhet me shkrue nji tregim që do të fillonte afërisht kështu:

»Na ish nji herë nji murator. Ai e ndërtonte mirë të gjithë jetën e vet. Ka ndërtue shtepija të panumërta, ura, fabrika a pallate. Tashmâ as vetë nuk do të mundej me tregue mbi gjithshka ka ndërtue. Sikur të dëshironte me regjistrue gjithska ka ndërtue, do të bâhej njî libër i trashë prej krejt punës së vet. Asnji mbret nuk ka punue aq shum, sigurisht jo edhe aq punë të dobishëme.

Ka ndërtue pallate, e banonte në barakë. Kur e kryente pallatin, dera e tij mbyllej për tê. Kur kryente së ndërtuemi shtëpin e mirë për banim, atij i duhej me u largue prej saj. Gekqerja ia grryente rrobet dhe lëkurën. Këpucët i shkatrroheshin në kambë. Vinte dimni e për atê nuk kishte punë kërkund mâ. Ka qenë murator, dhe të gjitha ato punë kanë qenë për tê dishka krejt gjana tê thjeshta. Ai ka qenë »vetëm« murator. Kush ka mendue prej atyne, që kanë jetue në pallate se ato i ka ndërtue muratori që mërdhihej në barakë?

Ka qëllue që shî ai murator ka fillue të ndërtojë në themele të reja. Ai nuk ka ndërtue pallate për kapitalista, as vila për spekulanta dhe liferenta t'ushtrisë, as fabrika për shfrytëzuesat e popullit. Ai ka fillue të ndërtojë në shtetin tanë populluer. Së bashku me shokët ka ndërtue ura, penda për centralet e reja elektrike, aso fabrikash që te na as nuk ka pasë deri tash, e ndërtesa banimi të mëdha e të ndritshëme.

— Kush do të banojë n'ato shtëpija? — Pyeti ai.

— Punëtorët — ju përgjegjën. — Edhe ti do të mundesh me banue aty.

— Për kend do të punojnë ato fabrika?

— Për të gjithë né që punojmë në vende të ndryshëme, për njerëzit punuesa.

Muratori mendoi: »Punoj, pra, për familjen e madhe dhe familja e madhe punon për mue. Të gjithë punojmë për të gjithë. Punojmë për vehten tanë. Të gjithë jemi nji familje. Ndihmojmë njeni tjetrin. Pikërisht të gjithë ndërtojmë. Do të kryejmë së ndërtuemi nji gjâ të madhe. Tash të pakten e dij se për kë po ndërtoj. Tash po ndërtoj që mos të mërdhihem mâ në barakë. Po ndërtoj shkolla, që fëmijt e mij dhe fëmijt e të gjithë atyne që punojnë të mësojnë në to... Po ndërtoj fabrika në mënyrë që ato të prodhojnë mall, maqina për né... Të gjithë nuk kemi ende shtëpija të bukura. Nuk ka edhe mjaft fabrika e shkolla. Duhet të ndërtojmë edhe mâ shpejt.

Po flitet se këto shtëpija duhet t'i kryejmë deri në mbarim të Dhetorit. E pse mos t'i kryejmë edhe mâ parë. Kush po thotë se nuk âsht e mundun? Duhet me provue gjithshka që na duket e pamundshëme«.

Muratori e provoi atë të pamundshëmen. Filloi me ndërtue në mënyrën e re. Për nji ditë ka ndërtue aq mur, sa që mâ parë nuk ka mujtë me ndërtue për tetë ditë. U bâ novator. U shkrue për të nëpër mbarë vendin. Kudo që ndërtohet filloi puna simbas mënyrës së tij. Tash me të bâjnë gara muratorë të panumërt. Bâjnë gara me të të gjithë ata që ndërtojnë te na. Na po ndërtojmë dishka mâ të madhe se sa ndërtuesat prej tullave, betonit dhe hekurit. Na po ndërtojmë shtetin. Mbassi e dijmë që po e ndërtojmë për vehten tanë po flasim ashtu si edhe muratori ynë novator, se âsht e nevojshëme me i provue të gjitha ato që duken të pamundshëme. Do t'i ndërtojmë të gjitha mâ përpara dhe mâ mirë, se sa ndërtohej mâ parë te na dhe në botën e jashtëme. Tregimi mbi muratorin tanë, mbi popullin tanë — ndërtues po sa ka fillue. Ai po rritet dita ditës në të gjitha viset e vendpunimit tanë të fuqishëm.

6. Kuvendim me vetvehten

Asht e nevojshëme që të kuvendoj edhe me vetvehten. Por jo vetëm unë. Secili prej nesh duhet të kuvendojë, të bisedojë me doemos me vetvehten për shum gjana. Të mos presë që t'ia çelë sytë njeriu që bân mrekullina.

Të jemi krenarë mbassi mundemi me mendue me kryet tanë. E si punëtorë të krahut të jemi kryenaltë për duert tona të regjuna, me gjithë se në punë përdorim mendjen, armën tanë aq të çudishëme. Të gjithë duhet të dijmë me mendue, pa marrë parasyshë në se punojmë me duer apo me krye.

Me rastin e çdo pune duhet me mendue. Edhe me rastin e punës mâ të thjeshtë duhet me mendue vazhdimisht se a ka qenë e mundun me u thjeshtësue, me u shpejtësue dhe me u bâ mâ e lirë ajo punë. Çdo maqinë duhet me e përsosë edhe mâ shum, ase duhet me e zêvendësue me të rén.

Për çdo ditë mësojmë ase njohim edhe nga dishka. Sikurse maqinat që mund të përsosen vazhdimisht, ashtu mund të përsosemi edhe na vetë. Nuk âsht e nevojshëme që vetëm të persosemi sa mâ tepër në punën tanë profesjonale, por duhet të bâhemi edhe mâ të kuptueshëm, mâ të vetëdijshëm, mâ të njerëzishëm dhe mâ fisnikë. Ligji ynë mbi Planin pesëvjeçar bân fjalë, midis tjerash, edhe për persosmenín e qymyrit. Në qoftë që t'intereson se shka do me thanë kjo gjâ, do ta marrësh vesh se âsht e mundun me i përmirësue të gjitha llojet mâ të dobta të qymyrit, e me këtê gjâ qymyrin do të mundemi me e përdorë atehere edhe për ato qëllime, për të cilat kemi përdorë mâ parë qymyr mâ të shtrejtë, të cilin zakonisht e kemi ble nga jashtë. Por në qoftë se e lexon me shum vemendje Ligjin mbi Planin pesëvjeçar, do të kuptosh, se atje, në çdo kapitull veç e veç, flitet dhe mbi fisnikimin e njerëzve. Me kryemjen e këtij ligji do të fisnikohemi sa mâ tepër. Sa mâ me vetëdije që t'i kryejmë detyrat tona, aq mâ me sukses do të kryhen ato; e prej çdo fitores së punës do të dalim mâ të farkuem.

Për të qenë mâ të mirë në botë, çdo njeri duhet të përmirësojë botën, tue fillue nga vetvehtja. E-jetën mund ta përmirësojnë vetëm njerëzît e vetëdijshëm, të cilët e dijnë se shka duen dhe shka kanë për detyrë.

Na nuk jemi skllavë të topitun, të pavetëdijshëm, asish puntorësh, që dëshirojnë të kenë shtetet kapitaliste industrijale, njerëz që iu shërbejnë maqinave, në mënyrë mekanike dhe të cilët nuk guxojnë me mendue kurgjâ. Na nuk duhet të bâhemi skllavë të maqinave. Maqinat do të na sherbejnë né, e jo na atyne.

Maqinat i blejmë prej së jashtëmi dhe i përsosim në mënyrë që të mujmë me mendue mâ tepër, që të bâhemi mâ të kuptueshëm dhe mâ të lirë, që të bâhemi zotnues të fuqive të natyrës, që të qeverisim me ligjet ekonomike dhe shoqnore.

Edhe unë duhet me u bâ punëtor mâ i mirë dhe njeri mâ i mirë.

Edhë unë e kam Planin tim pesëvjeçar në kuadrin e planit të përgjithëshëm ekonomik. Cila âsht detyra ime?

Ai që âsht punëtor i vetëdijshëm dhe realizues i Planit pesëvjeçar, nuk pyet se shka ka për detyrë me krijue — ai vetë zotohet se do të krijojë shum mâ tepër, se sa duhet të bâjë si pjesëmarrës në ndërtimin e Planit pesëvjeçar.

E kam për detyrë që shoqnís socjaliste t'i jap antarin e denjë — ndërtuesin e ardhmenís mâ të bukur.



LEXUESAVE TË PËRMBAJTJES

Libri zakonisht përfundon me përmbajtjen, që shërben si ndonji udhëtregues, me anën e të cilit njeriu orjentohet në pyllin e kapitujve dhe në prozhmin e përmbajtjes. Disa lexues lexojnë vetëm përmbajtjen, sigurisht nga shkaku se in duket që libri nuk vlen as që të paktën të shpalohet. Ata janë të ngjajshëm me shtegtarët që udhtojnë vetëm nëpër hartën gjeografike dhe kujtojnë se e njohin mbarë botën. Disa lexuesa flasin, prap, mbi shum libra si me i dijtë përmendësh, me gjithë se nuk u kanë lexue as përmbajtjen e tyne.

Do të përpiqem që lexuesave të përmbajtjes t'iu tregoj mbi shka flet ky libërth e ndoshta mandej do të fillojnë me e lexue tue fillue të paktën nga fundi.

Në tanësi, ky âsht nji kolëkcjon kuvendimesh me njerëzit — ndoshta me të vërtetë në nji farë trajte pak jo të zakonshëme — me rinín, me nxanësat, me puntorët, e bile edhe me shkencëtarët, letrarët, me profesjonalistat dhe sociologët e ndryshëm. Kuvenduem mbi gjanat që i kemi mâ afër dhe që duhet të na interesojnë patjetër (me gjithë se disa prej tyne nuk janë ende interesante). Kùvenduem mbi të tashëmen dhe mbi t'ardhmen. Me këtë rast nuk kemi harrue se e ardhmja âsht qysh tash para nesh, se duhet me doemos të hapin rrugën drejt saj. Prej saj na ndan vetëm hapi j madh pesëvjeçar.

Në kreun e parë kërkojmë visare, sepse jemi të vorfën. Gjatë shum shekujsh kemi kërkue visare për të tjerët, e na nuk kemi qenë fare të vetëdijshëm për këtë gjâ. Na kemi mxjerrë pre dheut visaret, tue mos dijtë se shka âsht visari. Tash dijmë

shum më tepër, e prandaj edhe kemi shtrue pyetjen se të kujt janë pikërisht ato pasuni dhe na interesон se si duhet me i zhdukë pengesat në rrugën deri te ato.

Në kreun e dytë kuvendojmë mbi punën se si drejtohet pa mend visari në botë, kështu që nuk dihet më se »kush pin e kush paguen«. Mirëpo, tash e dijmë se paguejnë turmat punuese, që »pijnë« më pak. Flasim mbi punën shka duem pikërisht na që jemi të bindun se është e mundshëme (e ndryshe është fare e pamundshëme) me punue me mend — natyrisht, atje ku populli din se shka don. Na e dijmë mirë se shka duem — duem me realizue tregimin mbi bukën e bardhë.

Në kreun e tretë jemi përpjekë me iu përgjegjë pyetjes se shka duem me mbërrijtë me realizimin e tregimit mbi bukën e bardhë. Ai që dëshiron me u pasunue, nuk guxon me e kalue këtë kapitull.

Në kreun e katërtë kemi tregue kalizimin shum të vërtetë mbi kulshedrën që don me i përbi të gjithë njerëzit e gjallë. Nuk kemi harrue me thanë se si është e nevojshëme me e zhdukë nji herë e përgjithmonë atë përbindësh gjakpimës — se si është e nevojshëme me i përvjelë duert dhe se si »pronari i vogël« duhet me doemos t'ia këthejë shpinen »pronarit të madh«, ështu që prej skllavi të bâhet njeri. Në qoftë se nuk e din se shka është lirija, të këshilloj që ta lexojsh këtë kapitull.

Në kreun e pestë kemi shkue të vërtetën me sy. Pa kurrfarë shmangëje kemi pranue se detyra jonë âsht shum e randë. Për realizimin e saj na duhen afër një miljonë njerëz më tepër. Ku gjindet ai miljon njerëz? Në qoftë se t'interesон — lexojo!

Në kreun e gjashtë jemi njohë me miqtë dhe bashkëpuntorët tanë më të mirë, të cilët do të na ndihmojnë që ta kryejmë detyrën e randë. (Ajo âsht detyrë aq e randsishme, sa që duhet ta quejmë historike). Kemi bisedue edhe mbi dy animiqtë më të mëdhej — mbi gardhin dhe traktorin. Për njenin nga këta nuk ka më vend në botë. Gardhiqet tona janë si ndonji kalendar i çuditshëm. Tue i marrë ato parasyshë — na ndodhemi endë në shekullin e XIX.

Në kreun e shtatë u zhvillue kuvendimi mbi fabrikën mâ të çuditshëme, të cilën nuk e ka ndërtue njeriu, por me gjithë këtë e drejton — edhe me gjithë se, shpesh herë, si edhi laknën. Ajo nuk âsht kurgjâ tjetër, veçse fabrika e jetës. Kur ta lexosh atê kapitull, nuk do të habitesh mâ. Do të pranosh se pa atê fabrikë nuk do të mundemi me të vërtetë me jetue dhe se ajo duhet ta ketë me doemos drejtorín ma të mirë.

Në kreun e tetë do tâ provosh se plehu nuk âsht aq fjalë e keqe, sikurse iu duket ende disave, me gjithë se ata nuk mprohen aspak nga buka e bardhë që âsht pjekë në plehun e mirë e t'yndyrshëm. Shpresoj se nuk do të frigohesh për se tepërmi kur do të hetosh kulturen e plehut n'afërsín tande. Në se e lexon këtë kapitull, do të pranosh pa kurrfarë ngurrimi se kultura pa pleh âsht me të vërtetë e zbehtë. Kush mendon se kultura âsht e mundshëme pa ekonomi, ai âsht ende shum i pakulturuem. A po s'âsht kështu?

Në kreun e nandë do të mundesh me njohë mëshehtësín e llogarís së madhe që gjindet në librin e llogarís të quejtun Ligji mbi Planin pesëvjeçar. Aty do të bindesh se të gjitha degët ekonomike janë në nji afërsi aq të ngushtë, sikurse drithi e buka ase druni e zjarmi. Nuk do të mëshehësh mâ se, pikërisht ashtu sikurse duhet të hajë, çdo njeri duhet të llogaritë, në qoftë se dëshiron me jetue — natyrisht, jo në kurriz të huej.

Në kreun e dhetë do të mundesh me lexue tregimin për pesë — e jo vetëm për tre — vllazënit që jetojnë në nji familje shembullore, që këso familje rrallë gjindet në botë. Ndermjet këtyne vllazënve nuk ka gardhiqe dhe as nuk do të ketë mâ kurr. Vllazënit e ndihmojnë njeni tjetrin, që shtëpija e tyne të bâhet së shpejti e fortë dhe e pasun. Si quhet ajo shtëpi?

Në kreun e fundit ua kam dhanë fjalën të gjithë atyne që kanë dashtë të tregojnë ndonji send. Ndoshta edhe ti je midis tyne. Pra, kush dëshiron të flasë? Në qoftë se kurkush nuk paraqitet mâ detyrohem me bisedue vetë me disa prej atyne që i çmojnë për së tepërmi fjalët e veta.

E tash — le të mos mbetet vetëm me fjalë!

PËRMBAJTJE

Kreu i parë

Faqe

Kujt duhet me iu përgjegjë? — — — — — — — 5

Visaret tona

1. Në rrethin magjik — — — — — — — — 7
2. Visaret nuk gjinden vetëm në tregime — — — 8
3. Të kujt janë visaret — — — — — — — 11
4. Si duhet me i përballue pengesat në rrugën deri te visaret — — — — — — — — 13
5. Gjithkush âsht farkatari i fatit të vet — — — 16

Kreu i dytë

Shka duem

1. »Nuk dihet se kush po pin e kush po paguen« — 19
2. »Këtu do të mbjelli grunë« — — — — — — 21
3. Tregimi interesânt nuk qe shkrue asnji herë — — 24
4. Tregimi për bukën e bardhë — — — — — 27
5. Mrekullina t'atilla që nuk kanë ndodhë ende — — 30

Kreu i tretë

Dhe shka do të mbërrijmë

1. Mbrenda pesë vjetëve do të jemi dy herë mâ të pasun — — — — — — — — — — 33
2. Si të pasunohemi — — — — — — — — 36
3. »Do të shihni, dishka do të ndodhë« — — — — 39
4. »... Sunduesi i botës« — — — — — — 42
5. Cili âsht ndryshimi midis...? — — — — — 45

Kreu i katërtë

Si duhet të fillojë

1. Kulshedra që përbin njerëz të gjallë — — — — 48
2. Pronarët e mëdhej dhe të vogjël — — — — 52

Faqe
3. Pa qymyr nuk mund të lavrohet — — — — 54
4. Shka âsht lirija? — — — — — — — — 57
5. Kur do të prodhojmë aeroplana? — — — — 60
6. »A nuk po e sheh se jam zdeshë e zdáthë?« — — 64
7. E pse vetëm në Bosnjë? — — — — — 67

Kreu i pestë

Ta shiqojmë të vërtetën në sy

1. Edhe njerëz ka tepër pak — — — — — — 71
2. A don rrobe të reja? — Ajo gjâ nuk më intereson! 75
3. Burri dhe grueja — — — — — — — — 77
4. »Le të bâhet zotni!« — — — — — — — 80
5. Ku janë nji miljonë njerëz? — — — — — 82
6. Orat janë hutue — — — — — — — — 86

Kreu i gjashtë

Punëtori me njimijë duer

1. »Ta kemi prû shtëpín« — — — — — — 90
2. Mirë se keni ardhë! — — — — — — — 93
3. Cfarë dallimi ka midis katundarit dhe punëtorit — 95
4. Dy anmiqtë: gardhi dhe traktori — — — — 97

Kreu i shtatë

Fabrika e jetës

1. Vrasësi mâ i madh — — — — — — — 101
2. Kur ta nxjerrësh nga shtëpija gurin e themelit — 103
3. Aleat ase anmik i jetës? — — — — — — 104
4. Visare shum të mëdha humbin n'ajr — — — 107
5. Damtuesi mâ i madh i pyjeve — — — — — 110

Kreu i tetë

Plehu — buka — kultura

1. Plehu âsht fjalë e bukur — — — — — — 112
2. Grindja për theatër dhe për gropat e plehut — — 115

Kreu i nandë

Mëshehtësít e llogarís së madhe

1. Mâ tepër qymyr, mâ tepër hekur, mâ tepër bukë, mâ tepër — — — — — — — — — 119
2. Nuk dij me llogaritë — — — — — — — — 120

Faqe
3. Qysh? — — — — — — — — — — 124
4. Pse? — Qé sepse — — — — — — — — 127

Kreu i dhetë

Në mes të republikave tona nuk ka gardhiqe

1. Tregimi mbi pesë vllaznit — — — — — — 132
2. Parmenda dhe traktori — çift i çuditshëm — — 134

Kreu i njëmbëdhetë

Kush dëshiron me e marrë fjalën

1. A ka lindë tashmâ poeti? — — — — — — 136
2. Edhe letrari e ka Planin e vet pesëvjeçar — — 137
3. Shkencëtarit me dyer të mbylluna — — — — 140
4. Shoku ingjinjer — — — — — — — — 143
5. Punoj për familjen e madhe — — — — — 145
6. Bisedim me vetvehten — — — — — — 147
Lexuesave të përmbajtjes